

RAPPORT
2005



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruga: "Abdi Toptani", Tiranë

Tel. +355 4 226287

Fax. +355 4 226089

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr. 12/1 Prot.

Tiranë, më 25.01.2006

Lënda: Raport mbi veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2005

KUVENDIT TE SHQIPERISE

Znj. Jozefina Topalli
Kryetare

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 35 prot, datë 06.01.2006, bashkëlidhur, ju dërgojmë "Raport mbi veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2005", si dhe materiale të tjera shoqëruese.

KRYETARI

Halil Lala



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruga: "Abdi Toptani", Tiranë

Tel. +355 4 226287

Fax. +355 4 226089

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr. 12/1 Prot.

Tiranë, më 25.01.2006

Lënda: Raport mbi veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2005

KUVENDIT TE SHQIPERISE

Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

**Znj. Valentina Leskaj
Kryetare**

Tiranë

Bashkëlidhur, ju dërgojmë "Raport mbi veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2005", i cili u miratua në mbledhjen e Këshillit të KKRT-së, në datë 23.01.2006, si dhe materiale të tjera shoqëruese.

KRYETARI

Halil Lafaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KKRT-KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

Rruja: "Abdi Toptani", Tiranë

Tel. +355 4 226287

Fax. +355 4 226089

e-mail/ kkrt@kkrt.gov.al

Nr. 12/1 Prot.

Tiranë, më 25.01.2006

Lënda: Raport mbi veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2005

Prezencës së OSBE-së

Zyrës së Shtypit

Tiranë

Bashkëlidhur, ju dërgojmë "Raport mbi veprimtarinë e KKRT-së për vitin 2005", i cili u miratua në mbledhjen e Këshillit të KKRT-së, në datë 23.01.2006, si dhe materiale të tjera shoqëruese.

KRYETARI

Halil Lalaj



**KESHILLI KOMBETAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT
KKRT**

***RAPORT VJETOR
2005***

JANAR 2006

Pasqyra e materialeve të KKRT-së paraqitur për raportim në Kuvendin e Shqipërisë:

1. Raporti Vjetor 2005

2. Anekset:

- Aneksi 1 : Realizimi i buxhetit për vitin 2005, detyrimet financiare
- Aneksi 2 : Raport mbi llogaritjen e të ardhurave nga monitorimi i reklamave
- Aneksi 3 : Rregullimet ligjore, licensimet dhe rilicensimet e operatorëve rtv, problematikat e veprimtarisë rtv
- Aneksi 4 :
 - 4.Të dhënrat e hyrjes së Shqipërisë paraqitur në ushtrimin e parë të Planifikimit;
 - 4.1.Të dhënrat e hryses për cakttime/allotime numerike;
 - 4.2.Rezultati i ushtrimit të parë të planifikimit;
 - 4.3.Zhvillimi i ushtrimit të parë të planifikimit;
 - 4.4.Projekt shembulli i tekstit rregulator;
 - 4.5.Proyekt plani i frekuencave numerike të Rajonit të Ballkanit, miratuar në takimin shumëpalësh (Sofje);
 - 4.6.Proyekt plani i frekuencave numerike të Rajonit të Adriatikut, miratuar në mbledhjen e Grupit të Adriatikut.

3. Plani i Veprimit 2006

**PER NJE RREGULLIM ME EFEKTIV
TE TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE**

Raport mbi veprimitarinë e KKRT-së gjatë vitit 2005

Hyrje

Gjatë vitit 2005, KKRT, ka shënuar disa realizime, që janë vlerësuar si hapa në drejtimin e duhur në fushën e rregullimit të mediave elektronike, duke fokusuar problemet që duhet të zgjidhen për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, në kuadrin e përpjekjeve të të gjithë vendit për arritjen e standardeve të anëtarësimit në Europë.

Për të siguruar progresin e evidentuar, gjatë vitit 2005, KKRT, në përputhje me Planin e Veprimit ka stabilizuar strukturat e tij drejtuese duke rritur efektivitetin e administratës me synim rritjen e qëndrueshmërisë dhe cilësisë së rrjeteve të transmetimit, përmirësimin e programacionit, nxitjen e diversitetit të tij, krijimin e hapësirave mediatike për minoritetet, zbatimin e rregullave të konkurrencës së ndershme dhe trajtimin e operatorëve në bazë të parimeve të barazisë, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit.

Në zbatim të misionit të tij, edhe gjatë vitit 2005, KKRT ka vazhduar përpjekjet konkrete për konturimin e një strategji kombëtare për zhvillimin e sektorit të transmetimeve radio e televizive, përfshirë rregullimin me ligj të shërbimeve numerike.

Gjatë vitit 2005 u shënua progres edhe në zbatimin e planit të përafrimit të legjislacionit për mediat elektronike me standartet europiane, konkretisht me Konventën Europiane mbi Televizionin Ndërkufitar dhe Direktivën e Televizionit Pa Kufi.

Ndërkaq, edhe për arsyet e vitit të vështirë elektoral, probleme të rëndësishme, si transmetimet pa autorizimin e KKRT-së, transmetimet jashtë zonës së licencimit, rregullimi i transmetimeve numerike, mbeten për t'u trajtuar e zgjidhur, gjatë këtij viti.

1. EFEKTIVITETI I KKRT

Në përpjekje për të vënë në zbatim kërkesat e Rekomandimit të Këshillit të Europës (2000) 23 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore për sektorin e transmetimit, përsa i përket garancive legjislative të pavarësisë nga autoritetet publike, forcat politike dhe interesat ekonomike, janë bërë hapa përpara që evidentohen me krijimin dhe stabilizimin e profitit të KKRT-së si organ kompetent dhe i respektueshëm.

Në vitin 2005, Këshilli funksionoi me përbërjen e tij të plotë, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Kjo është ndjerë në vendimmarrje, në dobi të transparencës dhe besueshmërisë së saj. Kjo ka sjellë rritjen e autoritetit të KKRT-së dhe uljen e numrit të kontestimeve mbi vendimet e tij nga operatorët radio e televizivë, kombëtarë e lokalë. Qëndrimi i unifikuar i KKRT-së, lidhur me projektligjin e transmetimeve numerike,

ndihmoi në mosmiratimin e këtij projekti, siç dihet tashmë qëndrim i përshëndetur nga përfaqësitet e organizmave ndrkombëtarë në Shqipëri.

Vendimet e marra nga KKRT gjatë vitit 2005, përgjithësisht dëshmojnë për aplikimin korrekt, proporcional e jodiskriminues të këtyre përgjegjësive, duke e evidencuar përgjegjësinë e vet institucionale, nëpërmjet transparencës së plotë të akteve të tij të rëndësishme, siç kanë qenë organizimi i konkurrimit të kandidaturave për licenca operatorësh të shërbimeve radio apo televizive të mbështetura në teknikën analoge tokësore, shqyrtimi i dokumentacionit dhe dhënia e licencave, etj. KKRT ka publikuar rregullisht vendimet e tij të rëndësishme në gazeten zyrtare, si dhe në website-in e tij (www.kkrt.gov.al).

Një moment i rëndësishëm i llogaridhënës i KKRT-së është raportimi vjetor në organin më të lartë të vendit, që është Kuvendi i Republikës, ku me transparencë të plotë, paraqitet gjendja e sektorit, veprimtaria e KKRT-së dhe problemet që shtrohen për zgjidhje, për sigurimin e zhvillimit të harmonizuar të shërbimeve radio e televizive në vend.

Për rritjen e transparencës dhe tërheqjen e bashkëpunimit të strukturave të tjera të shtetit, shoqatave të transmetuesve dhe të publikut, KKRT është përpjekur të organizojë diskutime me tema të caktuara, në kuadrin e sqarimit të rrugëve të zhvillimit të sektorit në kushtet e Shqipërisë, duke kërkuar njëkohësisht edhe mbështetjen e organizmave të specializuara ndërkontinentare. Me këtë rast përmendim punën e bërë për hartimin e projektit të ligjit “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike në Shqipëri”.

KKRT mendon se për të ardhmen, duhet punuar më fort dhe më me motiv për tërheqjen e mendimit dhe bashkëpunimit të strukturave shtetërore, shoqatave të mediave dhe vetë publikut.

2. PROGRAMET RTV – DUKURITE MBI PROGRAMACIONET

Parimi themelor i zhvillimit të veprimit tarisë radiotelevizive është liria e komunikimit audiovizual. Njëkohësisht, kjo liri duhet të ushtrohet duke respektuar paanshmërisht të drejtën për informim, pluralizmin e informacionit, respektimin e dinjitetit të njeriut, ruajtjen e rendit publik dhe sigurisë kombëtare, mbrojtjen e të miturve dhe adoleshentëve. Respektimi i këtyre parimeve në median elektronike është shëndruar tashmë në një cilësi thelbësore për të gjithë operatorët radiotelevizivë. Ndërsa vëzhgimi e monitorimi në praktikat zbatuese të këtyre parimeve vazhdon të mbetet si përkujdesje kryesore e KKRT.

Vlen të theksohet se KKRT, në asnjë rast nuk mund të nderhyjë dhe nuk ka ndërhyrë përpëra transmetimit të programit nga operatorët radiotelevizivë. KKRT nuk është organ censure. Ai ka ushtruar funksionin e vet duke u kujdesur që operatorët të respektojnë kushtet e përcaktuara në ligj dhe detyrimet kushtetuese, kryesisht duke i dhënë përparësi dialogut me operatorët radiotelevizivë dhe jo përdorimit të sanksioneve. Programacionet e radiove dhe televizioneve kanë ndryshuar me ritme të shpejta në këto vite të zhvillimit të medias elektronike në Shqipëri. Theksojmë që ritmet e ndryshimit të formateve të programacionit në televizione janë më të shpejta se sa në radio. Kanalet televizive, si rezultat i përballimit të konkurrencës, janë vazhdimisht në proces të rinnovimit të programeve të tyre dhe ndryshimit të programacionit. Në përgjithësi dhe si

rregull, vihet re kombinimi i programeve informative dhe debateve politike me programet zbavitëse dhe argëtuese. Por, po funksionojnë normalisht edhe operatorë me tematikë si muzikore, sportive e sidomos informative. Përshtatja e formave të njohura po kthehet në dukuri negative, që tregon varférinë e ideve për të përbaluar programacionin, sipas të cilës është bërë licensimi. Formatin informativ të NEWS 24, tashmë e kanë përshtatur disa operatorë televizivë, me ndryshime të vogla, por në thelb, mbetet e njëjtë skemë. Po përvijohet një fenomen i ngjashëm edhe në kanalet muzikore.

Edicionet e lajmeve dhe debateve politike janë nga programet më cilësore të medias elektronike shqiptare. Operatorët radiotelevizivë më të njohur privatë kanë krijuar fizionominë e tyre dhe audiencën e caktuar për emisionet e lajmeve në përgjithësi, dhe emisioneve të aktualitetit në veçanti. Por, po përhapet dukuria e imitimit të stilit të dhënies së lajmeve, faqosjes së edicioneve informative, si në stacionet e njohura, ashtu edhe tek operatorët e rindërtuar radiotelevizivë. Aq e vërtetë është kjo dukuri, sa që edhe grafika, edhe titrimi i edicioneve të lajmeve bëhet i ngjashëm nga njëri stacion tek tjetri. Sapo njëri operator ndryshon faqosjen e edicionit të lajmeve, vërehet një përpjekje e ngjashme e kolegëve të tjerë. Duke patur parasysh edhe faktin që gazetarët e lajmeve dhe folësit e edicioneve informative po lëvizin pa “kritere profesionale” nga njëri stacion tek tjetri, po bëhet e vështirë të dallosh se në cilin ekran po ndjek lajmet. Në fund të fundit, janë të njëtat lajme, të rendituara ndoshta ndryshtë, ku pjesën më të madhe të kohës e mbush e njëjtë tematikë, e zënë po ato “personazhe” që ndyshojnë vetëm ekran.

Së pari, kështu do të ndodhë për sa kohë burim kryesor informacioni do të janë konferencat e shtypit, seminaret, mbledhjet dhe analizat e punës së dikastereve, që nga ministritë e deri tek komisariatet e policisë. Së dyti, kjo ndodh edhe se gazetaria investigative, zë një vend ende të vogël në programet e aktualitetit. Edhe kur përdoret si element, nëpërmjet kamerave të fshehta në programe të tjera, shpesh pretendohet se cënohet privatësia e ngjallen debate deri në mungesën e ligjit për këtë të drejtë të njeriut. Duke u nisur nga fakti, se sot në mjedisin mediistik ndërkombëtar ekzistojnë rregulla që nuk lejojnë të publikohen dhe të transmetohen informacione që dhunojnë jetën private të njerëzve, qoftë edhe deklarata apo biseda telefonike të regjistruar, pa dijeninë dhe aprosimativ e tyre, e ndjejshmë të nevojshme të theksojmë që ka ardhur koha të mundësohen këto lloj publikimesh me kritere të përcaktuara ligjore.

Në po këtë aspekt duhet parë edhe keqpërdorimi i jetës private të figurave publike në disa nga programet e medias elektronike, pasi shpeshherë tejkalohet dhe nuk justifikohet interes i publikut për informim. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për keqpërdorimin e fëmijëve në fushatë politike, qëllime promocionale si dhe për çështje familjare private.

Një vend të rëndësishëm në strukturat programore të transmetuesve privatë kanë zënë spektaklet dhe varietetë muzikore. Duhen respektuar financimet për realizimin e programeve të tillë, si “Gjeniu i vogël”, “Top Fest”, “Ethet” etj. që, krahas promovimit të vlerave kulturore kombëtare, kanë shërbyer edhe për evidentimin e talenteve të reja.

Konkurenca dhe tendenca për të siguruar audiencën më të gjerë, ka bërë që formatet e programacionit të ndyshojnë vazhdimisht, duke i hapur hapësirë komercializmit të programeve. Më shumë vend po zënë në transmetim, programe të tipit “Reality Tv”, Quize dhe Lojrat e fatit. Adoptimi i programeve të transmetuesve të huaj të

tipit si “Big Brother” që ndiqet në gjithë botën, me gjithëse ka patur një audience jo të vogël, nuk u ka shpëtuar banalitetëve banalitete dhe përdorimin e një gjuhe dhe fjalori që lë për të dëshiruar.

Edhe sporti ka zënë një hapësirë të konsiderueshme në programacionin e medias elektronike private. Në kushtet që transmetuesi publik nuk mundi të përballonë konkurrencën në sigurimin e të drejtave të transmetimit të evenimenteve sportive, operatorët private e ndanë vetë tregun dhe përshtatën transmetimin me pagesë nëpërmjet platformave satelitore dhe numerike, ende të palicenuara nga KKRT.

Më shumë vend po zënë në programacionin e operatorëve privatë filmat artistike, pavaresisht se platformat satelitore dhe numerike konkurojnë ndjeshem ne kete aspekt. Filmat komerciale, telenovelat e lira latino amerikane, soap operat dhe hapësirat komerciale, gjithnjë e më shumë po mënjanojne emisionet edukative, arsimore dhe kulturore nga strukturat programore të televizioneve private. Kjo është dukuri edhe në vende të tjera të Europës.

Gjendja e pasqyruar më sipër vlen për operatorët kombëtarë dhe operatorët e tjerë privatë që transmetojnë në Ultësirën Perëndimore në përgjithësi, me qendër në Tiranë e afér saj, që, duke patur pothuajse pjesën më të konsiderueshme të buxhetit të reklamave, zoterojnë edhe audiencën më të madhe. Për operatorët e tjerë vendorë, vështirësitë financiare ndikojnë në ndërtimin e një programacioni real. Ata shpesh përsërisin programet e stacioneve të huaja apo transmetuesve më të mirë vendas. Të vetmet programe që ata prodhojnë vetë, janë lajmet, bisedat në studio për problemet e komunitetit, si dhe disa programe përfëmijë.

KKRT, në zbatim të detyrimeve të veta ligjore, do të ndërmarrë nisma përvendosjen e normave të prodhimit të programeve, duke i kushtuar rëndësi programeve kulturore, arsimore dhe edukative, si në radio dhe në televizion.

2.1 Pasqyrimi i fushatës zgjedhore 2005

Monitorimi i medias elektronike në zgjedhjet politike të vitit 2005 u krye në bashkëpunim me Bordin e Monitorimit të Medias, i ngritur nga KQZ-ja, në përpunje me detyrimet e Kodit Zgjedhor. Për nevojat e monitorimit, përrugullat, mënyrën dhe afatet e shfrytëzimit të kapaciteteve tona teknike, KKRT dhe KQZ, në fillim të Qershoris nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, e cila kishte si qëllim angazhimin e palëve për monitorimin e fushatës zgjedhore 2005 në radiot dhe televizonet në Republikën e Shqipërisë.

Me një vendim të veçantë të KKRT-së u miratua “KUJTESA”, si një përmblehdje e kushteve ligjore dhe kërkesave etike dhe profesionale që duhet të mbanin parasysh operatorët radiotelevizivë në pasqyrimin e fushatës zgjedhore. Ky dokument iu shpërndau të gjithë operatorëve radiotelevizivë, subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje, si dhe u botua në disa nga organet me tirazhin më të madh në shtypin e përditshëm.

Sic përcaktohet edhe në Raportin përfundimtar të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE-ODIHR-it, media elektronike ishte përgjithësisht e ekuilibruar në pasqyrimin e subjekteve zgjedhore dhe bëri përpjekje për përbushjen e detyrimeve të saj ligjore. Sidoqoftë, ajo u dha dy partive më të mëdha më shumë kohë sesa u përkiste në bazë të ligjit dhe nuk ishte e njëtrajtshme në pasqyrimin e partive të vogla.

RAPORTI I MONITORIMIT TE MEDIAS ELEKTRONIKE

PER EDICIONET INFORMATIVE

Koha e Plotë për Subjektet Politike (*koha në min*)

ZGJEDHJET 2005

Data : 03 Qershor - 01 Korrik 2005

Subjektet	OPERATOR	TVSH	TV KLAN	TVA	TCH	VIZION +	TV KOHA	SHIJAK TV	ALSAT	NEWS 24	NESSER TV	R. TIRANA	TAR	RADIO +2				SHUMA
AD ALEANCA DEMOKRATIKE		57,17	14,58	52,97	13,27	27,36	22,04	1,90	9,60	29,35	4,72	14,51	3,16	0,17				250,80
PBK PARTIA E BALLIT KOMBËTAR		17,59	4,36	21,82	4,21	0,00	0,00	12,72	0,00	11,72	84,26	6,46	0,00	0,64				163,78
LSI LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM		54,67	107,81	76,08	61,42	48,00	5,90	83,44	75,21	91,98	208,09	29,58	17,30	8,96				868,44
LZH LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR		47,86	12,93	63,92	20,67	26,20	0,55	41,54	12,00	41,52	29,53	18,32	5,76	1,95				322,75
PAA PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE		55,12	9,05	7,41	9,51	24,84	23,74	0,00	7,43	38,72	41,42	11,09	2,96	0,00				231,28
AMS ALEANCA PËR MIRQËNIE DHE SOLIDARITET		0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	79,99	0,00	0,00	0,00				79,99
BDSH PARTIA BASHKIMI DEMOKRAT		0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00				0,00
PBDNJ PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT		52,03	14,72	31,84	14,44	40,13	19,64	48,74	6,92	43,62	1,85	19,98	5,37	1,31				300,59
PBKD PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT		1,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00				1,00
BLD PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT		13,97	6,40	11,60	1,71	0,00	3,90	7,60	1,40	0,00	36,12	2,58	1,07	0,52				86,87

PER EDICIONET INFORMATIVE

Koha e **Plotë** për Subjektet Politike (*koha në min*)

ZGJEDHJET 2005

Data : 03 Qershor - 01 Korrik 2005

Subjektet	OPERATOR	TVSH	TV KLAN	TVA	TCH	VIZION +	TV KOHA	SHJAK TV	ALSAT	NEWS 24	NESER TV	R. TIRANA	TAR	RADIO +2				SHUMA
------------------	-----------------	-------------	----------------	------------	------------	-----------------	----------------	-----------------	--------------	----------------	-----------------	------------------	------------	-----------------	---------	---------	---------	--------------

PD PARTIA DEMOKRATIKE	442,57	281,18	361,31	181,75	219,13	343,85	644,97	158,90	259,30	1106,59	127,51	42,02	18,51					4187,59
PDK PARTIA DEMOKRISTIANE	45,39	15,00	1,93	13,01	27,02	20,15	4,62	0,47	22,52	41,62	7,95	1,00	1,98					202,65
PDR PARTIA DEMOKRATE E RE	56,92	14,87	59,27	22,63	40,59	29,20	63,08	15,17	61,84	93,85	26,42	6,66	1,23					491,73
PDSSH PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPÉRISË	59,97	14,96	59,66	14,68	36,93	0,80	11,63	6,55	6,76	72,61	16,91	1,17	0,48					303,11
PKSH PARTIA KOMUNISTE SHQIPTARE	0,00	0,00	4,27	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	1,75	0,00	0,00	0,00	0,00					6,02
LBSH PARTIA LIDHJA E BLERTË SHQIPTARE	10,57	1,36	0,00	0,00	2,60	0,00	5,20	0,00	0,00	16,21	0,77	0,00	21,71					58,42
LDLNJ LÉVIZJA PËR TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT	51,11	7,86	50,25	13,08	1,13	0,00	28,46	5,38	3,75	6,64	10,76	2,96	0,33					181,71
PPSH PARTIA E PUNËS E SHQIPÉRISË	1,30	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,30					1,60
PR PARTIA REPUBLIKANE	56,82	21,94	61,03	22,31	44,03	22,44	71,23	20,28	31,08	75,39	16,69	5,74	2,83					451,81
PS PARTIA SOCIALISTE E SHQIPÉRISË	454,29	275,22	373,00	205,79	235,71	369,91	493,05	171,94	292,57	971,47	162,23	40,69	19,80					4065,67
PSD PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPÉRISË	55,98	13,05	58,73	20,31	31,64	18,42	3,32	4,87	32,19	45,83	19,77	5,68	0,72					310,50
PSKSH PARTIA E SIGURISË KOMBËTARE SHQIPTARE	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00					0,00

PER EDICIONET INFORMATIVE

Koha e **Plotë** për Subjektet Politike (*koha në min*)

ZGJEDHJET 2005

Data : 03 Qershor - 01 Korrik 2005

Subjektet	OPERATOR	TVSH	TV KLAN	TVA	TCH	VIZION +	TV KOHA	SHJAK TV	ALSAT	NEWS 24	NESER TV	R. TIRANA	TAR	RADIO +2			SHUMA
PRESIDENTI		83,59	43,35	51,44	58,96	7,74	26,21	40,78	37,16	9,13	0,00	51,84	17,02	11,52			438,74
KRYEMINISTRI		40,70	15,85	24,69	12,16	6,83	13,29	4,13	6,15	1,66	0,00	14,18	1,18	0,38			141,20
QEVERIA		77,26	29,57	41,88	43,53	30,62	21,22	13,57	13,78	13,30	0,00	24,44	12,97	2,27			324,41
PARLAMENTI		2,71	0,00	0,17	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00			2,88
SHUMA		1738,59	904,06	1413,27	733,44	850,50	941,26	1579,98	553,21	992,76	2916,18	581,99	172,71	95,61			13473,56
DIFERENCA (PS - PD)		11,72	-5,96	11,69	24,04	16,58	26,06	-151,92	13,04	33,27	-135,12	34,72	-1,33	1,29			-121,93
DIFERNCA (PS + PD) - PARTITE E TJERA		259,39	297,51	173,53	156,29	104,37	546,98	754,54	165,56	135,06	1239,94	87,95	23,88	-4,82			3940,19

Në të vërtetë, media elektronike e nisi pasqyrimin e veprimtarive politike për zgjedhjet përparrë fillimit zyrtar të fushatës, pasi vetë subjektet politike e kishin nisur këtë fushatë para kohës së përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Bie në sy gjatë kësaj periudhe që, pasqyrimi i veprimtarive të qeverisë nga RTSH-ja, të jetë jo në masë të barabartë me subjektet e tjera politike. Gjatë fushatës zgjedhore, RTSH-ja i dha pothuajse kohë të barabartë pasqyrimit në edicionet e lajmeve të veprimtarive të PS-së dhe PD-së, por pasqyroj pak veprimtaritë e partive të vogla. Veprimtarive të partive të mëdha iu dha kohë e barabartë në edicionet e lajmeve edhe nga transmetuesit e tjerë privatë, që në disa raste e kronometronin vetë kohën e kronikave televizive, si shenjë transparence për të përmbytshur parimin e paanësisë dhe pasqyrimit të balancuar.

Edhe media elektronike private e përqëndroi pasqyrimin e fushatës më shumë mbi veprimtaritë e qeverisë dhe dy partive më të mëdha, PS e PD. (Shih Tab. Nr. 1 ku jepet koha në minuta që operatorë të ndryshëm radiotelevizivë i kanë vënë në dispozicion partive politike në edicionet kryesore të lajmeve).

E gjithë media elektronike u tregua e paanshme në pasqyrimin e veprimtarive politike të partive pjesëmarrëse në zgjedhje. Në përgjithësi u zbatuan kërkesat e ligjit për ndalimin e propagandës, komenteve dhe qëndrimeve politike, gjatë edacioneve të lajmeve. Media elektronike siguroi një pasqyrim të plotë të fushatës zgjedhore dhe një gamë të larmishme të opinioneve politike.

2.2 Monitorimi i programeve informative të operatorëve kombëtarë

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, bazuar në nenin 7/2 të ligjit nr. 8410, dt. 30.09.1998 ka kompetencë të monitorojë programet informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizive kombëtarë. Gjatë vitit 2005, ky monitorim u kushtëzua me punën përgatitore për monitorimin e fushatës për zgjedhjet parlamentare. U monitoruan nga Departamenti i Programeve edicionet kryesore të lajmeve të Radiotelevizonit Shqiptar, televizioneve kombëtare "KLAN" e "ARBERIA", si dhe "Top Albania Radio".

KKRT reflektoi mbi vërejtjet dhe propozimet e bëra nga ana e ish opozitës në raportin e një viti më parë, mbi kalkulimet e kohës së dhënë për qeverinë dhe politikën në edicionet e lajmeve të transmetuara nga radiot dhe televisionet kombëtare. Mbi bazën e këtyre propozimeve u përpiluan raporte të reja monitorimi dhe u përgatit moduli i ri i këtij procesi. Sipas propozimeve të bëra, u bashkua koha e dhënë në edicionet e lajmeve për qeverinë, kryeministrin dhe partitë parlamentare të pozitës nga njëra anë dhe koha e partive parlamentare të opozitës nga ana tjetër.

Rezultatet e monitorimit u janë bërë të njohura të gjitha subjekteve mediatike të monitoruara, si dhe Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë. Këto rezultate u janë paraqitur edhe partive politike parlamentare, si dhe institucioneve ndërkombëtare të specializuara e që e vëzhgojnë median shqiptare. Tabelat e monitorimit përcaktojnë të dhëna statistikore mbi kohën e vënë në dispozicion nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, për veprimtaritë e partive politike, institucioneve shtetërore dhe të pavaruara, aktorëve të ndryshëm politikë dhe social-ekonomikë etj. Po ashtu jepen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të personaliteteve politike dhe shtetërore në ekranet televizive dhe mikrofonet e radios. Eshtë sugjeruar që operatorët radiotelevizivë, në zbatim të parimit të pluralizmit, të vendosin një ekuilibër ndërmjet kohës sinkron të anëtarëve të qeverisë, të

personaliteteve që i përkasin mazhorancës parlamentare dhe personaliteteve të opozitës parlamentare, duke përjashtuar raste të veçanta që sjellin zhvillimet e paprituara të aktualitetit.

Në Radiotelevizionin Shqiptar, mbi 50 përqind e kohës në edicionet kryesore të lajmeve në TVSH i kushtohet pasqyrimit të veprimtarive të pozitës, pra qeverisë, kryeministrat dhe partive parlamentare të mazhorancës, ndërsa 33% e kësaj kohe i vihet në dispozicion pasqyrimit të veprimtarive të opozitës. Për institucionet, kohën më të madhe në dispozicion e ka patur qeveria me 27% dhe kryeministri me 18%. Raporte të njëjtë ka ruajtur edhe RadioTirana në edicionet e lajmeve, ku 53% e kohës i është vënë në dispozicion pozitës dhe vetëm 26% veprimtarive politike të opozitës parlamentare. Aktorët kryesorë sinkron në RTSH kanë qënë Sali Berisha, Fatos Nano dhe Edi Rama. Ndërsa pozita dhe opozita kanë pasur kohë të barabartë në dispozicion, për t'iu drejtuar sinkron publikut, përkatesisht me 51% dhe 41% në TVSH dhe në një disekuilibër më të ndjeshëm në favor të pozitës në Radio Tirana,(2:1)

Në edicionet informative të televizionit “**KLAN**”, rrëth 54% e kohës televizive i është kushtuar veprimtarive të qeverisë dhe pozitës parlamentare, ndërsa 37% e kohës veprimtarive të opozitës parlamentare. Nga institucionet, qeveria dhe kryeministri kanë zënë pothuajse kohë të barabartë, me rrëth 21% te kohës televizive. Në TV “**KLAN**” personalitetet politike që i janë drejtuar publikut sinkron më shumë janë Sali Berisha dhe Edi Rama. Pozita ka pasur në dispozicion rrëth 55% të kohës së përgjithshme sinkron, ndërsa opozita 41% të kohës sinkron, pra, me një diferencë prej 14% ne favor të pozitës.

Qëndrimi i Televisionit “**ARBERIA**” është i ndryshëm nga dy operatorët e mësipërm. Rrëth 50% e kohës në edicionet e lajmeve i kushtohet veprimtarive të partive opozitare parlamentare aktuale, ku rrëth 37% i jepet PS-së. Ndërsa Pozitës, pra Qeverisë, Kryeministrat dhe partive parlamentare të mazhorancës i është dhënë rrëth 41% e kohës se lajmeve. Aktorët që i janë drejtuar sinkron publikut janë të njëjtët, si edhe në operatorët e tjera kombëtarë, pra, liderët e partive politike kryesore. Ndërsa për subjektet politike, TV “Arbëria” i ka dhënë opozitës rrëth 15% të kohës sinkron më shumë se pozita.

“**Top Albania Radio**” ka pasqyruar në mënyrë të ngjashme veprimtaritë e pozitës dhe opozitës në edicionet e saj informative. Rrëth 50% e kësaj kohe në lajme i jepet pozitës dhe 33% e kësaj kohe i kushtohet pasqyrimit të veprimtarive politike të partive opozitare parlamentare. Aktorët sinkron me kohën më të madhe në dispozicion mbeten liderët e partive politike, ndërsa nga subjektet politike pozita ka rrëth 16% kohë sinkron më shumë se opozita.

Gjatë vitit 2005, “**Radio + 2**”, e licencuar si radio kombëtare, është monitoruar vetëm me sondazhe, pasi programet e lajmeve nuk kanë qenë të strukturuara në orare të përcaktuara.

2.3 Disa dukuri të tjera në edicionet informative

KKRT, nëpërmjet Departamentit të Programave monitoron gjithashtu edhe qëndrimin e operatorëve kombëtarë kundrejt aktorëve, subjekteve politike ose institucioneve të ndryshme. Pavarësisht se kemi të bëjmë me të njëtin lajm, vihet re se transmetimi i tij është i ndryshëm tek operatorët televizivë kombëtarë. Kështu, kundrejt

aktorëve kryesorë të politikës, qëndrimi më i hasur është citimi ose dhënia sinkron e asaj pjese të fjalimit të tij që shkon më për shtat me qëndrimin editorial të vetë operatorit. Gjithashtu, janë hasur raste kur pavarësisht pjesëmarrjes së njëkohshme të dy aktorëve në një ngjarje të caktuar, televizionet i kushtojnë vëmendje vetëm njërit prej aktorëve, duke lënë në hije aktorin tjetër. Gjatë lajmeve ka edhe një tendencë për të ngarkuar negativisht një figurët të caktuar, duke u përpjekur për ta bërë atë përgjegjës për një ngjarje të ndodhur.

Kundrejt subjekteve politike, operatorët mbajnë qëndrim duke u përpjekur të tregojnë se ka mosmarrëveshje edhe brenda koalacioneve. Po kështu, ka raste kur gazetarët theksojnë shumë edhe një qëndrim të aktorit poltik që shkon ndesh me qëndrimin e liderit të vetë mazhorancës ose të opozitës.

Edhe renditja e lajmeve për nga tematika tenton të ndryshojë në renditje. Nëse për një operator lajmet e para të edicionit informativ janë ato që flasin për veprimtarinë e qeverisë dhe të Kryeministratit, për një tjetër, si lajm i parë mund të jenë ato me përbajtje sociale. Kjo është shenjë larmishmërie dhe përpjekjeje për këndvështrime origjinale. Eshtë rasti të shënojmë se kohët e fundit është rritur pesha specifike që zënë lajmet mbi problemet sociale gjatë edicionit kryesor të lajmeve. Kjo temë ndiqet nga lajmet politike dhe ato që bëjnë fjalë mbi veprimtarinë e qeverisë.

Ka patur një përmirësim të dukshëm gjatë transmetimit të kronikës së zezë. Operatorët në përgjithësi përpilen të shmangin pamjet makabre të viktimateve ose intervistat me të prekurit.

Monitorimi i programeve informative të operatorëve kombëtare është shoqëruar çdo muaj me një material studimor mbi qëndrimin e operatorëve të ndryshëm për të njëjtin lajm. Gjithashtu, tabelat me të dhëna statistikore përbledhëse për të gjithë operatorët, u janë dërguar çdo operatori me qëllim që të mund të bëhen krahasimet e nevojshme në rast se dëshirohet.

Pjesë e këtij materiali janë tabelat përbledhëse përkatëse mbi kohën e plotë dhe kohën sinkron në përqindje, dhënë subjekteve politike nga të gjithë operatorët radiotelevizive të monitoruar.

Në përbledhje të sa u tha më sipër, KKRT, si rregullator i ngarkuar me ligj për të monitoruar edicionet informative dhe veprimtaritë politike të operatorëve kombëtarë dhe me kërkësen që kjo gjë, me mënyra të ndryshme, të shtrihet edhe për operatorët e tjere, gjithësesi mbetet e rezervuar të shprehet për anën cilësore të këtyre edicioneve apo përgjithësisht të emisioneve të këtij lloji. Por kjo nuk do të thotë se rregulatori është i pandjeshëm për çka sheh dhe çka kronometron. Të vetëdijshëm për progresin, na mbetet po ashtu të bashkëpunojmë me institucione të tjera, me shoqata që po krijojnë profil për sondazhe ose anketime për një dukuri ende të pakapërcyer, për atë mbingopje me informacione që nuk kanë informacion, me lajme që nuk përbëjnë lajm, me njoftime përtakime e mbledhje të rëndomta, çka përbën veprimtarinë rutinë të administratës së shtetit. Kësisoj nuk mendojmë se aktualisht ka ndonjë shqetësim të mprehtë për të ngritur se, fjala vjen, minutazhet e qeverisë janë të larta, në raport me opozitën, se minutazhet brenda partive janë të pabalancuara etj. etj. Shqetësimi është tek balanca e problematikave, që përbëjnë jetën e vërtetë të kësaj shoqërie, të shqetësimeve që kanë sot

**RAPORTI I DEPARTAMENTIT TE PROGRAMEVE
PER EDICIONET INFORMATIVE**

Koha e Plotë për Subjektet Politike (*koha në %*)

2005

Subjektet	OPERATOR	TVSH	TV KLAN	TVA	RADIO TIRANA	TAR
PRESIDENTI		3,80%	1,68%	1,76%	5,29%	2,59%
KRYEMINISTRI		18,55%	20,64%	10,84%	22,59%	14,83%
QEVERIA		26,88%	21,61%	22,25%	24,66%	26,92%
PARLAMENTI		9,48%	7,29%	6,26%	13,68%	12,57%
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		5,60%	9,25%	6,25%	4,12%	6,05%
PARTIA SOCIALISTE (PS)		25,57%	27,29%	36,59%	18,88%	24,67%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		0,79%	0,45%	0,71%	0,89%	0,37%
LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM (LSI)		4,93%	7,44%	7,41%	4,01%	6,33%
PARTIA AGRARE AMBENTALISTE (PAA)		0,00%	0,02%	0,03%	0,00%	0,00%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		0,09%	0,02%	0,07%	0,00%	0,00%
PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT (PBDNJ)		0,14%	0,15%	0,37%	0,00%	0,10%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPERESE (PDSSH)		0,82%	0,47%	1,90%	0,54%	0,70%
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)		0,19%	0,18%	0,50%	0,32%	0,74%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		0,52%	0,71%	0,38%	0,98%	0,85%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		0,72%	1,23%	0,44%	0,82%	0,89%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)		0,95%	1,34%	3,26%	1,47%	1,30%
PARTI TE TJERA		0,96%	0,21%	1,01%	1,75%	1,06%
SHUMA		100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%
POZITA (KRYEMINISTRI + QEVERIA + PARTITE PARLAMENTARE)		52,69%	53,81%	41,12%	53,49%	50,39%
OPOZITA (PARTITE PARLAMENTARE)		33,07%	37,00%	49,85%	25,78%	33,38%
DIFERENCA		19,63%	16,81%	-8,73%	27,71%	17,01%

RAPORTI I DEPARTAMENTIT TE PROGRAMEVE

PER EDICIONET INFORMATIVE

Koha **Sinkron** për Subjektet Politike (*koha në %*)

2005

Subjektet	OPERATOR	TVSH	TV KLAN	TVA	RADIO TIRANA	TAR
PRESIDENTI		1,47%	0,65%	1,03%	3,32%	1,36%
KRYEMINISTRI		15,97%	20,91%	9,03%	26,88%	15,26%
QEVERIA		26,79%	18,42%	22,19%	25,95%	26,35%
PARLAMENTI		4,35%	2,58%	2,77%	3,99%	5,69%
<hr/>						
PARTIA DEMOKRATIKE (PD)		6,90%	13,09%	6,77%	5,88%	9,37%
PARTIA SOCIALISTE (PS)		33,36%	30,60%	38,00%	24,34%	28,10%
ALEANCA DEMOKRATIKE (AD)		0,84%	0,62%	0,82%	0,45%	0,53%
LEVIZJA SOCIALISTE PER INTEGRIM (LSI)		5,23%	7,78%	8,78%	2,74%	6,49%
PARTIA AGRARE AMBENTALISTE (PAA)		0,00%	0,00%	0,02%	0,00%	0,00%
PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT (PBLD)		0,21%	0,00%	0,10%	0,00%	0,00%
PARTIA BASHKIMI PER TE DREJTAT E NJERIUT (PBONJ)		0,18%	0,22%	0,31%	0,00%	0,26%
PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE E SHQIPERISE (PDSSH)		1,07%	0,66%	2,86%	0,90%	1,06%
PARTIA DEMOKRATE E RE (PDR)		0,14%	0,27%	0,63%	0,38%	0,83%
PARTIA DEMOKRISTIANE (PDK)		0,60%	0,74%	0,48%	1,36%	1,02%
PARTIA REPUBLIKANE (PR)		1,05%	1,61%	0,62%	0,38%	1,06%
PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)		1,01%	1,69%	4,74%	1,53%	1,53%
<hr/>						
PARTI TE TJERA		0,85%	0,15%	0,86%	1,92%	1,09%
<hr/>						
SHUMA		100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%
POZITA (KRYEMINISTRI + QEVERIA + PARTITE PARLAMENTARE)		51,84%	55,27%	40,16%	60,82%	54,15%
OPOZITA (PARTITE PARLAMENTARE)		41,50%	41,35%	55,18%	29,95%	37,70%
DIFERENCA		10,34%	13,91%	-15,03%	30,87%	16,45%

RAPORTI I MONITORIMIT TE MEDIAS ELEKTRONIKE

PER EDICIONET INFORMATIVE

Koha e Plotë për Subjektet Politike (*koha në min*)

ZGJEDHJET 2005

Data : 03 Qershor - 01 Korrik 2005

Subjektet	OPERATOR	TVSH	TV KLAN	TVA	TCH	VIZION +	TV KOHA	SHJAK TV	ALSAT	NEWS 24	NESER TV	R. TIRANA	TAR	RADIO +2			SHUMA
AD ALEANCA DEMOKRATIKE		57,17	14,58	52,97	13,27	27,36	22,04	1,90	9,60	29,35	4,72	14,51	3,16	0,17			250,80
PBK PARTIA E BALLIT KOMBËTAR		17,59	4,36	21,82	4,21	0,00	0,00	12,72	0,00	11,72	84,26	6,46	0,00	0,64			163,78
LSI LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM		54,67	107,81	76,08	61,42	48,00	5,90	83,44	75,21	91,98	208,09	29,58	17,30	8,96			868,44
LZHK LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR		47,86	12,93	63,92	20,67	26,20	0,55	41,54	12,00	41,52	29,53	18,32	5,76	1,95			322,75
PAA PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE		55,12	9,05	7,41	9,51	24,84	23,74	0,00	7,43	38,72	41,42	11,09	2,96	0,00			231,28
AMS ALEANCA PËR MIRQËNIE DHE SOLIDARITET		0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	79,99	0,00	0,00	0,00			79,99
BDSH PARTIA BASHKIMI DEMOKRAT		0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00			0,00
PBDNJ PARTIA BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT		52,03	14,72	31,84	14,44	40,13	19,64	48,74	6,92	43,62	1,85	19,98	5,37	1,31			300,59
PBKD PARTIA BALLI KOMBËTAR DEMOKRAT		1,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00			1,00
BLD PARTIA BASHKIMI LIBERAL DEMOKRAT		13,97	6,40	11,60	1,71	0,00	3,90	7,60	1,40	0,00	36,12	2,58	1,07	0,52			86,87

bindur që edhe funksionimi i këtyre operatorëve është një proces që do të përmirësohet vazhdimisht e në rrugë e sipër.

Nje fenomen i ri që, po u nënverësua mund të jetë me pasoja në të ardhmen, e marrëdhënieve midis operatorëve radiotelevizivë, është ai i respektimit të pronësisë intelektuale. Vërehet kalimi i programeve nga njëri kanal televiziv tek tjetri, së bashku me grupin realizues. Shembuj si ai i "Etheve të së premtes" apo së fundmi "Zonë e lirë" jo vetëm vijnë në dëm të identitetit e profilizimit të operatorëve, për çka edhe rregullatori mbetet veçanërisht i interesuar, por ka edhe norma ligjore, që duhen njojur dhe respektuar, siç janë marrëdhëniet kontraktore.

3. OPERATORI PUBLIK I SHERBIMIT RADIOTELEVIZIV

3.1 Gjendja

Sipas ligjit "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë: "Programet e RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 përqind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë".

Brenda 5 vjetesh nga dita e miratimit të këtij ligji, të paktën njëri nga programe e RTSH-së duhet të mbulojë 99 përqind të popullsisë".¹

RTSH vazhdon të mbulojë 73.3 % të territorit shqiptar. Edhe vitin që kaloi nuk u shënuan investime të konsiderueshme për zgjerimin e mbulimit, si me sinjal radio, ashtu edhe me sinjale televizive. Po kështu, nga operatori publik (RTSH) ende nuk janë ndërmarrë hapa për daljen në transmetim të programit të dytë, të parashikuar nga ligji. Ndërkohë, siç është raportuar dhe herë të tjera, programi i parë vazhdon të mbështetet në një stacion që transmeton nga mali i Dajtit në brezin 81-88 MHz, që, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe përcaktimeve të përbashkëta Europiane, është caktuar për shërbime të tjera. Duke qenë se sinjali i emetuar nga ky transmetues shërben si sinjal primar për të gjithë rrjetin e përsëritësave të RTSH që mbulon gjithë vendin dhe për shkak të investimeve të konsiderueshme që kërkoheshin, edhe vitin e kaluar nuk u bë e mundur mbyllja e këtij transmetuesi.

Në kërkim të një zgjidhjeje optimale të këtij problemi, KKRT, në bashkëpunim me Drejtoren e Përgjithshme të PT, në projektin për modifikimin e planit kombëtar të Frekuencave dërguar Këshillit të Ministrave, propozojnë që lirim i brezit të frekuencave 81-88 MHz të okupuara nga RTSH, të realizohet në kuadrin e përgjithshëm të mbylljes së transmetimeve televizive analoge për kalimin në teknologji numerike.

3.2 Përbajtja

Radiotelevizioni publik shqiptar ka për detyrë ligjore që, nëpërmjet programeve që transmeton, të informojë, të edukojë, të argëtojë, të zbavisë e të ndikojë në pasurimin e jetës shpirtërore dhe intelektuale të publikut. Këto janë veçoritë e transmetuesit publik e që realizohen nëpërmjet përmirësimit të përbajtjes së programeve. Eshtë detyrë e RTSH-së të promovojë kulturën, gjuhën dhe krijimtarinë letrare dhe artistike. Në plot[sim t] k[tyre detyrimeve v[rejm] se është bërë e vazhdon të bëhet pak dhe k[sisoj RTSH nuk po e përballon dot konkurrencën me median elektronike private.

¹ Ligji "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", nen 71

Ndryshe nga operatorët privatë, transmetuesi publik është i detyruar të transmetojë një shumëlojshmëri programesh kulturore dhe edukative, duke mos qenë vetëm një mjet komunikimi. Ky mision i tij nuk mund të plotësohet duke prodhuar një festival këngë në vit apo një telekomedi, as duke transmetuar veprimtari të realizuara nga institucione të tjera kulturore. Eshtë transmetuesi publik që duhet të ndikojë me programet e veta të strukturura profesionalisht në shëndoshjen morale të shoqërisë sonë. Vetëm duke qenë shërbim publik për informacionin, edukimin, kulturën, artin dhe sportin, ky transmetues do të përballojë konkurrencën e nuk do të dalë nga tregu mediatik, siç po ndodh aktualisht.

Kemi mendimin se Këshilli Drejtues i RTSH-së ka në dorë të bëjë shumë për të realizuar me efektivitet misionin e transmetuesit publik, dukuri që fillon me miratimin e strukturës programore, por edhe me zbatimin e saj, që mishërohet në programin favor të transmetimit. Radiotelevizioni Shqiptar po bën pak në fushën programore për të përmbrushur misionin e tij në shërbim të publikut. Për çështje të rëndësishme të interesit publik, operatorët privatë organizojnë debate nga më të ndryshmet, qoftë në formë ashtu edhe në përbajtje, ndërsa operatori publik vazhdon të mbetet në heshtje. Programet debat, që kanë ekzistuar më parë në strukturën e operatorit publik, tashmë janë transferuar në ekrane të tjera. Përmendim, se debatet e suksesshme "Opinion" dhe "Shqip" kanë lindur në TVSH, kanë ndërruar ekran e padyshim janë përmirësuar ndjeshëm, aq sa në llojin e vet, janë më të mirëpriturit nga teleshikuesit.

Ligji i medias elektronike e ngarkon operatorin publik t'i shërbejë nëpërmjet programeve me cilësi të lartë të gjitha grupeve të shoqërisë, duke përfshirë këtu edhe minoritetet etnike apo kulturore.

KKRT vëren se nga studiot qëndrore të RTSH-së dhe nga studiot në rrethe si Gjirokastër, Shkodër e Korçë transmetohen shumë pak programe që u drejtohen posaçërisht pakicave kombëtare dhe aspak programe në gjuhën e minoriteteve. Këshilli Drejtues i RTSH-së, gjatë miratimit të strukturës programore të operatorit publik, duhet ta vleresojë këtë detyrim nga dispozitat ligjore në fuqi dhe si angazhim në plotësimin e detyrimeve të konvantave ndërkombëtare, ku vendi ynë ka nënshkruar.

KKRT do të rishikojë gjatë këtij viti vendosjen e këtij detyrimi edhe për operatorët kombëtarë privatë. Eshtë fakt që disa radio në jug të Shqipërisë transmetojnë programe në gjuhën greke për minoritetin e atjeshmë, ndërsa Radio "Prespa" në juglindje transmeton në gjuhën maqedonase, pasi për këtë qëllim është licensuar nga KKRT-ja. Radio dhe Televizioni "Armonia" në Gjirokastër, të licensuar jo shumë kohë më parë për të transmetuar në gjuhën e minoritetit, ende nuk kanë filluar nga funksionimi e së shpejti pritet të dalin në transmetim.

4. POTESIMI I KUSHTEVE TE LICENCES NGA OPERATORET PRIVATE RADIO E TELEVIZIVE QE PERDORIN TRANSMETIMET ANALOGË TOKESORE

4.1 Operatorët Kombëtarë

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizivë, krahasuar me detyrimet përmblim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre.

Nr.	Operatori	Zona e Licencimit	Mbulimi							
			Dhjetor 2002 Viti II		Dhjetor 2003 Viti III		Dhjetor 2004 Viti IV		Dhjetor 2005 Viti V	
			Kusht ete licenc.	Mbulimi faktik	Kusht ete licenc.	Mbulimi faktik	Kusht ete licenc.	Mbulimi faktik	Kusht ete licenc.	Mbulimi faktik
1	TVSH	K	-	73,31	-	73.31	-	73.31	-	73.31
2	TV ARBERIA	K	7,33	27,39	26,4	30,1	46,97	30,1	62.09	30.1
3	TV KLAN	K	7,33	40,91	26,4	42,68	46,97	42,68	62.09	42.68
4	R. TIRANA	K	-	80,54	-	80,54	-	80,54	-	80.54
5	R. T. ALBANIA	K	28,85	87,22	55,76	87,22	72.69	87,22	94.4	87.22
6	RADIO + 2	K	-	-	55,76	72,64	72,69	72,64	94.4	72.64

- Mbulimi i RTSH është dhënë i pandryshuar në vite, pasi nuk janë raportuar apo identifikuar ndryshime të rrjetit bazë të transmetimit, përvèç identifikimit të ndërhyrjeve me përsëritës me fuqi të vogël që kanë rritur cilësinë e mbulimit me sinjal.
- Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB (μ V/m), që siguron një mbulim cilësor e të garantuar në zonat ku ekziston influenca e kanaleve të vendeve fqinje, siç është zona e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë.

Tabela e mësipërme vërteton tendencën e konstatuar vitin e kaluar² lidhur me përqëndrimin e vëmendjes së pronarëve të TV KLAN dhe TV ARBERIA në zhvillimin e transmetimeve satelitore, të shoqëruara me investimet përkatëse, që kanë sjellë daljen në treg të shërbimeve satelitore SAT+. Kjo ka sjellë që, ndërsa në vitin e kaluar diferenca midis mbulimit të përcaktuar në kushtet e licencës dhe mbulimit faktik përmblim me sinjal nga TV KLAN të ishte vetëm 4.29%, në vitin 2005 kjo diferençë të bëhet 19.41%.

Mosrealizimi i kushteve të vendosura në licencë përmblimin me sinjal nga TV ARBERIA vazhdon të jetë i ndjeshëm (Diferenca midis mbulimit të përcaktuar në kushtet e licencës me mbulimin faktik të realizuar është 31.00 %).

Konstatohet që në vitin 2005, edhe operatorët radio private kombëtarë kanë krijuar diferenca në mbulimin e territorit të Republikës, në përputhje me kushtet e licencës.

Diferenca të tillë e vënë seriozisht në dyshim zbatimin nga të gjithë operatorët privatë kombëtarë, radio apo televizivë, të objektivave të përcaktuara në ligjin “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” (Neni 20),

“Mbajtësi i licencës përmblimin e mbulimit të territorit të vendit. Brenda 6 vjetësh, ky mbulim duhet të arrijë të përfshijë deri në 90 % të territorit dhe jo më pak se 90 % të popullsisë”.

Ndërkaq, objektivi i mbulimit vazhdon të jetë kryesish mbulimi i zonave që kërkojnë më pak investime dhe ku ekziston interes për thithjen e reklamave, duke lënë pa mbulim me sinjal zona të largëta, ku mungojnë edhe operatorët vendorë.

Sipas kushteve të licencës,

² Shih Raportin e KKRT per vitin 2004.

(1) I licensuari duhet të realizojë lidhje stacionare radiorele me jo më pak se 4 (katër) qytete të Shqipërisë, të cilët ndodhen jo më pak se 100 km larg Tiranës.

(2) Këto lidhje duhet të realizohen jo më vonë se 18 muaj nga koha e fillimit të transmetimit.(Detyrimi për lidhje me disa rrethe të Shqipërisë)

Këto kushte presupozojnë që operatorët të kenë ndërtuar studiot e tyre në qytete të ndryshme. Siç është raportuar edhe vitin e kaluar, këto kushte të licencës vazhdojnë të mos plotësohen nga të dy operatorët televizivë privatë kombëtarë.

KKRT, ashtu si edhe vitin e kaluar, i ka tërhequr vëmendjen të dy operatorëve privatë kombëtarë dhe i ka paralajmëruar se shëmangia nga detyrimet e licencës **do të jetë një kusht penalizues gjatë procesit të rilicencimit**.

Informacioni mbi shtrirjen dhe cilësine e mbulimit të territorit të secilit nga operatorët privatë kombëtarë, jepet bashkëngjitur.

4.2. Operatorët Vendorë

4.2.1. Operatorët e rinj vendorë

Për vetë gjendjen e ngarkuar të shfrytëzimit të spektrit me transmetime të teknikës analoge, gjatë vitit 2005, në përputhje me kërkesat e paraqitura, KKRT është përpjekur të orientojë ngritjen e operatorëve vendorë radio dhe televizivë në zonat e largëta, ku nevojat për informacion e argëtim janë më të mëdha dhe ku shfrytëzimi i spektrit nuk është i ngarkuar. Organizimi i garës për operatorë radio e televizivë për zonën e minoritetit grek në jug të Gjirokastrës që u kurorëzua me krijimin e radios dhe televizonit "ARMONIA,, është një shembull i veprimtarisë së KKRT-së në zbatim të këtij orientimi.

Në përpjekje për të realizuar, mundësishët të gjitha kërkesat për t'u licencuar si operatorë vendorë radio e televizivë, në KKRT janë depozituar një numër i konsiderueshëm kërkesash për licensim, ku dhe janë lëshuar 18 licenca të reja për operatorë radio apo televizivë, kryesisht operatorë të vegjël lokalë, ose zgjerime të vogla të operatorëve ekzistues.

4.2.2. Mbulimi i realizuar nga operatorët vendorë radio e televizivë

Informacioni për mbulimin e realizuar nga secili prej operatorëve radio apo televizivë të licencuar, jepet bashkëngjitur.

Në përgjithësi, shumë prej operatorëve të licencuar, sidomos ata televizivë, nuk i mbulojnë plotësisht zonat e tyre të licencimit. Mosplotësimi i detyrimeve për mbulimin luhatet prej 30 % (Ndër të cilët spikatin TV 6+1-8.9 %, TV Gramshi-7.2 % TV Berati-6.2 %) deri në 70 % (Real TV-32%, Tirana TV-42%, Adriatik 61 %, Vizioni+ 54.69%, BBF-60%). Vetëm disa TV, si TNSH, TV 4+, Klodianë e Magic Channel mbulojnë me sinjal 70 deri në 100 % të zonës së tyre të licencimit.

Në fushën e transmetimeve radio, për vetë karakteristikat e përhapjes së sinjalit në brezin FM, mbulimi i zonës së licencimit paraqitet më i mirë.

4.2.3 Operatorët që kanë instaluar stacione jashtë zonës së tyre të licencimit

Në raportet paraardhëse vjetore që KKRT ka mbajtur para parlamentit, ky fenomen është evidentuar qartë, duke paraqitur edhe të dhëna të detajuara mbi mbulimin e realizuar nga çdo operator në përputhje me licencën dhe jashtë kushteve të saj. Në këto

raporte janë propozuar edhe rrugët për të zgjidhur këtë problem, që për mungesë të mekanizmave ligjore, nuk mund të zgjidhej brenda kuadrit ligjor ekzistues.

Nga KKRT janë paraqitur disa variante të amendimit të ligjit, për të lejuar hapësira më të mëdha operimi për operatorët, nëpërmjet futjes së operatorëve **rajonale**, apo për zgjidhjen e përkohshme, nëpërmjet licencimit provizor të impianteve jashtë zonës së licencimit, atje ku ata nuk shkaktojnë interferencë të dëmshme.

Në mungesë të mjeteve ligjore, KKRT është përpjekur të mbajë situatën nën kontroll duke mos lejuar një përkeqësim të gjendjes, sidomos duke ndërhyrë me shpejtësinë e nevojshme për mylljen e menjëherëshme të pajisjeve që janë vënë në përdorim aty këtu, nga operatorë të palicencuar. Si rezultat, në territorin e Shqipërisë nuk janë shfaqur impiante transmetues të rinj analogë tokësorë, me përjashtim të dy rasteve në Laç.

5. MBI TREGUESIT EKONOMIKO FINANCIARE

5.1 Treguesit buxhetorë të KKRT

Për vitin 2005 të ardhurat e planifikuara ishin 62.9 milionë lekë, ndërsa shpenzimet e planifikuara ishin 63.2 milionë lekë. Deri më 22 janar 2006, të ardhurat janë realizuar vetëm 66.2 për qind. Prej dy vjetësh qeveria i ka reduktuar financimet nga buxheti i shtetit, duke zbritur në 8 për qind për vitin e kaluar dhe 7.1 për qind të parashikimit të këtij viti. Siç shihet nga shifrat, ende mbetemi larg balancimit të të ardhurave me shpenzimet. Fjala është kryesisht për shpenzime operative, pa patur ndonjë investim me peshë, si janë mjediset e punës apo qendra monitoruese në distancë si për spektrin ashtu edhe për programet, gjë që është sjellë sot vërtet në nevojë. Duke vlerësuar se pavarësia e rregulatorit është thelbësore dhe se, në funksion të saj, pavarësia financiare është treguesi më shprehës, KKRT e ka në vëmendje të studiojë të gjitha burimet e mundshme, të bëjë propozimet përkatëse në dobi të këtij synimi.

Të ardhurat, deri më tanë, janë thuajse të gjitha nga pagesat vjetore për licencë që operatorët derdhin në llogari të rregulatorit. E vërteta është se tarifat në përdorim janë mjaft të reduktuara dhe, si të tilla, ka vend për t'u rivlerësuar, veçanërisht për ata subjekte që e ushtrojnë veprimtarinë në zona me dendësi të madhe popullsie dhe me prani të ndjeshme të bizneseve në tërsi. Por, për fat të keq, ka operatorë, madje edhe me shtrirje kombëtare, që krijojnë marrëdhënie financiare jokorrekte me institucionin rregulator, vonesa të pajustifikuara në pagesa, çka, përveç pasojave që sjell, reflekton mendësi që tashmë do të ishte e udhës të shiheshin si të kapërcyera.

5.2 Lidhur me bilancet e operatorëve radio e televizivë

Siç dihet, subjektet radiotelevizive kanë detyrim ligjor që bilancet e tyre t'i hartojnë në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe një kopje ta depozitojnë në KKRT. Për subjektet fizike, të cilët nuk hartojnë bilance, është paraparë nga rregulatori të depozitojnë disa të dhëna më të thjeshtëzuara për treguesit kryesorë ekonomikë të veprimtarisë që ata kryejnë. Megjithatë jo të gjithë i janë përbajtur kërkesës së ligjit për t'i paraqitur këto bilance. Po si paraqitet gjendja, në shqyrtim të tyre? Përgjithësisht subjektet Radio FM rezultojnë me rezultat financier zero, sa nuk mbulojnë shpenzimet

me të ardhurat. Diçka më ndryshe është për subjektet televizive, por dhe ato, ndonëse me rezultat financiar pozitiv, sillen me tregues fitimi relativisht të ulët.

Duke i shqyrtuar një nga një disa prej tyre, del se TV Arbëria, operator kombëtar, për tre vjet radhazi të shënojë humbje me 27, 25 dhe 59 milionë lekë, për Top Channel, pas dy viteve me humbje, thuhet se vetëm në 2004, del me bilanc pozitiv. Me humbje raportohen dhe Vizion +, Telesport, TV Koha etj. Por nga ana tjetër, në të dhënët që disponojmë duken qartë devijimet në treguesit financiarë nga njëri vit në tjetrin. Kësisoj, të ashtuquajturat humbje të reportuara, por edhe shifra të tjera që sillen meritojnë më shumë studim. Një studim mbi reklamën, në kuptimin e kohës televizive që zënë reklamat tregtare në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit e sidomos të ardhurat e përafërtë të realizuara nga reklamat, si burim kryesor i të ardhurave, të çon në përfundimin se pjesa më e madhe e televizioneve tona duhet të kenë një gjendje financiare të ndryshme nga sa raportohet.

Gjatë një muaji u monitoruan 10 televizione, ose 476 orë për secilin nga televizonet. Raportet midis kohës reklamë dhe kohës gjithësje të transmetimit variojnë nga 10 përqind, shifër që sillet thuajse tek të gjithë operatorët privatë, deri te 22.4 për qind, më e larta, TV Klan. Mbështetur në të dhënët që vetë subjektet raportojnë, si dhe në të dhëna të tjera krahasuese, duke bërë zbritje korrektuese deri në 60 për qind të shifrave fillestare, del se tregu i reklamës në median elektronike në Shqipëri nuk është aq i varfër nga ç'është servirur sa here e ka sjellë rasti. Në tërësi ai sillet tek 2.6 miliardë lekë, ose rrëth 21 milionë EURO.

Po sa janë raportuar në bilance? Shifrat janë shqetësuese. Të ardhurat nga reklamat nxjerre nga bilancet, me përjashtime të rralla, nuk shkojnë më shumë se 20-25 për qind. Madje në ndonjë rast edhe shumë më poshtë. Veçojmë TV Teuta, rast korrektese për t'u përshtendet, ku shifra që ky operator ka raportuar është në diferençë të ngushtë me çfarë del nga monitorimi. Në këtë vështrim, të ashtuquajturat humbje janë disa fish më të ulëta se të ardhurat e paraportuara. Shmangje fiskale në shifra që shkojnë më e pakta 30 milionë lekë e deri në 630 milionë, janë një object për të reflektoar, që nga operatori, irregulatori dhe strukturat financiare të shtetit. Të dhënët ua kemi vënë në dispozicion se cilët operator, të cilët janë ftuar në diskutim të përbashkët, sidoqë jo të gjithë i janë përgjigjur kësaj fteze. Ndërkohë në KKRT nuk ka pasur kurrëfarë reagimi kundërshtues. Për të dhënët është bërë me dije edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe organe të tjera. Ajo çfarë i intereson irregulatorit është reflektimi i menjëherëshëm në praktikën e mëtejshme, pasi shmangjet apo fshehja fiskale në një fushë si e mediave, veç të këqijave të tjera, ndikon më ndjeshëm se gjetkë në deformimin e tregut. Kemi besim se ky reflektim do të realizohet.

Por të dhënët sjellin edhe një fakt pozitiv. Eshtë krijuar një opinion se mjaft nga operatorët radio dhe televizivë janë të privilegjuar në treg për faktin se ata krahas veprimtarisë për të cilën janë licensuar kanë edhe veprimitari të tjera biznesi. Raportimet me humbje krijojnë idenë se media që ata zotërojnë financohet nga bizneset e tjera paralele dhe ajo kthehet kështu ne dobi të biznesit, duke u krijuar një pushtet i dyfishtë me ndikim edhe në politikë. Pavarësisht të vërtetave, si dhe nevojës për masa kufizuese, ajo çka rezulton është se media elektronike në të shumtën e herës, ndonëse me dendësi si rrallëkund, gjeneron me burimet e saj të brendshme, edhe pse trafiku, pirateria etj. janë duke u kufizuar ndjeshëm.

Në mbyllje të kësaj çështjeje, në raportin që vitin e shkuar KKRT i paraqiti Kuvendit, burimet e financimit të operatorëve, transparenca e tyre i quajti si sfidë për këtë vit dhe në të ardhmen. Në këtë sferë disi të nxeh të ne sapo kemi hyrë dhe do ta vazhdojmë më tej. Mundësi për këtë janë instrumentet ligjore që kemi në përdorim, si dhe propozimet për amendime të mëtejshme që ne i kemi paraqitur dhe besojmë se do të merren në konsiderate. Natyrisht kjo sferë kerkon bashkëpunime me institucione të tjera, siç janë ato fiskale, të cilat me siguri do të zhvillohen edhe më tej. Shpresojmë se sipërmarrje shoqëri anonime ose private do të reflektojnë duke iu gjendur me të dhëna KKRT, që janë jo thjesht në interes të vet po në interes të publikut.

6. PLANI I FREKUENCAVE

6.1 Hyrje

Sic është bërë e njojur, një nga vështirësítë kryesore në rregullimin e fushës së transmetimeve analoge tokësore në Shqipëri ka qenë mungesa e një Plani të Caktimeve Frekuencore dhe okupimi arbitrar i spektrit, përparrë krijimit të KKRT-së.

Plani i Rregullimit, i hartuar në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të Hartës së Frekuencave u konceptua si plani më i thjeshtë e më i realizueshëm për disiplinimin e përdorimit të spektrit, sidomos në zonat e mbingarkuara me sinjale analoge tokësore. Ai parashikonte vetëm migrimin e transmetuesve në një frekuencë tjetër, pa ndryshuar parametrat e tjerë të tij, si fuqinë e daljes së transmetuesit, drejtimin e antenave, etj. Për shndërrimin e Planit të Rregullimit në Plan të mirëfiltë frekuencash, ishte e domosdoshme llogaritja e parametrave të saktë të secilit caktim frekuencor, ekzistues dhe i planifikuar, dhe koordinimi me vendet fqinje, mbështetur në procedurat e përcaktuara nga Radio Rregulloret e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve. Vetëm në këtë mënyrë, operatorët shqiptarë mund të pajiseshin më frekuencia brenda standardeve teknike e të mbrojtura nga interferencat e dëmshme.

Ndërkaq, Konferanca e Radiokomunikacioneve (RRC-04, Gjenevë, Maj 2004) vendosi bazat për hartimin e Planit të Frekuencave Numerike të Rajonit, i cili do të miratohet nëpërmjet një marrëveshjeje të re (RRC-06). Marreveshja, e cila do te realizohet 45 vjet pas Marreveshjes se Stokholmit 1961, (ST-61) dhe do te nenen kruhet nga perfaquesuesit e te gjitha shteteve te zones se planifikimit, nga Britania e Madhe atlantik deri ne kufi me Mongoline, perben një eveniment me rendesi qe do te percaktoje zhvillimin e stabilizimin e transmetimeve numerike, qe do te zevendesojne transmetimet aktuale analoge brenda një periudhe qe do te percaktohet nga Konferanca.

Plani i ri do të jetë një kombinim i caktimeve frekuencore analoge ekzistuese me caktimet frekuencore numerike të reja, që do të bashkëjetojnë deri në fund të periudhës së tranzicionit. Me përfundimin e kësaj periudhe, që i korrespondon mbylljes së transmetimeve analoge, Plani i ri do të jetë plan krejtësisht numerik.

Në këto kushte, detyra për hartimin e planit të caktimeve analoge për Shqipërinë, u zgjerua me detyrën e hartimit të planit të caktimeve frekuencore numerike.

Teknologjia e transmetimeve tokësore numerike është një teknologji krejtësisht e re. Futja e kësaj teknologjie i gjeti administratat e të gjitha vendeve të papërgatitur për ta mbështetur me plane frekuencore. Për këtë arsy, ITU ka kohë që ka filluar përgatitjet për mbajtjen e RRC-06, që do të stabilizojet Planin e Frekuencave të Rajonit. Shqipëria

ndodhet në të njëjtat pozita me të gjitha vendet e tjera të rajonit, e ngarkuar nga Rezolutat e Konferencës RRC-04, të hartojë Planin për territorin e saj dhe ta koordinojë këtë plan me vendet fqinje.

Shqipëria nuk ka marrë pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes së ST 61.

Hartimi i Planit të Frekuencave Numerike të Shqipërisë, bazuar në standaret e përcaktuara nga RRC-04, pjesëmarrja aktive në diskutimet gjatë koordinimit me vendet fqinje, harmonizimi i interesave me ta nëpërmjet argumenteve të bazuara, mbrojtja e interesave të vendit gjatë zhvillimit të Konferencës, do të bëjë që Shqipëria të sigurojë resurse të spektrit të frekuencave në shkallë të njëjtë me vendet fqinje dhe të mjaftueshme për të përballuar një zhvillim të qëndrueshëm të transmetimeve numerike tokësore. Për të arritur këtë qëllim, një rëndësi të veçantë merr edhe përgatitja e delegacionit që do të përfaqësojë Shqipërinë në këtë konferencë tepër të rëndësishme.

6.2. Veprimtaria intersesionale (Midis RRC-04 dhe RRC-06)

Përgatitjet për Konferencën RRC-06, KKRT i ka filluar menjëherë pas përfundimit të RRC-04, ose siç quhet ndryshe, sesioni i parë i Konferencës. Me përfundimin e RRC-04, nga KKRT u përgatit informacioni dhe detyrat që shtroheshin për administratën shqiptare nga Rezolutat e miratuara të Konferencës. Informacioni u paraqit në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit, i cili adoptoi vendimin përkatës. Ndërkohë, ky informacion, së bashku me detyrat dhe Vendimin e KKRT-së, me letrën nr. 714, të datës 08.07.2004, është dërguar edhe në adresat e Ministrisë së Jashtme dhe Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

Theksojmë se, qysh në fillim të punës për zbatimin e detyrave të dala nga Konferenca e sipërpërmendor, por edhe nga veprimtari të mëvonshme, janë hasur vështirësi, sidomos në mbajtjen e kontakteve të rregullta me ITU dhe konkretisht BR (Byroja e Telekomunikacioneve e ITU-së) që është ngarkuar të udhëheqë teknikisht të gjithë procesin e hartimit të Planit të ri numerik deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së re.

Për shkak të mungesës së kontakteve, deri në disa data kritike, KKRT-së i ka munguar informacioni bazë i nevojshëm për fillimin e planifikimit. P.sh. përmarrjen e të dhënave të hyrjes (input requirement), BR përgatiti një soft të veçantë (Data capture software), të cilin ua dërgoi të gjitha vendeve të rajonit të planifikimit. Ky software u dërgua edhe në Shqipëri, por ai nuk mbërriti në KKRT. Një gjë e tillë ka ndodhur me të gjitha LQ (Letër Qarkoret – Circular Letters) e lëshuara nga BR, që përmbanin njoftime të rëndësishme e udhëzime të vlefshme për procesin e planifikimit. Nuk duhet harruar se teknologjia numerike është e re dhe për të hartuar një plan numerik, kërkoheshin njohuri të specializuara, për pervetësimin e të cilave ITU ka organizuar edhe seminare të ndryshme, ku, përmungesë informacioni, specialistët e KKRT-së nuk kanë marrë pjesë.

Për të shmangur këtë mangësi dhe për të fituar kohën e humbur janë bërë përpjekje të mëdha për të hyrë në kontakt me ITU-në dhe BR-në. Në këtë kontekst, është dashur të bëhen, më së fundi, sqarimet përkatëse edhe nga ana e Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve për faktin se, KKRT, me ligj është përgjegjëse edhe për administrimin e frekuencave radiotelevizive. Tashmë, marrëdhëniet janë më të stabilizuara dhe vendi ynë, përmes këtij institucioni është duke u përfaqësuar në veprimtaritë e zhvilluara në fushën përkatëse.

6.2.1. Takimet dypalëshe e shumëpalëshe

(Parakoordinimi)

Në periudhën midis dy seshioneve (RRC-04 deri në RRC-06), bazuar në rezolutat e seshionit të parë, nga të gjitha administratat e shteteve anëtare brenda zonës së planifikimit është zhvilluar një veprimtari intensive për të hartuar planin e koordinuar të frekuencave për transmetimet numerike tokësore të rajonit.

Veprimtaria intersessionale është zhvilluar sipas fazave të përcaktuara nga rezolutat e RRC-04 dhe me asistencë të BR (Byrosë së Radiokomunikacioneve të Bashkimit Ndërkombetar të Telekomunikacioneve).

Ky proces u realizua nëpërmjet takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe midis shteteve në bazë të nëngrupeve të përcaktuara sipas përkatësisë gjeografike. Shqipëria ka marrë pjesë në takimet e organizuara nga dy grupe parakoordinuese; **grupi i vendeve të Ballkanit** (Shqipëri, Bullgari, Rumani, Maqedoni, Serbi-Mali i Zi, Turqi) dhe **grupi i Adriatikut** (Shqipëri, Austri, Itali, Mali i Zi, Kroaci, Slloveni).

Nëpërmjet pjesëmarjës aktive në takimet e organizuara u bë e mundur të sigurohet informacioni bazë dhe një ekspertizë e mjaftueshme për të ndjekur zhvillimet. Një ndihmë të madhe kanë dhënë takimet dypalëshe parakoordinuese me Maqedoninë (2 takime), Greqinë (2 takime), Malin e Zi (1 takim) e Italinë (1 takim), ku është këmbyer informacioni, eksperienca, software-i, etj. Takimet janë zhvilluar në përputhje me rezolutat, rekomandimet dhe nxitjet e ITU-së që e sheh rrugën e takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe si një nga rrugët më efikase për arritjen e kompatibilitetit të caktimese frekuencore numerike në rajonin e planifikimit.

Krahas takimeve dypalëshe janë zhvilluar takimet e Grupit të Adriatikut (3 takime, ku KKRT është përfaqësuar dy herë) dhe të Grupit të Vendeve të Ballkanit (2 takime, përfshirë takimin final të zhvilluar në Sofje, më 12-14 Tetor 2005).

Veçojmë faktin se, në takimet dypalëshe të zhvilluara me Greqinë dhe Maqedoninë, është kryer koordinimi i caktimese frekuencore analoge dhe i caktimese frekuencore numerike, ndërsa me Malin e Zi dhe Italinë, me insistimin e tyre, është kryer vetëm koordinimi i caktimese frekuencore numerike.

6.2.2. Përgatitja e të dhënave të Shqipërisë për ushtrimin e parë të planifikimit

Sipas rezolutave të RRC-04, nga administratat e Shteteve Anëtare (pra dhe nga Shqipëria) për të përgatitur planin e ri numerik të rajonit, duhej të paraqiteshin në BR (Byronë e Radiokomunikacioneve të ITU-së), brenda 28 Shkurtit 2004:

- Informacion mbi gjendjen ekzistuese dhe të planifikuar të caktimese frekuencore analoge të transmetimeve (radio dhe televizive);
- Informacion mbi gjendjen ekzistuese dhe të planifikuar të caktimese frekuencore numerike të transmetimeve (radio dhe televizive);
- Informacion mbi gjendjen ekzistuese dhe të planifikuar të caktimese frekuencore të shërbimeve të ndryshme nga transmetimet rtv.

Rezolutat përcaktojnë analizimin e këtyre të dhënave nga BR, në dy faza:

- **Në ushtrimin e parë të planifikimit**, rezultatet e të cilët u analizuan në mbledhjen e IPG-1 (Mbledhja e parë e Grupit Intersessional i Planifikimit), dhe
- **Në projektplanin** i cili do të diskutohet në IPG-2 (shkurt 2006) dhe më pas, do të paraqitet për miratim në RRC-06 për t'u shndërruar në planin e frekuencave numerike për zonën e planifikimit.

6.2.2.1. Projektplani i Caktimeve Frekuencore Numerike të Shqipërisë i paraqitur në Ushtrimin e Parë të Planifikimit

Përgatitja e të dhënave për Planin e Frekuencave Numerike të Rajonit, kërkonte paraprakisht hartimin e Planit Shqiptar të Frekuencave Numerike. Për hartimin e këtij plani, fillimi si u studiuua territori i Shqipërisë. Bazuar në dimensionet e kufizuara të territorit, si dhe të konfiguracionit të thyer të terrenit, u konkludua se tipi më i përshtatshëm i rrjetit SFN do të ishte RN2, që presupozon një diametër të zonës së mbulimit prej rrjeti 50 km^3 (ndryshe nga RN1 me diametër 140 km). Më pas, bazuar kryesisht në parametrat e pranuara bashkërisht nga administratata ballkanike në mbledhjen e Sofjes, u bë projektimi i zonave të allotimit (zona që do të mbulohen nga një rrjet SFN). Këto zona, u përcaktuan edhe duke marrë parasysh ndarjen administrative të Republikës së Shqipërisë. Rregulli që u përdor ishte mundësish përputhja e zonës së allotimit me territorin e një qarku me synim që të krijojen mundësitet për ndërtimin e rrjeteve numerike vendore me zonë licencimi 1 qark. Eshtë e kuptueshme se nuk mund të pretendohet për një përputhje të plotë të ndarjes administrative me zonat e mbulimit të transmetuesve. Për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe madhësisë së zonave të allotimit (që synohet të jetë afërsisht e barabartë) u krijuan 11 zona allotimi nga 12 Qarqe të vendit (shih figurën në Aneksin 4).

Plani i ri numerik, i paraqitur në ushtrimin e parë të planifikimit, parashikon të kombinojë 11 rrjetet SFN (Single Frequency network-Rrjet me Frekuencë të Vetme), për të krijuar një rrjet k-SFN (në këtë rast k=11), ose një rrjet MFN (multi frequency Network) për mbulimin e territorit të Shqipërisë.

Siq rezultoi nga mbledhja e zhvilluar në Sofje, numri 10 i kërkesave për mbulim kombëtar i bërë nga Shqipëria, rezultoi numri më i lartë i mbulimeve të këruara. Kërkesat e vendeve të tjera shkonin nga 4 në 8 mbulime kombëtare (Pas IPG-1, të gjitha vendet i rritën kërkesat për mbulime kombëtare). Projektplani i caktimeve frekuencore numerike të Shqipërisë për ushtrimin e parë të planifikimit u paraqit në ITU në format elektronik standard. Në Aneksin 4 pasqyrohen të dhënat e projektplanit te paraqitur.

6.2.2.1.2 Mbrotjtja e transmetimeve analoge

Informacioni mbi transmetimet analoge është një moment shumë i rëndësishëm gjatë hartimit të planit të frekuencave numerike, pasi shërbimet ekzistuese të transmetimit analog duhen mbrojtur nga interreferencat e transmetimeve të reja numerike në të dy nivelet: kombëtar dhe ndërkombe. Bazuar në aktet e RRC-04, **në nivel ndërkombe caktimet frekuencore analoge ekzistuese dhe të planifikuara do të mbrohen vetëm nëse ato janë të regjistruara në MIFR (Regjistri kryesor Ndërkombe i Frekuencave), në përputhje me procedurat e fiksuar në ST61.** Me fjalë të tjera, nëse një caktim shqiptar është i regjistruar në MIFR, në planin e ri, kanali që ai okupon **nuk do të planifikohet për t'u përdorur** për transmetimet analoge apo numerike, si nga Shqipëria, ashtu edhe nga vendet e tjera ku arrin sinjali (brenda distancës së koordinimit të përcaktuar nga ST61).

Shqipëria nuk e ka nënshkruar Marrëveshjen ST61. Ajo ka të regjistruara në MIFR vetëm 4 caktime, nga të cilat 3 në VHF (Kukës, Tiranë e Pogradec) dhe 1 në UHF (Tiranë). Kjo gjendje e vë Shqipërinë në pozicion shumë të vështirë për të mbrojtur

³ Shih RRC-04, Gjenevë, 2004

transmetimet e saj analoge televizive, të cilat aktualisht përbëhen nga rreth 210 caktimes frekuencore ekzistuese dhe të planifikuara. KKRT, ka paraqitur zyrtarisht gjendjen e transmetimeve televizive analoge në ITU, por siç u vërtetua më pas, ato nuk janë marrë parasysh në ushtrimin e parë të planifikimit, pasi për regjistrimin e tyre në MIFR duhej një procedurë e gjatë dhe e komplikuar (në zbatim të nenit 4 të Marrëveshjes ST61).

Mbrojtja e transmetimeve analoge ekzistuese do të ketë efekt vetëm gjatë periudhës së tranzicionit, që fillon nga momenti i fillimit të funksionimit të rrjetit të parë numerik e deri në mbylljen e plotë të transmetimeve analoge. Kohëzgjatja e periudhës së tranzicionit është një nga çështjet që do të diskutohen dhe do te vendosen gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së re RRC-06 dhe revizionimit të marrëveshjeve ST-61 dhe GE 89. Në mbledhjen e RPG, (shih 5.2.8), për mbylljen e transmetimeve analoge u diskutuan dy data 2015 dhe 2025. Opinionet e vendeve të zhvilluara (CEPT) anojnë më shumë drejt përcaktimit të një periudhe tranzicioni sa më të shkurtër.

Çështja e regjistrimit të përshtypetar të caktimese analoge shqiptare në MIFR u trajtua edhe në takimin e veçantë që Kryetari i KKRT-së zhvilloi me Drejtorin e Departamentit të Shërbimeve Tokësore të BR, z. Trajco Gavrilov.

Duke qenë se regjistrimi i caktimese frekuencore varet nga koordinimi me fqinjët, gjatë fazës së dytë të parakoordinimit u zhvillua një punë intensive që u kurorëzua me pranimin reciprok të caktimese frekuencore analoge me Greqinë dhe Maqedoninë. Dokumentacioni përkatesë është dërguar në BR dhe është pranuar prej saj, dhe përbën një premisë për regjistrimin e caktimese në MIFR. Përpjekjet e KKRT-së për të realizuar koordinimin edhe me Italinë, Malin e Zi dhe Serbinë, nuk kanë përfunduar me sukses, ndonëse dokumentacioni përkatesë konform standardeve të ITU-së është drejtuar më se dy herë në adresë të tyre.

6.2.3. Zhvillimi i Mbledhjes së parë të Grupit Intersesional të Planifikimit (IPG-1)

IPG-1 (Intersessional Planning Group) i zhvilloi punimet prej datës 04.07.05 deri në 08.07.05, në Gjenevë, bazuar në të njëjtat kritere përfaqësimi si edhe RRC-04.

Në mbledhjen e IPG-1, mori pjesë dhe një delegacion i KKRT-së si përfaqësues i administratës shqiptare. Në këtë mbledhje u diskutuan rezultatet dhe eksperientat e ushtrimit të parë të planifikimit, të metat e vërejtura, dhe u përgatitën udhëzime përikompozimin e planeve të dërguara nga secili vend, për hartimin e projektplanit të caktimese frekuencore të rajonit.

Si konkluzion kryesor, nga drejtuesit u deklarua se **rezultatet** (e ushtrimit të parë të planifikimit) **ishin më të ulëta se ç'pritej, pasi për një numër të madh kërkesash nuk u gjenden kanale**. Kryetari i IPG-së i nxiti administratat **të rishikojnë disa nga kërkesat e tyre, me qëllim që të përmirësohet rezultati i përgjithshëm**.

Hollësi mbi zhvillimin e Mbledhjes së parë të Grupit Intersesional të Planifikimit (IPG-1) jepen në Aneksin 4/1.

6.2.4. Deklaratat administrative

Për të lehtësuar procesin e planifikimit, RRC-04 rekomandon që, gjatë koordinimit të përdorimit të frekuencave midis vendeve fqinje, të përdoren “deklaratat administrative”. Me anë të deklaratave administrative, një vend pranon se ai nuk pëson

interferencia të dëmshme nga një apo shumë caktimes frekuencore të një vendi tjetër. Lëshimi i deklaratave administrative reciproke e thjeshton procesin e koordinimit të frekuencave.

Deklaratat administrative të dërguara nga KKRT dhe vendet e tjera pas ushtrimit të parë të planifikimit, e lehtësuan situatën duke krijuar më shumë kanale për t'u përdorur.

6.2.5. Aplikimi i parimit të Aksesit të barabartë

Duke marrë në konsideratë numrin e madh të kërkesave për frekuencia nga të gjitha shtetet, i cili u përcaktua si një nga shkaqet e rezultateve të dobëta të ushtrimit të parë të planifikimit, si dhe detyrimin e Konferencës për të krijuar kushte për një shfrytëzim të njëjtë të burimeve natyrore për të gjitha shtetet pjesëmarrëse, ne mbledhjen e IPG-1, nga të gjitha administratat u diskutua gjërësisht mbi vodosjen e kritereve të drejta për të realizuar akses të barabartë.

Pas debateve të shumta është arritur formulimi i mëposhtëm i parimit të Aksesit të barabartë: "Në drejtimin e procesit të mëtejshëm të planifikimit, PXT instruktohet, në bazë të kërkesave të paraqitura nga administratat, të bëhen të gjitha përpjekjet e mundura për të siguruar një minimum prej:

- 4 deri në 7 shtresa (layers) mbulimi me multiplekse në Bandat IV-V per DVB-T;
- 1 shtresë mbulimi për DVB-T, dhe 3 shtresa mbulimi me multiplekse për T-DAB në bandën III, ose 2 shtresa mbulimi me multiplekse për DVB-T dhe asnjë shtresë për T-DAB në Bandën e III; *dhe /ose* një numër të arsyeshëm të caktimeseve dhe/ose allitimeve», për secilin dhe çdo vend brenda zonës së planifikimit.

Kërkesa e paraqitur nga KKRT për BR për ushtrimin e parë të planifikimit është për krijimin e 10 rrjeteve kombëtare. Kjo kërkesë është bazuar në materialin e Projektit të Strategjisë së Zhvillimit të transmetimeve numerike tokësore në Shqipëri, miratuar kohë më parë në KKRT. Bazuar në parimin e aksesit të barabartë, Shqipërisë mund t'i caktohet një numër deri në 7 mbulime (rrjete) kombëtare në brezin UHF dhe 1 rrjet në VHF.

6.2.6. Dërgimi i të dhënave për projektplanin

Kjo fazë përfundoi më 31 Tetor 2005, duke u dërguar në adresë të BR, nga të gjitha vendet e zonës së planifikimit, kërkesat për caktime frekuencore numerike të korrigjuara, sipas konkluzioneve të IPG-1 dhe rezultateve të raundit të dytë të takimeve dypalëshe dhe shumëpalëshe për caktime frekuencore numerike.

6.2.6.1. Projekt Plani i Caktimese Frekuencore Numerike të Shqipërisë i paraqitur në Ushtimin e Dytë të Planifikimit (draft plani)

Projekt Plani i Caktimese Frekuencore Numerike, i paraqitur nga KKRT për ushtrimin e Dytë të Planifikimit (Draft Plani), ndryshe nga projekt plani i parë i paraqitur në § 4.2.2.1. është plotësish i koordinuar përkatësisht me vendet që përfshihen në grupin e Adriatikut dhe ato që përfshihen në grupin e Ballkanit. Koordinimi është realizuar përkatësisht në mbledhjet e Zagrebit, Vjenës dhe Lubjanës (për grupin e Adriatikut) dhe mbledhjen e Sofjes (12-14 Tetor 2005), për grupin e vendeve të Ballkanit.

Në takimin e Sofjes, mbështetur edhe në rezultatet e koordinimit të grupit të Adriatikut, u përgatit një plan i parakoordinuar i përdorimit të frekuencave numerike në

rajonin e Ballkanit, i miratuar nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, të cilat u angazhuan që kërkesat e hyrjes për hartimin e draft planit, të hartoheshin në përputhje me planin e miratuar.

Bashkëngjitur këtij materiali është edhe pëllimi i parakoordinuar i përdorimit të frekuencave numerike në rajonin e Ballkanit, ku paraqitet kanal për kanal shpërndarja e frekuencave numerike, ashtu siç u miratua në takimin e Sofjes, (Aneksi 4/2).

6.2.6.2. Të dhënët përfundimtare të hyrjes (Dërguar në BR më 31.10.2005)

Të dhënët që u dërguan në BR më 31 Tetor 2005 (të formatuar sipas softit të përgatitur nga BR), janë rezultat i punës disa mujore përgatitore për evitim e të metave që rezultuan nga ushtrimi i parë i planifikimit.

Me evitim e te metave qe u konstatuan ne mbledhjen e IPG-1, si dhe me plotësimin e **Deklaratave Administrative**, të cilat janë planifikuar të dërgohen në BR më 28 Janar 2006 (afati i përcaktuar nga BR), Shqipërisë do t'i krijohen mundësi për të ndërtuar rrjete numerike që do të realizojnë të paktën **7 mbulime kombëtare DVB-T në brezin UHF, 1 mbulim kombëtar DVB-T në VHF dhe 1 mbulim kombëtar me T-DAB**, po në VHF. Plani parashikon gjithashtu 7 mbulime shtesë për një suballotment të veçantë në rajonin e Tiranës.

6.2.6.3.1. Karakteristikat e rrjetit

Projekt plani parashikon që karakteristikat teknike të rrjeteve mbeten:

1. Tipi i Rrjetit (për allotment):	SFN/MFN
2. Diametri mesatar i allotmenteve:	50-60 km
3. Varianti i Sistemit:	C2
4. Rrjeti Reference:	RN2
5. Tipi i modulimit:	64 QAM
6. Tipi i marrjes:	fiks/mobile
7. Distanca mesatare e ripërdorimit:	60 km
8. Intervali mbrojtës:	1/4
9. Code rate:	2/3
10. Numri i mbartëseve:	8k
11. Rasteri per DVB-T në Bandën III:	7 MHz

6.2.6.3.2. Zonat e allotimit dhe frekuencat

Pas rishqyrtimit të planit, sipas rekomandimeve të IPG-1, KKRT konkludoi:

Rrjeti reference që do të përdoret do të jetë RN2, si me i pershtatshmi per territorin shqiptar. Ne kete menyre nuk lindi nevoja të ndryshohet madhësia e zonave të allotimit në krahasim me variantin e parë të dërguar në 28 Shkurt 2005. Janë ndryshuar vetëm dimensionet e allotmenteve SH AL001D dhe KU AL 002D për efekt të futjes së pikës së transmetimit Mide në zonën e allotmentit të Kukësit. Kjo pikë e lartë do të shërbejë si pika ku do të instalohen transmetuesit kryesorë si të allotmentit SH, ashtu dhe të allotmentit KU. Përfundimisht, territori i Shqipërisë do të ndahet në 11 zona allotimi, siç u paraqit edhe në variantin e parë. Për të rritur mundësitë e ndërtimit të rrjeteve numerike për zonën e Tiranës, në kërkesat finale janë parashikuar edhe 8 mbulime për këtë zonë, duke krijuar **sub-allotmentin e Tiranës**, që nuk ishte parashikuar në variantin e parë.

Zonat e allotimit dhe suballotimit, si dhe frekuencat përkatëse jepen në figurat që vijojnë (fig. 1, fig. 2 dhe fig. 3).




Fig.1 Zonat e Allotimit për DVB-T në bandat VHF/UHF

ALB - DIGITAL REQUIREMENTS

Fig.2 Frekuencat sipas Zonave të Allotimit për DVB-T në bandat VHF/UHF



Fig.3 Zona e Allotimit dhe blloku i Frekuencat për T-DAB në bandën VHF

6.2.6.3.3. Të dhënat e caktimeve analoge për krijimin e gjendjes referencë

Në të njëjtën kohë me hartimin e planit numerik, është punuar edhe për koordinimin e caktimeve tv analoge për krijimin e gjendjes referencë, për të dërguar të dhënrat sipas afatit të përcaktuar nga COM 5/1, që ishte po 31 Tetori 2005. Kjo detyrë është zbatuar plotësisht me administratën greke dhe atë maqedonase, ku tashmë ekziston një dokumentacion i plotë e i pranuar nga të dy palët, i shfrytëzimit të spektrit të frekuencave në rajonet kufitare. Ky dokumentacion, i plotësuar sipas formatit të ITU-së (përfshirë dhe formularët T02) është dërguar BR dhe të gjitha vendeve fqinje. Një koordinim i tillë nuk u realizua me Italinë, Malin e Zi dhe Serbinë, të cilat u fokusuan kryesisht në hartimin e planit numerik dhe nuk dhanë disponibilitetin e duhur për koordinimin edhe të caktimeve analoge.

Në veçanti, Administrata italiane kërkoi zyrtarisht zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesave tona me justifikimin se ishte një periudhë e ngarkuar. Zgjatje e afatit do të thoshte mosrespektim i afatit të vendosur nga RRC-04, për fiksimin e gjendjes referencë. Kjo do të thotë se administrata italiane nuk ishte e interesuar të realizonte koordinimin e caktimeve analoge.

Sidoqoftë, edhe pa koordinimin me disa vende fqinje, KKRT do të ndërmarrë hapa për mbrojtjen e transmetimeve analoge të operatorëve shqiptarë gjatë gjithë periudhës së tranzicionit. Një rrugë për të realizuar mbrojtjen do të jetë futja e parametrave të caktimeve analoge në maskën e caktimeve numerike të planit të ri që do të miratojë Konferenca RRC-06.

I gjithë informacioni mbi gjendjen e caktimeve frekuencore të transmetimeve analoge, ekzistuese dhe të planifikuara në Shqipëri, i është përcjellë BR-së duke përdorur formatet standarde të kërkua nga BR (filat **TVA**).

6.2.6.3.4. Vazhdimi i punës për hartimin e planit të frekuencave numerike

Rezultatet e punës për hartimin e projektplanit të frekuencave numerike do të paraqiten nga BR në mbledhjen e dytë të IPG-së, e parashikuar të mbahet në Gjenevë nga muaji Shkurt 2006 dhe ku, në funksion të këtyre rezultateve, do të përcaktohen masat dhe ecuria e mëtejshme deri në nënshkrimin e marrëveshjes, parashikuar për në muajin Maj 2006.

6.2.7. Deklaratat Administrative për ushtrimin e dytë të planifikimit (draft planin)

Për të siguruar kompatibilitet të plotë të projektplaneve të dërguara nga secili vend, është i domosdoshëm plotësimi i **deklaratave administrative**. Kjo do të thotë që secila kërkesë numerike e dërguar nga administrata e një vendi do të deklarohet reciprokisht kompatibël me secilën nga kërkesat e administratës korresponduese fqinje.

Përpilimi i deklaratave administrative për ushtrimin e dytë të planifikimit (draftplanin) përbën një volum të konsiderueshëm pune, që duhet të përfundojë deri në **27 Janar 2006**, siç është përcaktuar nga Vendimet e IPG.

6.2.8. Mbledhja e RPG

Në zbatim të Rezolutës COM 5/1 të miratuar nga sesioni i parë (RRC-04), për organizimin e veprimitarive intersesionale përgatitjen e marrëveshjes së re, prej datës

03.12.2005 deri në datën 09.12.2005, në Gjenevë u zhvillua mbledhja e Grupit Rregulator Procedural (RPG).

Në mbledhjen e RPG-1, kryesisht u diskutua “projekt shembulli i tekstit rregulator”, që do të përbëjë bazën prej nga do të fillojnë diskutimet për marrëveshjen e re. Siç shihet, në këtë fazë evitohet përdorimi i termave më direkte si “projekt marrëveshja e re RRC-06”, pasi ligjërisht projekt i presupozohet të propozohet e të miratohet në nivelin më të lartë vendimmarrës, që është vetë Konferanca.

Detajet mbi mbledhjen e RPG-së jepen në Aneksin 4/4.

6.2.9. Zhvillimi i Mbledhjes së dytë të Grupit Intersesional të Planifikimit (IPG-2)

IPG-2 (Intersessional Planning Group) është planifikuar t'i zhvillojë punimet në Gjenevë në muajin Shkurt 2006, bazuar në të njëjtat kritere përfaqësimi si edhe RRC-04. Në këtë mbledhje do të paraqiten rezultatet e të dhënavë të hyrjes për projektplanin, të dërguara në datën 31 Totor 2005.

6.3 Konferanca Rajonale e Radiokomunikacioneve (RRC-06)

Konferanca Rajonale e Radiokomunikacioneve (RRC-06) do të mblidhet në Gjenevë, duke filluar nga 15 Maji deri 16 Qershor 2006.

6.3.1 Përgatitjet e Administratës shqiptare për Konferencën Rajonale të Radiokomunikacioneve

Në sesionin e parë të Konferencës Rajonale të Radiokomunikacioneve (RRC-04), me mandat plotfuqishmëri të nënshkruar nga Ministri i Jashtëm, administrata shqiptare është përfaqësuar nga një delegacion i përbërë nga përfaqësues të KKRT-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të PT në Ministrinë e atëhershme të Transportit dhe Telekomunikacioneve, i kryesuar nga Kryetari i KKRT-së.

Korrespondencia me Ministrinë e Jashtme për procedurat e mandatimit është këmbyer nga Drejtoria e Përgjithshme e Postë Telekomunikacionit.

Në kuadrin e përgatitjeve për të marrë pjesë në këtë konferencë të rëndësishme që do të vendlodë bazat përfaqësues të një delegacioni i përbërë nga përfaqësues të KKRT-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të PT në Ministrinë e atëhershme të Transportit dhe Telekomunikacioneve, i kryesuar nga Kryetari i KKRT-së.

Mendimi i KKRT-së është që delegacioni të përbëhet nga përfaqësues të organeve shtetërore (drejtues të niveleve të ndryshme të Dikastereve si Ministria e Jashtme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve, KKRT dhe Enti Rregulator i Telekomunikacioneve).

Në mbledhje mund të marrin pjesë (jashtë përbërjes së Delegacionit), përfaqësues të organizmave apo institucioneve të tjera, si shoqatat e mediave, etj).

Gjatë përgatitjeve të delegacionit, do të jetë e nevojshme të përcaktohen në përgjithësi qëndrimet përfaqësuese të çështjet e diskutueshme me karakter strategjik, që janë parashtruar në Informacionin bashkëngjitur për zhvillimin e RPG, si:

- Procedura lidhur me modifikimet e Planeve dhe koordinimi i shërbimeve të tjera primare tokësore;
- Notifikimi i Caktimeve Frekuencore;
- Kohëzgjatja e periudhës së tranzicionit (Viti 2015 apo 2025);

d. Hyrja në fuqi e marrëveshjes dhe fshirja e të gjitha caktimeve që nuk figurojnë në Plan. (Viti 2007), etj.

Për të diskutuar për problemet e shtruara më sipër, KKRT ka planifikuar, duke filluar nga muaji shkurt 2006, një seri takimesh me të gjitha organet shtetërore që kanë lidhje me problemin për të diskutuar dhe për të përcaktuar qëndrimin e Administratës shqiptare në Konferencë.

7. PERPJEKJET PER RREGULLIME TE METEJSHME LIGJORE

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, në zbatim të detyrave të veta rregullatore është përqëndruar kryesisht që veprimitaria e operatorëve të medias elektronike të zhvillohet korrektësisht në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe me atë të medias elektronike më në veçanti. Ecuria mund të konsiderohet pozitive në kuptimin se vetë operatorët tashmë janë më të ndërgjegjshëm se rruga e ligjit është e vëtmja rrugë e dobi shme në një vështrim afatgjatë dhe se ky opinion po bëhet sa vjen e më zotëruesh në shumicën e operatorëve.

Por, veç sa sipër, KKRT ka këmbëngulur dhe është duke këmbëngulur ende që të shfrytëzojë mundësitë e veta ligjore përsa i përket të drejtës për të propozuar projektligje apo përmirësimë të pjesshme në legjislacionin e fushës. Në këtë pikëpamje vlerësojmë se marrëdhëniet me komisionin përkatës në Kuvend kanë qenë të afërtë dhe përgjithësisht inkurajuese. Dy iniciativa meritojnë vëmendje, çka përbën sot edhe pjesën më preokupante në veprimitarinë e institucionit. Për fat të mirë, këto projektligje nuk janë të asaj kategorie që prekin çështje të diskutueshme që kanë të bëjnë me lirinë e medias dhe raportet me kategoritë e tjera të lirisë, gjë që bëhet e ndjeshme sa herë diskutohet për këtë temë. Të dy projektet kanë karakter rregulator dhe të aplikuar gjerësisht nga të tjerët përreth nesh e kësijoj në standartet tashmë të njohura.

Njëri projekt përban amendime të Ligjit 8410 dhe kryesisht janë përshtatjet me dokumentet ndërkombëtare siç është Konventa për Televizonin Ndërkufitar dhe Protokollin Ndryshues të saj, si dhe disa masa në dobi të rritjes së transparencës për financimet, në ngushtimin e monopoleve për mediat elektronike etj. Por, duke mbajtur në vëmendje se një numër operatorësh janë duke e zhvilluar veprimitarinë e tyre jashtë zonave të licensimit, kryesisht në zona me dendësi të madhe popullsie dhe me prani të konsiderueshme të bizneseve dhe kjo gjendje e trashëguar prej vitesh po bëhet rënduese në raport me të tjerët, për shkak të pabarazisë fiskale; kjo situatë meriton vëmendjen e nevojshme për t'u zgjidhur. Trajtimet e diferencaura janë vdekjeprurëse për çdo biznes. Fusha delikate e medias e ndjen ndoshta më shumë se cilado tjetër sa herë ndodhet në rrethana diferencause. Po të sjellim në vëmendje edhe faktin se operatorët në fjalë kanë përfunduar afatet ligjore të licencave të tyre, është e kuptueshme që kjo situatë do rregulluar, qoftë dhe për këtë arsy.

Projektligji tjetër është ai i transmetimeve numerike, për të cilin është diskutuar gjatë Iniciativa në Kuvend fillimisht është e një grupei deputetësh që në korrik 2004. Më tej u përfshinë edhe të tjerë. Me të drejtë Komisioni i atëhershëm për Mjetet e Informimit Publik kërkoi konsulencë dhe ekspertizë, duke iu drejtuar edhe organizmave të huaj monitorues në vendin tonë, siç është OSBE. Prania e OSBE-së u gjend e gatshme, ashtu si dhe herë të tjera, të japë ndihmën e vet duke thirrur ekspertë të fushës. Një grup që u ngrit aso kohe nga Komisioni, bashkë me këta ekspertë formatuan një projekt, i cili u

depozitua në Komision. Por, për fat të keq, në Komision ndodhi e papritura: projekt u deformua dhe i tillë iu paraqit Kuvendit në çastet e fundit të Legjislaturës. Ishte pozitive që shumica e deputetëve u orientuan drejt dhe nuk e pranuan këtë projekt, duke ia lënë atë Legjislaturës pasardhëse. Sot jemi duke pritur si do të vijojë procedura me këtë projektiligj. Duke iu shmangur çdo komenti për ligjin, tashmë nuk mund të vazhdojmë të quajmë sukses se nuk u miratua ai projekt. Fusha ka ardhur duke u rënduar dita ditës, sepse një biznes i madh mediatik është duke vepruar, pa asnje detyrim fiskal dhe paasnje kontroll mbi programet që emetohen dhe për të cilët shikuesit që i ndjekin paguajnë. Nevoja për të ndërhyrë tashmë mund të vlerësohet se i ka kapërcyer të gjithë parametrat. Vonesat janë duke u kthyer në komprometim.

Duke u ndalur në dy projektiligjet e mësipërme, KKRT beson se ndan të njëtin opinion sidomos me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, por edhe me deputetët e tjerë të Kuvendit, se nevoja për këto rregullime ligjore është bërë prej kohësh urgjente. Kësisoj shprehemi me bindje se jo vetëm gjemë mirëkuptim, por edhe gatishmëri për zgjidhjen e kësaj situate komprometuese.

8. BASHKEPUNIMI NDERINSTITUCIONAL

Sic është trajtuar në Raportin e vitit të kaluar, produktet e tregut mediatik gjëzojnë një status të veçantë dhe rregullimit e mbikqyrjes. Promovimit të tyre i kushtohet rëndësi e madhe në çdo vend. Prandaj, në këtë proces marrin pjesë shumë hallka të strukturës së shtetit: Parlamenti, Qeveria, organet e pavarura rregullatore, shoqatat e operatorëve, etj. Vetëm nëpërmjet një bashkëveprimi dinamik midis këtyre hallkave mund të arrihet sigurimi i vlerave thelbësore të një shoqërie demokratike që janë: pluralizmi, transparenca, mosdiskriminimi, mbrojtja e të drejtave të njeriut, të të miturve, mbrojtja e të drejtave të autorit, etj. KKRT e konsideron vehten vetëm si njérën nga hallkat e këtij mekanizmi që i siguron shoqërisë këto vlera thelbësore. Për këtë arsy, edhe gjatë vitit 2005, KKRT ka vazhduar përpjekjet për forcimin e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit me të gjitha strukturat e shtetit, si dhe me shoqatat e operatorëve.

8.1. Bashkëpunimi me Ministrinë e Integrimit Europian

Nën drejtimin e Ministrisë së Integrimit, KKRT ka marrë pjesë aktivisht në procesin e hartimit dhe vënies në zbatim të Planit të Veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve të Partneritetit Europian (PVZRPE), si dhe të Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit. Gjithashtu, KKRT ka ofruar kontributin sa herë që i është kërkuar në mbështetje të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim – Asocimit, për pjesët ku trajtohen çështje të rregullimit të mediave elektronike në përputhje me standarde europiane.

Në kuadrin e zbatimit të Planit të Përafrimit të Legjislacionit, KKRT ka paraqitur në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik propozimet për amendimin e Ligjit “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe për projektiligin “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike në Shqipëri”.

8.2. Bashkëpunimi me Ministrinë e Transporteve dhe Telekomunikacioneve

KKRT ka bërë përpjekje edhe për rritjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Transporteve dhe Telekomunikacioneve. Një shembull bashkëpunimi produktiv ishte dhe

miratimi, së bashku me specialistë të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, ERT, i amendimeve të propozuara për Planin Kombëtar të Radiofrekuencave. Sidoqoftë, vështirësitë që hasi KKRT për stabilizimin e kontakteve me ITU, evidentojnë se duhet investuar akoma në drejtim të stabilizimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm.

8.3. Bashkëpunimi me ERT

Për periudhen raportuese, KKRT ka forcuar bashkëpunimin me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve, organ rregulator që është dhe partneri kryesor në administrimin e frekuencave. Në vijim të bashkëpunimit të fryshtshëm janë zhvilluar matje me ekipe të përbashkëta dhe janë zgjidhur mjaft probleme të interferencave në brezat e frekuencave që administrohen nga ERT, duke shfrytëzuar dhe pajisjet teknike të KKRT-së.

Në vijim të punës për sistemimin e veprimitarisë së përdoruesve të radiofrekuencave, për shërbimet pikë-më-pikë të operatorëve radio e televizivë, (që administrohen nga ERT), ERT dhe KKRT kanë hasur vështirësi. Sikurse dihet, mjaft operatorë radio e televizivë e nisën aktivitetin në një situatë të parregulluar dhe më parë se ERT dhe KKRT të fillonin veprimitarinë e tyre rregullatore. Ashtu siç u veprua edhe me frekuencat e transmetimeve radio e televizive (që sipas ligjit administrohen nga KKRT), edhe për lidhjen e studiove me transmetuesit (shërbimet pikë-më-pikë që administrohen nga ERT), frekuencat u okupuan arbitrarisht duke përdorur edhe pajisje të vjetruara e jashtë standardeve teknike. Ndryshimet në ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë" (ligji nr. 8655, datë 31.07.2000, që kaloi administrimin e frekuencave për lidhjet pikë-më-pikë të operatorëve radio e televizivë në kompetencë të KKRT-së dhe ligji nr. 8794, datë 10.05.2001, që ia ktheu këtë kompetencë ERT-së), e komplikuani më shumë problemin, pasi për afërsisht një vit nuk u arrit një marrëveshje midis ERT dhe KKRT për caktimin e brezave për këto lloj transmetimesh. Vështirësi ka krijuar edhe vonesa në përcaktimin e brezave për këto lloj shërbimesh.

VKM nr. 379, datë 31.5.2001, që miraton Planin Kombëtar të Radiofrekuencave, ka vënë përpëra administratorëve të spektrit të radiofrekuencave (ERT dhe KKRT) detyrime me afat për harmonizimin e brezave dhe largimin nga brezat e paharmonizuar të radiofrekuencave të atyre operatorëve, që ishin evidentuar në kundërshtim me kërkasat e vendimit. ERT dhe KKRT, në bashkëpunim dhe veç e veç, kanë punuar për zbatimin e detyrave të vëna për harmonizimin e brezave dhe kanë arritur disa rezultate. Në vazhdën e masave të marra është edhe dokumenti i përbashkët "Procedura e caktimit të radiofrekuencave për shërbimet fikse dhe të lëvizshme të operatorëve radio dhe televizivë", nënshkruar më 8.04.2003. Megjithatë, duhet thënë se me gjithë përpjekjet e të dy palëve, progresi është i ngadalshëm. Shumë operatorë radio e televizivë të licensuar nga KKRT, që përdorin lidhje pikë-më-pikë, akoma përdorin radiofrekuencia të paharmonizuara dhe në kundërshtim me Planin Kombëtar të Radiofrekuencave. Problemi ndërlikohet nga ekzistenca e operatorëve radio apo televizivë që transmetojnë jashtë zonës së tyre të licencimit, të përcaktuar në licencën e lëshuar nga KKRT.

Sipas të dhënave, rezulton se janë 49 operatorë televizivë dhe 39 operatorë radio të licensuar nga KKRT, që përdorin radiofrekuencia për lidhjet fikse pikë-më-pikë. Këta operatorë përdorin gjithsej 206 lidhje fikse dhe të lëvizshme, nga të cilat 53 lidhje janë të konfiguruara në radiofrekuencia të harmonizuara me Planin Kombëtar të

Radiofrekuencave dhe 153 lidhje janë të konfiguruara në radiofrekuanca të paharmonizuara me këtë Plan.

Në zbatim të detyrimeve të saj dhe në zbatim të kërkesave të dokumentit të përbashkët, cituar më lart, ERT ka lëshuar deri tani Leje Përdorimi të Radiofrekuencave për lidhjet për 5 operatorë televizivë dhe 6 operatorë radio. Lëshimi i Lejes së Përdorimit për këta operatorë është bërë në përputhje me rrëgullat në fuqi dhe radiofrekuencat e dhëna për përdorim janë të harmonizuara me Planin Kombëtar të Radiofrekuencave.

ERT dhe KKRT, në zbatim të obligimeve të tyre ligjore, duke e vlerësuar seriozisht pajisjen e operatorëve me Leje të rregullt Përdorimi të Radiofrekuencave, janë përpjekur maksimalisht për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi të akumuluar ndër vite. Gjatë vitit 2005, KKRT, në mbështetje të ERT ka ndërhyrë pranë operatorëve të licencuar për t'i detyruar t'u përgjigjen detyrimeve ligjore për këto shërbime.

Por, nga ana tjetër, ERT dhe KKRT gjykojnë se mbyllja e menjëherëshme e stacioneve që okupojnë breza të paharmonizuara, do të krijonte shqetësimë e zhurmë mediatike me ngarkesa politike të panevojshme, që mund të evitohet nëse operatorëve u jepet një afat i arsyeshëm kohor për të liruar brezin e zënë pa autorizim, ashtu siç është vepruar edhe për brezin e frekuencave radio e televizive që administrohet nga KKRT.

Duke qenë se një pjesë e operatorëve radiotelevizivë të licensuar nuk mund të pajisen menjëherë me Leje të rregullt Përdorimi, gjyket si zgjidhje e mundshme, e pranuar nga të dyja palët pajisja me Leje të Përkohshme Përdorimi, duke lënë një afat kohor të mjaftueshëm për të përgatitur kushtet për largim nga radiofrekuencat e paharmonizuara.

Për të zgjidhur sa më shpejt këtë problem, të dy institucionet kanë ngritur një grup të përbashkët pune, i cili po punon intensivisht me synim që pajisja me Leje përdorimi të Përkohshme të përfundojë brenda muajit mars 2006.

Fusha e veprimtarisë rregullatore të KKRT, ndonëse nga koha në kohë është duke njojur zhvillime pozitive, gjithsesi ajo vazhdon të mbetët delikate dhe me problemet e veta të zhvilimit dhe maturimit. Këto probleme, si deri më tani, KKRT nuk i ka zgjidhur e as i zgjidh e vetme. Janë vetë operatorët radiotelevizivë, që kanë manifestuar vullnet në zbatim të ligjeve e rregullave, partnerët e parë në këtë veprimtari. Por, mbi të gjitha, është privilegji që ndryshe nga autoritetet e tjera rregullatore, ky institucion mban lidhje të drejtpërdrejtë me Kuvendin e Shqipërisë, përmes Komisionit të Edukimit dhe të Mjeteve të Informimit Publik, si dhe raporton para tij. Edhe raportimi i sivjetëm është një obligim serioz në zhvillim të përgjegjësive që institucioni ynë të kryejë edhe më mirë detyrat e veta në zbatim të ligjit.

ANEKSI 1

REALIZIMI I BUXHETIT PER VITIN 2005 DETYRIMET FINANCIARE

Departamenti Ekonomik e ka mbështetur punën e tij në zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera ligjore në fushën ekonomike dhe të financave.

1. Buxheti dhe realizimi i treguesve financiare

Me ligjin nr. 9339, datë 21.12.2004 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2005”, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit iu akorduan fonde nga buxheti i Shtetit në shumën prej 5 milion lekë në zërin “Shpenzime operative”.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me vendimin nr. 320, datë 28.01.2005 “Mbi miratimin e planit finanziar të vitit 2005”, miratoi treguesit finanziarë për vitin 2005: të ardhurat e shpenzimet.

	Në milion lekë
▪ Të ardhura	62.9
▪ Shpenzime	63.2

1.1. Të ardhurat

Për vitin 2005, të ardhurat e institucionit tonë janë parashikuar të realizohen në masën prej 63 milion e 100 mijë lekë, janë realizuar 41 milion e 800 mijë lekë me një mosrealizim në shumë absolute prej 21 milion e 300 mijë lekë, në përqindje 66.2.

Realizimi i të ardhurave sipas strukturës paraqitet si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Plan	Realizimi	Dif.	Në milion lekë
					%
1	Pagesa vjetore e licencës dhe pagesa per marrjen e licences, viti 2005	42	24.85	- 15.5	60
2	Pagesa vjetore e licencës diferencë nga viti 2004	13.6	12.7	- 0.9	93.3
3	Pagesa përpunimin e dokumentave të licencës	0.8	0.5	-0.3	62.5
4	Të ardhura nga agjenti tatimor	0.5	0.5	-	100
5	Të ardhura nga interesa bankare	1	1.4	+ 0.4	
6	Financime nga buxheti	5.2	5.2		100
	Gjithsej	63.1	41.8	- 21.3	66.2

1.1.1. Pagesat vjetore të licencave

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republiken e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimeve të KKRT-së, si dhe në mbështetje të treguesve të përcaktuar nga Departamenti Teknik, si zona e licensimit, numri dhe fuqia e transmetimit të pajisjeve të instaluara, Departamenti Ekonomik ka përllogaritur dhe ndjekur shlyerjen e detyrimeve financiare të licencës, si pagesat vjetore për licencë, pagesat për marrjen e licencave, si dhe taksat për shërbimet e transmetimeve rtv për vitin 2005.

Pagesat për licencë dhe pagesat për marrjen e licencës janë detyrime që kanë operatorët radiotelevizivë ndaj KKRT-së.

Pagesat për licencë janë pagesa vjetore, të cilat llogariten në bazë të zonës së mbulimit të përcaktuar në licencë.

Pagesat për marrjen e licencave janë pagesa që paguhen nga operatorët vetëm vitin e parë të licensimit, me vlerat 20.000 lekë për televizion dhe 15.000 lekë për radio.

Mbështetur në dokumentat bankare dhe mandatarkëtimet e depozituara pranë Departamentit Ekonomik, pagesa vjetore e licencës për vitin 2005 është realizuar si më poshtë:

Pagesat vjetore që paguajnë subjektet Radio FM dhe TV për vitin 2005, nga 41 milion e 29 mijë lekë janë realizuar 32.2 milion lekë me një mosrealizim në shumë absolute prej 8.8 milion lekë, ose 78.5 përqind. Tabela e mëposhtme:

Në mijë lekë

Pagesat për licencë	Taksat			
Subjektet	Plan	Real	Dif.	%
Operatorë FM	6.5	6	0.5	92.3
Operatorë TV	34.5	26.2	8.3	76
Gjithsej	41	32.2	8.8	78.5

Subjektet	Plan	Real	Dif.	%	Plan	Real	Dif.	%
Operatorë FM	6.5	6	0.5	92.3	1.9	1.6	0.3	84.2
Operatorë TV	34.5	26.2	8.3	76	11.4	6.7	4.7	58.2
Gjithsej	41	32.2	8.8	78.5	13.3	8.3	5	62.4

Për ndjekjen e detyrimeve financiare është hartuar plani i punës, së bashku me masat përkatëse për ndjekjen e detyrimeve.

Nga eksperiencia e viteve të kaluara, derdhja e këtyre detyrimeve vazhdon edhe përmuajt Janar-Shkurt të vitit pasardhës.

Realizimi i detyrimeve të pagesave të operatorëve si numër dhe ne vlefte absolute paraqitet sipas Pasqyrës nr. 1, në të cilën jepen të dhënat deri në datën 22 Janar 2006.

1.1.2. Detyrimet e pashlyera të pagesës së licencës për vitin 2004

Detyrimet e pashlyera të pagesës së licencës për vitin 2004 në shumën prej 13.6 milion lekë, janë arkëtar 12 milion e 853 mijë lekë. Mbeten pa u arkëtar 747.600 lekë. Në këtë shumë përfshihet detyrimi i pashlyer i subjekteve:

Radio Argjiropolos 29.3 nuk ka dalë në transmetim

TV ABC	91.5
TV Dibra	14.3 nuk është në transmetim
TV Malësia	71.5
TV Shijak	528.8
Diferenca të tjera	12.2

Shuma 747. 6

Nga ana e Departamentit Ekonomik, gjatë vitit 2005 është ndjekur me prioritet shlyerja e detyrimeve nga operatorët radiotelevizivë. Krahas praktikave shkresore, ku përfshihen shkresat me nr. 156 prot. datë 11.02.2004, nr. 1128 prot. datë 29.10.2004, nr. 1350 prot. datë 30.10.2004, nr. 253 prot. datë 21.03.2005, nr. 623 prot. datë 2.08.2005 dhe nr. 710 prot. datë 13.09.2005, kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me operatorët nëpërmjet kontakteve në vend, mesazheve elektronike, telefonit, faksit etj.

Janë përgatitur materiale dhe informacione në lidhje me detyrimet financiare të pashlyera për vitin 2004, materiale të trajtuar në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit në muajt Mars 2005, Maj 2005, Gusht 2005. Me këto subjekte është vepruar sipas detyrave të lëna nga Këshilli.

Për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet e vitit 2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizonit, në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, me vendimin nr. 371, datë 10.11.2005, "Mbi vlefshmërinë e licencës të disa subjekteve radiotelevizive private" bëri të pavlefshme licencën e këtyre subjekteve. Nga subjektet debitore, Radio "New Planet" pagoi detyrimet, ndërsa subjekteve të tjera iu la një afat 30 ditor.

1.1.3. Të ardhura të tjera nga burime të ndryshme

Nga pagesa për përpunimin e dokumentave të licencës për vitin 2005 janë arkëtuar 500 mijë lekë.

Në mbështetje të dispozitave ligjore për sistemin e taksave për derdhjet që janë bërë në buxhetin e shtetit, sipas aktraktave me Degën e Tatimeve në Tiranë, KKRT përfiton 5 përqind, shumë kjo e barabartë me 487.000 lekë.

Janë përfituar interesa bankare për fondet tona të depozituara në bankë, në shumën prej 1 milion e 400 mijë lekë.

Të ardhurat në shumën prej 200 mijë lekë janë detyrimet e paarkëtuara nga subjektet, të pagesave të licencës nga vitet e mëparshme. Në momentin e shqyrtimit të dosjeve të subjekteve, të cilët kërkonin të rilicensoheshin, në mbështetje të rregullores, iu është kërkuar subjekteve të bëjnë shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura nga vitet e kaluara.

Me ligjin nr. 9339, datë 21.12.2004 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2005", Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizonit iu akorduan fonde buxhetore në zërin "shpenzime operative" në shumën prej 5.2 milion lekë, fonde të cilat janë realizuar në masën e financuar.

1.2. Shpenzimet

Për zhvillimin e aktivitetit normal, gjatë vitit 2005 nevojiten gjithsej 63.2 milion lekë, të ndara si më poshtë:

• Shpenzime korrente	56.4 milion lekë
• Shpenzime për investime	6.8 milion lekë
Shuma gjithsej	63.2 milion lekë

Për vitin 2005 janë shpenzuar gjithsej 53 milion e 432 mijë lekë, nga të cilat në zërin “shpenzime operative” - 50 milion e 600 mijë lekë, dhe në zërin “investime” - 2 milion e 832 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve në kahasim me planin rezulton me një kursim në shumë absolute prej 9 milion e 800 lekë dhe në përqindje 84.5 %. Analiza e shpenzimeve, sipas strukturës, paraqitet si në vijim:

1.2.1 Shpenzime korrente

Janë shpenzuar rreth 53.4 milion lekë për përballimin e shpenzimeve të institucionit për vitin 2005. Struktura e shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Plan	Real	Dif.+ -	%
1	Fondi i pagave dhe honorare	25.5	25.2	- 0.3	98.8
2	Sigurime shoqërore	5	4.7	- 0.3	94
3	Fondi i veçantë shpërblime	4.9	3.4	- 1.5	70
4	Blerje materiale	4.5	2.3	- 2.2	51
5	Shpenzime për abonime, tel., postë, internet, riparime etj.	13	10	- 3	77
6	Shpenzime udhëtim e dieta	3.5	5	+ 1.5	142.8
	Gjithsej shpenzime korrente	56.4	50.6	- 5.8	89.7
7	Investime	6.8	2.8	- 4	41.1
	Gjithsej shpenzime	63.2	53.4	- 9.8	84.5

1.2.2. Shpenzime në zërin “Investime”

Për vitin 2005, në zërin “Investime” janë përdorur 2 milion e 832 mijë lekë, nga 6 milion e 800 mijë lekë, me një mosrealizim në shumë prej 3 milion e 968 mijë lekë, në përqindje 42%. Fondet janë përdorur kryesisht për blerje pajisjesh kompjuterike, zyre etj. Fondet e vëna në dispozicion për projektin “Monitorimi në distancë operatorëve rtv” në shumën prej 3 milion lekë, nuk janë përdorur.

1.2.3. Fondet e prokuruar

Në mbështetje të dispozitave ligjore për prokurimet janë realizuar 5 prokurime, në formë të kërkesës për kuotim 3, tender i hapur 2, me një fond prej 5 milion e 33 mijë lekë.

Prokurimet janë zhvilluar konform akteve ligjore, me një efektivitet ku për 1000 lekë të prokuruar janë kursyer 61 lekë.

1.2.4. Valuta jotregtare

Bazuar në urdhërat e dala për këtë qëllim, gjatë vitit janë përdorur 38.800 Euro, me kundërvlefjtë në lekë 4 milion e 800 mijë lekë, të detajuara si më poshtë:

Shpenzime për dieta akomodim	19558	Euro
Shpenzime biletë avioni	11042	Euro
Shpenzime kuotizacioni	7700	Euro
Taksë pjesëmarrjeje	500	Euro
Shuma	38.800	Euro

2. Taksat për shërbimet radiotelevizive

Ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për Sistemin e Taksave në Republikën e Shqipërisë” ngarkon Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e taksave nga operatorët për shërbimet radiotelevizive.

Në bashkëpunim me Departamentin Teknik (nga i cili janë përcaktuar numri dhe fuqia e transmetuesve dhe përsëritësave) janë llogaritur detyrimet që kanë operatorët radiotelevizivë për vitin 2005.

Taksat për shërbimet radiotelevizive për operatorët e trasmetimeve FM dhe TV janë arkëtuar 8.3 milion lekë nga 13.3 milion lekë të planifikuara, ose 62.4 përqind, diferençë prej 5 milion lekë.

Operatorët Radio FM kanë derdhur detyrimin për taksa, nga 1.9 milion lekë të planifikuara në 1.6 milion lekë, ose në përqindje 84.2, ndërsa operatorët TV, nga 11.4 milion lekë të planifikuara, kanë derdhur 6.7 milion lekë me një përqindje prej 58.2 përqind dhe diferençë prej 4.7 milion lekë.

2.1. Detyrimet tatimore dhe shumat e paguara nga operatorët radiotelevizivë (Tabelat bashkangjitur)

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 3, datë 18.01.2005 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” ku thuhet se “KKRT njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kur subjektet nuk paguajnë taksën vjetore të shërbimeve të trasmetimeve radiotelevizive...” është njoftuar zyrtarisht Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 828, datë 8.11.2005, për detyrimet e papaguara të taksës së shërbimeve radiotelevizive. Kjo Drejtori, me shkresën nr. 6281, datë 21.11.2005, na përgjigjet se janë urdhëruar Degët e Tatimeve në rrethe për vlejjen e menjëhershme të detyrimeve të taksave për shërbimet radiotelevizive. Pavarësisht nga njoftimi i bërë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nga ana jonë është komunikuar direkt me Degët e Tatimeve në rrethe, me shkresën nr. 828, datë 8.11.2005.

Gjithashtu janë organizuar **takime direkte** me përfaqësues të këtij institucioni për këtë problem.

Kjo situatë pasqyrohet në faqen tonë në internet, në adresën www.kkrt.gov.al në rubrikën Informacion, ku bëhet azhornimi i të dhënave periodikisht.

Për vitin 2005 janë derdhur në buxhetin e shtetit 9.7 milion lekë. Për derdhjet e kryera në buxhetin e shtetit është bërë aktrakordimi me Degën e Tatim Taksave Tiranë.

Në momentin e rilicensimit të subjekteve në mbështetje të Rregullores së KKRT-së nuk është përpunuar asnjë dosje e subjekteve, të cilat kishin detyrime financiare ndaj KKRT-së, si për pagesat e licencës, ashtu edhe për taksat. Detyrime të taksave të pashlyera nga subjektet janë arketuar rreth 2.2 milion lekë, të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

3. Bilanceet kontabël të operatorëve radiotelevizivë

Në bazë të Ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", neni 48 dhe të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin", operatorët radiotelevizivë janë të detyruar të hartojnë bilancet e tyre vjetore në përputhje me legjisacionin për kontabilitetin, një kopje të të cilave e depozitojnë pranë KKRT-së, me treguesit kryesorë në fushën e mediave elektronike.

Për këtë, nga ana e Departamentit Ekonomik, iu është kërkuar subjekteve rtv, të cilët plotësojnë kushtet juridike e financiare për plotësim Bilanci Kontabël (janë të regjistruar në gjykatë me formë ligjore **Person Juridik** dhe realizojnë **të ardhura vjetore më shumë se 200 000 lekë**), që, me mbylljen e llogarisë vjetore të vitit 2004, një kopje të **bilancit kontabël të sigluar dhe të vulosur** nga inspektori i Degës së Tatimeve të rrethit, të depozitohej pranë KKRT-së deri në fund të muajit Prill 2005.

Përveç kërkesës së mësipërme, Departamenti Ekonomik ka përgatitur dhe dërguar pranë subjekteve pasqyra me kërkesa të detajuara për treguesit më të rendësishëm ekonomike e financiare, ku subjektet të pasqyrojnë burimin e tyre të financimit, sponsorët kryesorë të programeve etj.

Për subjektet radiotelevizive, që **nuk plotësojnë Bilanc Kontabël** (në këtë grup bëjnë pjesë subjektet P.Fizik), Departamenti Ekonomik ka përgatitur dhe u ka shpërndarë operatorëve **Pasqyra** me treguesit kryesorë të aktivitetit të tyre në fushën e mediave elektronike.

Në amendamentet e përgatitura për ndryshimin e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, është edhe heqja e të drejtës së personave fizike për marrje licence. Kjo përfaktin pasi kjo formë ligjore e ekzistencës së një operatori radioteleviziv i shmanget detyrimi të nenit 48 të ligjit për depozitim e bilanceve vjetore në KKRT. Kësidoj nuk mund të nxirret asnjë lloj treguesi.

Përveç kësaj, një nga objektivat e **inspektimit** të organizuar në subjektet radiotelevizive ishte kontrolli dhe mbledhja e dokumentacionit financier-Bilanceve kontabël, Çertifikatës së Regjistrimit në Organet Tatimore.

Gjatë vitit 2005 kanë depozituar **Bilancet kontabël** për aktivitetin ekonomik e financiar të vitit 2004, rreth **54% të subjekteve persona juridikë**. Nga **52 subjekte rtv**, të cilët operojnë në rrethin e Tiranës, **52 %** e kanë depozituar bilancin kontabël për vitin 2004.

Më e vështirë paraqitet situata për subjektet që operojnë në rrethe. Kanë depozituar dokumentacionin 37 %, me gjithë këmbënguljen dhe kërkesat e herëpashershme nga ana e Departamentit Ekonomik.

3.1. Rezultati ekonomiko - finansiar i operatorëve radiotelevizivë

Nga përpunimi i të dhënave që kemi në dispozicion vihet se operatorët Radio FM përgjithësisht rezultojnë me rezultat finansiar zero ose jorentabël, nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet me të ardhurat.

Një situatë të ngjashme kemi për operatorët televizivë. Operatorët që kanë rezultat finansiar pozitiv, treguesin e fitimit e kanë relativisht të ulët.

Si paraqitet rezultati ekonomiko finansiar i operatoreve radiotelevizive:

Gjatë analizës së treguesve të tre viteve të fundit rezulton se një pjesë e operatorëve që operojnë në Tiranë, rezultojnë me humbje. Kështu, TV Kombëtar "Arberia", për tre vite radhazi: 2002, 2003 e 2004, rezulton me rezultat finansiar – Humbje respektivisht: - 27 milion lekë, - 25 milion lekë, - 59 milion lekë. TV "Top Channel" për vitin 2002 paraqitet me humbje rreth 53 milion lekë, për vitin 2003: - 33 milion lekë, kurse për vitin 2004 me fitim 4.5 milion lekë. Po kështu, TV "Vizioni +" rezulton me humbje respektivisht: - 4 milion lekë, - 6 milion lekë, - 3.4 milion lekë. TV "Telesport", - 20 milion lekë humbje për vitin 2002, - 36 milion lekë humbje për vitin 2004. TV "Koha" paraqitet me humbje prej rreth - 15.5 milion lekë për vitin 2003 dhe rreth - 53 milion lekë për vitin 2004.

Nga kjo analizë vërehen devijime të konsiderueshme në treguesit finansiarë nga një vit në tjetrin, në raportimin e të ardhurave e shpenzimeve, gjë që shton dyshimet tona për raportim fiktiv të këtyre treguesve. Projekti i Monitorimit të Reklamave i realizuar nga KKRT, ndihmoi për analizën e tregut të reklamave në vendin tonë.

Në strukturën e shpenzimeve, në bilancet kontabël nuk është i qartë numri i programeve të prodhuara me shpenzimet përkatëse, si dhe numri i programeve të blera me shpenzimet e tyre, por paraqiten shpenzimet në total.

Nga sa paraqitëm më lart, megjithëse ndjehet një ndryshim në krahasim me vitin 2003, ende nuk mund të nxjerrim disa tregues realë për tregun e mediave, me të dhënat që kemi në dispozicion.

4. Masat e marra në lidhje me trasparencën e burimeve të financimit, fshehjes fiskale

Në praktikën e kohëve të fundit, KKRT ka ndeshur në vështirësinë e tërheqjes së informacionit nga disa institucione shtetërore, në lidhje me tarifat e reklamave të aplikuara nga subjektet rtv. Këto të dhëna i nevojiteshin KKRT-së për studimin e monitorimit të reklamave.

Nisur nga sa analizuam më lart, në kuadër të respektimit rigoroz të rregullave dhe standardeve të shtetit ligjor, për një media sa më profesionale dhe të besueshme, gjë që lidhet me transparencën e burimeve të financimit, konkurrencën e lirë në tregun mediatik

dhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të vendeve të BE-së, u përgatitën amendamentet përkatëse në ligj, duke kërkuar:

1. Forcimin e rolit të KKRT-së, duke kërkuar nga institucionet apo çdo subjekt tjetër që hyn në marrëdhënie financiare me subjektet rtv, informacione që ajo i gjykon të nevojshme. Këtij qëllimi i shërbeu riformulimi i nenit 7, pika 13 e ligjit.
2. Publikimin nga i licencuari një herë në vit, deri në datën 31 Mars, të të dhënave që i përkasin vitit paraardhës mbi:
 - Strukturën e pronësisë
 - statutin e shoqërisë radiotelevizive
 - bordin drejtues
 - burimet e financimit.

Neni 48 i Lgjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” i detyron operatorët rtv të hartojnë bilancet e tyre vjetore në përputhje me legjislacionin dhe ta depozitojnë atë në KKRT. Por, ligji aktual, mbi bazën e të cilin vepron KKRT, nuk parashikon ndonjë sanksion për mosrespektim të këtij detyrimi ligjor nga ana e subjekteve rtv. Për të siguruar përbushjen e këtij detyrimi ligjor, si dhe me qëllimin që KKRT të arrijë të sigurojë një transparencë sa më të plotë të burimeve të financimit, si të ardhurat nga reklamat, të ardhura të tjera, të ardhura nga aktivitete të tjera, sponsorizime, donacione etj, është punuar për gjetjen e rrugëve ligjore që do të çojnë drejt zgjidhjes së kësaj çështjeje kaq të rëndësishme. Konkretisht, në projektligjin e përgatitur është bërë një riformulim i nenit 48 të ligjit “Bilancet vjetore dhe përbajtja e tyre”, si dhe është parashikuar sanksion konkret për mosrespektim të këtij neni (neni 34 i projektligjit).

Ndërkohë, depozitimi i bilanceve vjetore përbën detyrim të subjekteve rtv, ashtu si për çdo subjekt tjetër që ushtron aktivitet, edhe ndaj organeve të tatim-taksave, siç parashikohet në nenin 29 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Sa më sipër vjen si realizim i një prej kompetencave të KKRT-së për të garantuar konkurrencën e ndershme në fushën e mediave elektronike të parashikuar në nenin 7, pika 4. Një ndër hapat që duhen marrë për këtë qëllim është rritja e transparencës rrëth burimeve të drejtperdrejta dhe të tërthorta të fondeve buxhetore që hidhen në tregun e medias në formën e reklamave dhe administrimin më eficient të këtyre burimeve në dobi të forcimit të besimit publik ndaj institucioneve.

Gjithashtu, hap tjetër është ushtrimi i një kontrolli më efektiv mbi ekskluzivitetin e veprimtarisë rtv, me qëllim ndarjen e kësaj lloj veprimtarie nga forma të tjera të biznesit.

5. Analiza e tregut të trasmetimeve radio e televizive

Në përpjekje për të përmirësuar rregullimin e transmetimeve radio e televizive në përputhje me ligjin dhe parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit për garantimin e konkurrencës së lirë e të ndershme në tregun e mediave elektronike, KKRT miratoi projektin e monitorimit të reklamave të operatorëve televizivë (vendimi nr. 333, datë 29.03.2005), projekt i cili u realizua së bashku me Departamentin e Programave.

Monitorimi kishte për qëllim përcaktimin e kohës televizive që zënë reklamat në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit, të ardhurat e përaferta të realizuara nga reklamat, si e ardhura kryesore e operatorëve rtv, si dhe ballafaqimi me të ardhurat e raportuara në bilance nga subjektet.

Hollësirat për këtë monitorim dhe llogaritjet e të ardhurave nga subjektet e monitoruara janë dhënë në Aneksin nr. 2.

6. Përmirësimi i akteve ligjore e nënligjore; materiale të përgatitura për Këshillin

Gjatë vitit 2005, Departamenti Ekonomik ka punuar edhe për të përmirësuar projektaktet ligjore e nënligjore për çështjet ekonomike, në amendimet e projektligjit nr. 8410, datë 23.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", në të cilin janë bërë përmirësime dhe janë parashikuar nene të veçanta në lidhje me transparencën e burimeve të financimit, deklarimin e tyre, etj. Gjithashtu, është punuar edhe për përcaktimin e kritereve dhe kushteve në dhënien e licencave vendore rajonale e kombëtare, si dhe për projektligjin "Për transmetimet numerike".

Po kështu, janë përmirësuar aktet në lidhje me problemet ekonomike të rregulloreve të KKRT-së, si rregullores së procedurave të licensimit, rregullores për licensim TV e FM Kombëtare.

Janë përgatitur materiale dhe është raportuar në Këshill për problemet ekonomiko-financiare të institucionit dhe operatorëve privatë rtv.

Në iniciativën e ndërmarrë për uljen e përdorimit të parasë "Cash" u realizua kalimi i pagesave të administratës nëpërmjet llogarive bankare.

7. Objektivat për vitin 2006

- Përmirësimi i akteve ligjore në lidhje me rritjen e të ardhurave të institucionit me synim ndërprenjen e financimit të KKRT-së nga buxheti i shtetit.
- Rritja e bashkëpunimit me organet dhe institucionet e tjera të shtetit, të cilat kanë detyrimet e tyre në zbatim të ligjit.
- Përcaktimi i tarifave për pagesat e licencës për trasmetimet numerike.
- Realizimi i detyrave të përcaktuara në materialin mbi monitorimin e reklamave.

Pasqyra nr.1
Pasqyra e detyrimeve te operatoreve private Radio e Televizione
per vitin 2005

000/leke

Nr.	Emertimi i subjektit	Rrethet	Pagesat per licence	Paguar	Detyrimi	Taksat per frekuence	Paguar	Detyrimi
Radio FM								
1	Radio Perla	Durres	83.6	83.6		60.0	60.0	
2	Radio Real	Durres	85.3	85.3		48.0	48.0	
3	Radio Alfa	Elbasan	28.6	28.6		9.6	9.6	
4	Radio Klea	Elbasan	28.6	28.6		9.6	9.6	
5	Radio +3	Fier	28.6	28.6		9.6	9.6	
6	Radio Fieri	Fier	49.3	49.3		9.6	9.6	
7	Radio Star	Fier	14.3	14.3		9.6	9.6	
8	Radio Alpo	Gjirokaster	36.5	36.5		7.2	7.2	
9	Radio Argjiropolis	Gjirokaster	14.3		14.3	7.2		7.2
10	Radio Fantasy	Kavaje	36.5		36.5	9.6		9.6
11	Radio Magic	Kavaje	8.6		8.6	7.2		7.2
12	Radio ABC	Korce	49.3		49.3	19.2		19.2
13	Radio Emanuel	Korce	70.8	70.8		19.2	19.2	
14	Radio Magic Star	Korce	43.6	43.6		19.2	19.2	
15	Radio Prespa	Korce	16.2	16.2		1.2	1.2	
16	Radio Lezha	Lezhe	29.3	29.3		7.2	7.2	
17	Radio e Pare	Mat	19.3	4.3	15.0	1.8	1.8	
18	Radio Saranda	Sarande	31.5	31.5		7.2	7.2	
19	Radio Top Albania	Tirane	1500.0	1500.0		273.6	273.6	
20	Radio +2	Tirane	1500.0	1500.0		112.8		112.8
21	Radio 7	Tirane	128.9	128.9		48.0	48.0	
22	Radio Aldo 03 FM	Tirane	85.3	85.3		48.0	48.0	
23	Radio Alfa e Omega	Tirane	139.4	139.4		48.0	48.0	
24	Radio AL-SAT1	Tirane	128.9	128.9		48.0	48.0	
25	Radio Boom Boom	Tirane	100.3	100.3		79.2	79.2	
26	Radio Club FM	Tirane	131.9	131.9		48.0	48.0	
27	Radio Energy	Tirane	85.3	85.3		48.0	48.0	
28	Radio Euro Star Music	Tirane	99.6	99.6		57.6	57.6	
29	Radio House of Arts	Tirane	85.3	85.3		48.0	48.0	
30	Radio Ime	Tirane	57.3	57.3		24.0	24.0	
31	Radio Koha	Tirane	70.1	70.1		48.0	48.0	
32	Radio Kontakt	Tirane	85.3	85.3		48.0	48.0	
33	Radio me pers. "D.Velle"	Tirane	100.0	100.0		9.6	9.6	
34	Radio me pers. BBC	Tirane	100.0	100.0		12.0	12.0	
35	Radio me pers. Italia	Tirane	30	30		19.68	19.68	
36	Radio Muzika Jon	Tirane	85.3	85.3		48.0	48.0	
37	Radio Nacional	Tirane	85.3		85.3	19.2		19.2
38	Radio New Planet	Tirane	85.3		85.3	48.0		48.0
39	Radio Njallja	Tirane	76.5	76.5		48.0	48.0	
40	Radio Oxygen	Tirane	113.9	113.9		48.0		48.0
41	Radio Planet	Tirane	57.3		57.3	48.0		48.0
42	Radio Rash	Tirane	112.3	112.3		48.0		48.0
43	Radio Rock	Tirane	128.9	128.9		60.0		60.0
44	Radio Shqip (Love)	Tirane	85.3	85.3		48.0		48.0
45	Radio Skorpion	Tirane	149.7	149.7		64.8		64.8
46	Radio Stinet	Tirane	57.3		57.3	24.0		24.0
47	Radio Sport	Tirane	85.3	85.3		48.0		48.0
48	Radio Top Gold	Tirane	146.5	146.5		60.0		60.0
49	Radio Val'e kalter	Vlore	58.0	58.0		19.2		19.2
50	Radio Armonia	Gjirokaster	29.3	29.3		7.2		7.2
51	Radio Club Alsion	Elbasan	36.5	36.5		9.6		9.6
	Shuma		6494.5	6085.6	408.9	1930.7	1635.5	295.2

Nr.	Emertimi i subjektit	Rrethi	Pagesat per licence	Paguar	Detyrimi	Taksa per frekuence	Paguar	Detyrimi
Televizione								
1	TV B.Curri	B.Curri	65.8	65.8		36	36	
2	TV Color	Balish	2.86	2.86		24	24	
3	TV Onufri	Berat	71.5	71.5		48	48	
4	TV Bulqiza	Bulgize	45.8	45.8		24	24	
5	TV Mati	Burrel	45.8	45.8		9	9	
6	TV Adriatik	Durres	257.3	257.3		240	5.7	234.3
7	TV Johaniter	Durres	71.5	71.5		36	36	
8	TV Real	Durres	500.3	500.3		240	240	
9	TV Teuta	Durres	185.8	185.8		258	258	
10	TV Dardan	Elbasan	71.5	71.5		48	48	
11	TV Egnatia	Elbasan	357.3	357.3		471	471	
12	TV Skampa	Elbasan	71.5	71.5		36	3.6	32.4
13	TV Era	Erseke	2.86	2.86		24	24	
14	TV Apollon	Fier	117.3	117.3		144	144	
15	TV AVN	Fier	100	100		48	48	
16	TV Kombi	Fier	100.1	100.1		48	48	
17	TV Alpo	Gjirokaster	45.8	45.8		36	36	
18	TV Antena Jug	Gjirokaster	25.8	25.8		72	72	
19	TV Channel 7	Gjirokaster	45.8		45.8	36		36
20	TV Gramshi	Gramsh	14.3	14.3		36	36	
21	TV 2A	Kavaje	25.8	25.8		36	36	
22	TV ABC	Korce	71.5		71.5	96		96
23	TV Kristal	Korce	71.5		71.5	48	48	
24	TV Lobi	Korce	71.5	71.5		48	48	
25	TV Magic	Korce	45.8	45.8		36	36	
26	TV Kruja	Kruje	45.8	45.8		36	36	
27	TV Kucova	Kucove	71.6	71.6		60	60	
28	TV Kukesi	Kukes	491.8	292.8	199	366	366	
29	TV Lezha	Lezhe	177.4	177.4		84	84	
30	TV 4+	Lushnje	71.5	71.5		96	96	
31	TV Margit	Lushnje	100	100		192	192	
32	TV Mirdita	Mirdite	45.8		45.8	36		36
33	TV Klaudiana	Peqin	25.8	25.8		24	24	
34	TV AOS	Permet	14.3	14.3		24		48
35	TV Dibra	Peshkopi	14.3		14.3	24		24
36	TV Dibra Vizion	Peshkopi	14.3		14.3	36	36	
37	TV ARV	Pogradec	45.8	45.8		36		36
38	TV Sot 7	Pogradec	117.3	117.3		132	132	
39	TV Puka	Puke	45.8	45.8		36	36	
40	TV Asparag	Rogozhine	2.8	2.8		6	6	
41	TV Antena Nord	Shkoder	97.3	97.3		48	48	
42	TV Kopliku	M. Madhe	71.5	71.5		48		48
43	TV Malesia	M. Madhe	71.5		71.5	48		48
44	TV Rozafa	Shkoder	157.3	157.3	0	48		48
45	TV Shkodra	Shkoder	74.36	74.36		48		48
46	TV Arberia	Tirane	5000	3600	1400	1092		1092
47	TV Klan	Tirane	5000	1500	3500	1509		1509
48	TV Tirana 2000	Tirane	171.5	171.5		240	240	
49	TV ATN1	Tirane	391.5		391.5	240		240
50	TV Ballkan	Tirane	500.3	500.3		240	240	
51	TV BBF	Tirane	171.5	171.5		120	120	
52	TV Calvin	Tirane	171.5	171.5		240	240	
53	TV Koha	Tirane	203.1	203.1		276	276	
54	TV me frek. Al - Sat	Tirane	257.3	257.3		240	240	
55	TV me pers. RAI	Tirane	30		30	24		24
56	TV me pers. TV5	Tirane	100	100		67.8	67.8	
57	TV Nesan	Tirane	348.3		348.3	324		324
58	TV News 24	Tirane	308.8	308.8		240	240	
59	TV Telenorba Shqiptare	Tirane	528.8	528.8	0	528		528
60	TV Gjeli	Tirane	114.3		114.3	300		300
61	TV Satelitor	Tirane	5000	5000		204		204
62	TV Tele 1	Tirane	377.3		377.3	516	516	
63	TV Tele Sport	Tirane	500.3	500.3		780	780	
64	TV Top Chanel	Tirane	500.3	500.3		480	480	
65	TV Vizioni +	Tirane	500.3	500.3		48	48	
66	TV 6+1	Vlore	131.6	131.6		48	48	
67	TV Amantia	Vlore	71.5	71.5		72	72	
68	Tv Armonia	Gjirokaster	65.8	65.8		72		72
	Shuma		24685.3	17990.2	6695.1	11446.8	6671.1	4775.7
	TOTAL FM+TV+TV kabillor		41029.8	32215.8	8814.0	13377.5	8306.6	5070.9

000/leke

Nr.	Emertimi i subjektit	Rrethi	Pagesat per licence	Paguar	Detyrimi
1	TV Me kabell Irla	Berat	200	200	
2	TV Me kabell Iliria	Berat	200	200	
3	TV Me kabell AI - Te	Durres	750	750	
4	TV Me kabell Elbasat	Elbasan	500	500	
5	TV Me kabell Egnatia	Elbasan	850	600	250
6	Tv Me kabell Kombi	Fier	350	350	
7	TV Me kabell AVN	Fier	400	90	310
8	TV Me kabell Devi	Gramsh	150	150	
9	TV Me kabell Multivizion	Kavaje	100	100	
10	TV Me kabell Korca	Korce	400	400	
11	TV Me kabell Kuçove	Kuçove	150	150	
12	Tv Me kabell Lissus	Lezhe	100	100	
13	TV Me kabell Lezha	Lezhe	150	150	
14	TV Me kabell Lushnja	Lushnje	200	200	
15	TV Me kabell Mati	Mat	150	150	
16	TV Me kabell Permet	Permet	150	150	
17	TV me kabell HB - CA	Peshkopi	100	100	
18	TV Me kabell INKUSAT	Pogradec	100	100	
19	TV Me kabell Butrinti	Sarande	100	100	
20	TV Me kabell Alfa	Shkoder	350		350
21	TV Me kabell Ani	Skrapar	150	150	
22	TV Me kabell Polican	Skrapar	150	150	
23	TV Me kabell Alfa Tirane	Tirane	1000	1000	
24	TV Me kabell DCN	Tirane	1000	200	800
25	TV Me kabell Star	Tirane	1000	1000	
26	TV Me kabell Trio	Vlore	350	350	
27	TV Me kabell Asparag	Rrogozhine	150	150	
28	TV Me kabell Bulqiza	Bulqize	150	150	
29	TV Me kabell Kukesi	Kukesi	150	150	
30	TV Me kabell Ju - Al	Kruje	150	150	
31	TV Me kabell Fokus	Maliq	150	150	
Shuma			9850	8140	1710

Te dhenat e mesiperme i korrespondojne dates

22.01.2006

ANEKSI 2

RAPORTMBI LLOGARITJEN E TE ARDHURAVE NGA MONITORIMI I REKLAMAVE

Në përpjekje për të përmirësuar rregullimin e transmetimeve radio e televizive në përputhje me ligjin dhe parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit për garantimin e konkurrencës së lirë e të ndershme në tregun e mediave elektronike, KKRT, me vendimin nr. 333, datë 29.03.2005, miratoi projektin e monitorimit të reklamave të operatorëve televizivë, projekt i cili u realizua së bashku me Departamentin e Programeve për periudhën Prill–Maj 2005, 28 ditë, nga ora 8.00 deri në orën 24.00.

Monitorimi kishte për qëllim përcaktimin e kohës televizive që zënë reklamat tregtare në raport me kohën e përgjithshme të transmetimit, të ardhurat e përafërtë të realizuara nga reklamat, si e ardhura kryesore e operatorëve radiotelevizivë, si dhe ballafaqimi me të ardhurat e deklaruara në bilancet kontabël nga subjektet.

Burimet e informacionit

Ne realizuam këtë projekt për analizën e treguesve dhe llogaritjen e efekteve financiare në mbështetje të nenit 7, pika 13, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, në të cilin thuhet se KKRT “kërkon nga administrata shtetërore, gjykatat, bankat dhe organizma të tjera përkatës, si dhe nga titullarët e subjekteve të licensuara, informacione që i gjykon të nevojshme për të kontrolluar vërtetësinë e të dhënavë të paraqitura nga kërkuesi i licencës para dhënisë së saj, ose në çdo rast tjetër”. Operatorëve privatë televizivë, ndërmarrjeve, institucioneve apo enteve shtetërore, si KESH, Albtelekom, INSIG, Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së, subjekteve private që kanë porositur reklama dhe njoftime, si AMC, Shoqërisë së telefonisë celulare “Vodafone”, AM Group “Deka”, Shoqërisë “Coca Cola”, iu kërkuan me shkresë zyrtare të dhëna për tarifat e reklamave sipas kohës së transmetimit, numri i spoteve të transmetuara, tarifa për shërbime të tjera televizive etj.

Edhe pse u këmbëngul si në rrugë shkresore, ashtu edhe me takime të drejtpërdrejta, nga institucionet e mësipërme, përjashtuar Albtelekom dhe Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH-së, nuk na u vunë në dispozicion të dhënat apo informacioni i domosdoshëm i kërkuar për qëllimet e këtij projekti.

Kompania e telefonisë celulare “Vodafone”, AMC dhe KESH, kërkesës së KKRT-së iu përgjigjën negativisht, duke i trajtuar të dhënat për reklamat si informacion tregtar konfidencial, ndërsa Kompania “Coca Cola”, AM Group “Deka” dhe INSIG nuk u përgjigjën fare.

Informacioni i siguruar në KKRT nga operatorët televizivë, Albtelekom, RTSH, etj, shërbeu si bazë për studimin e treguesve ekonomikë e financiarë të Projektit.

Koha e monitorimit

Mbështetur në informacionet bazë të monitorimit për secilin subjekt dhe tarifat e aplikuara nga subjektet (në llogaritjen e efekteve financiare janë marrë për bazë tarifat e deklaruara nga vetë subjektet), sipas orareve të transmetimit, evidentojmë se:

Janë monitoruar gjithsej 10 subjekte, për transmetimet e reklamave tregtare, për teleshitje, njoftime dhe reklama flash, në periudhën 18 Prill – 15 Maj 2005, gjithsej 28 ditë monitorimi për çdo subjekt, 17 orë transmetimi në ditë.

Reklamat flash dhe njoftimet në raportin e monitorimit të paraqitur nga Departamenti i Programeve, nuk janë pasqyruar në kohë, por vetëm si numër dhe brenda kohës së transmetimit të reklamave. Edhe në analizën ekonomike kemi ndjekur po këtë linjë, duke mos i analizuar si zë më vete.

Efekti ekonomik është llogaritur bazuar në dy tregues: kohë transmetimi reklame dhe kohë transmetimi teleshitjeje.

Në analizën e përgjithshme nuk janë marrë në konsideratë treguesit dhe efekti ekonomik që rezulton nga transmetimi i "Quiz" dhe "0900" të transmetuara nga operatori "Telenorba Shqiptare", pavarësisht se janë bërë të gjitha llogaritjet për këto programe. Nëse do të llogariteshin programet e mësipërme, atëherë raporti orë reklame e monitoruar me orë transmetimi gjithsej është 32.2 përqind.

Treguesi orë reklame ndaj orëve të transmetuara gjithsej në 10 subjektet e monitoruara është 10.1 përqind, shifër kjo që varion nga 2.9 përqind për Televizionin Publik Shqiptar deri në 22.4 përqind për Televizionin Klan.

Janë monitoruar gjithsej 4 522 orë. Për secilin operator janë monitoruar 476 orë reklama tregtare dhe teleshitje (28 ditë x 17 orë = 476 orë). Orët e transmetimit të reklamave ndaj orëve të transmetimeve gjithsej janë 10.1% (455.1 orë reklamë ndaj 4 522 orë të transmetuara gjithsej).

Orët e transmetimit të reklamave ndaj orëve të transmetimit gjithsej për subjekte të ndryshme janë të ndryshme, p.sh: TV Klan ka 106.7 orë reklama tregtare dhe teleshitje, ose 22.4%; TV Arbëria ka rrëth 56 orë reklama ose 11.7%; TV Vizion + ka 49 orë reklama ose 10.9%, Top Channel 47.8 orë reklama ose 10 përqind etj. (Shih Pasqyrën nr. 1).

Nga koha e monitoruar gjithsej 1.639.431 sekonda, 55822 sekonda ose 3.4 përqind janë kohë reklama të transmetuara për subjektet shtetërore, si KESH, Albtelekom, AKP, Armo etj, dhe diferenca prej 1.583.609 sek ose 96.6 përqind është kohë reklama të transmetuara për subjektet private.

Të ardhurat nga reklamat, sipas monitorimit

Për të llogaritur të ardhurat e realizuara nga reklamat u përdorën dy tregues:

- Koha e transmetimit të reklamave të detajuar sipas programeve
- Tarifat e aplikuara nga operatorët rtv për blerjen e kohës televizive të depozituara pranë KKRT-së.

Që këtej, u përllogarit:

- Vlera e reklamave për periudhen e monitorimit
- Tarifa mesatare për blerjen e kohës televizive për sekondë
- Tarifa mesatare për blerjen e kohës televizive për spot.

Vlera e reklamave e përllogaritur për periudhën e monitorimit (pa përfshirë subjektet TVSH dhe TV Shijak)

Kohës së reklamave të monitoruara, gjithsej prej 1.426.297 sekonda, e barabartë me 23.771 minuta, ose 396 orë, me tarifat e reklamave sipas kohës së transmetimit, i korrespondon një vlerë totale e të ardhurave nga reklamat prej 335.964.500 lekë. Vlera e të ardhurave të monitoruara nga reklamat është llogaritur në mbështetje të tarifave të reklamave të depozituara nga subjektet. Llogaritjet janë të pasqyruara analistikisht për çdo subjekt.

Në rast se do të ruanim të pandryshuara vlerat e paraqitura më lart, për një periudhë njëvjeçare rezulton se vlera e të ardhurave për subjektet e monitoruara do të ishte **4.031.574 000 lekë**. Në këtë vlerë përfshihen vetëm të ardhurat nga shërbimi i reklamave tregtare, pa u përfshirë të ardhurat nga shërbimet e tjera, si: dhënia e pajisjeve me qera, prodhimi i reklamave etj.

Duke marrë parasysh faktin se subjektet mund të kenë ndryshime të reklamave të transmetuara nga njëri muaj te tjetri, pasi aplikojnë tarifa të ndryshme për paketa reklamash ose tarifa sipas preferencës së klientelës, autoreklama etj, subjekti monitorues parapëlqeu të mbajë një rezervë të konsiderueshme. Kësisoj, shifra prej 4.031.574.000 lekë vlerë vjetore është korrektuar me 80 % (ose afërsisht për 10 muaj), rezulton me një vlerë prej **3.225.259.200 lekë**, ndërsa e korrektuar me 60 përqind rezulton me një vlerë prej **2.418.944.400 lekë**, ose 7.2 muaj.

Tarifa mesatare e përllogaritur për sekondë është 235.6 lekë

Sekondë/reklamë

Një tregues tjetër i rëndësishëm që doli nga ky monitorim, është tarifa mesatare për sekondë. Subjekte të ndryshme kanë tarifë të ndryshme për sekondë. TV Klan del të praktikojë tarifë për sekondë 282 lekë, TV Arbëria me 196 lekë, TeleNorba Shqiptare me 209 lekë, ndërsa Top Channel 557.7 lekë.

Tarifa mesatare e përllogaritur për spot televiziv rezultoi 7066.5 lekë

Sekondë/spot

Një spot reklame është llogaritur për 30 sekonda, tarifa mesatare për sekondë është 235.6 lekë.

Për të gjitha subjektet, tarifa mesatare për një spot publicitar prej 30 sekondash, është rreth 7.066 lekë. TV Klan aplikon tarifë mesatare 8 462 lekë, TV Koha 5162 lekë, TeleSport 3 380 lekë, etj. Edhe në këtë rast, tarifa nga Top Channel është mjaft e ndryshme, 16 765 lekë.

Të ardhurat vjetore nga reklamat në vendin tonë për transmetimet televizive.

Subjektet e monitoruara përfshihen në zonën ku tregu i reklamave është i përqëndruar kryesisht në Tiranë e në Durrës.

Për llogaritjen e përafërt të të ardhurave vjetore të reklamave në shkallë kombëtare ne përdorëm treguesit e monitorimit që gjykojmë të arsyeshme, mbështetur në shkallën e njojjes dhe të informacionit që disponojmë:

- Vlera vjetore e monitorimit e korrektuar me 60 përqind
- Të ardhurat nga subjektet e tjera televizive që operojnë në rrethe

Të ardhurat vjetore të reklamave për subjektet televizive.

1. Vlera vjetore e reklamave e korrektuar me 60 përqind	2.418.944.400 lekë
2. Të ardhura vjetore të subjekteve të tjera që operojnë në rrethe	190.000.000 lekë
Shuma ose rreth	2.608.944.400 lekë
	21 milion euro

Sa më sipër, vlera vjetore e reklamave tregtare për transmetime televizive, në shkallë kombëtare rezulton rreth 21 milion euro. Në këtë vlerë nuk janë përfshirë të ardhurat nga reklamat Quiz, 0900, nga reklamat me pamje fikse etj.

Për vitin 2004, Albtelekomi për shërbimin e kryer për transmetimin e reklamave ka derdhur fonde në favor të subjekteve rtv në shumën prej 38.9 milion lekë ose 320 mijë Euro (shkresa e Albtelekomit nr. 15071, datë 15.3.2005).

Më gjithë kërkesën tonë për të patur këtë informacion nga KESH, gjë që nuk u realizua, duke shfrytëzuar burime të tjera të besueshme, mund të informojmë se KESH sh.a. ka shpenzuar për reklamën në përfitim të mediave 150 mijë dollarë për vitin 2001, për vitin 2002 rreth 500 mijë dollarë, për vitin 2003 rreth 560 mijë dollarë dhe për 6 mujorin e parë të vitit 2004, 180 mijë dollarë. Gjithashtu, ka pasur derdhje në favor të mediave edhe nga subjekte të tjera shtetërore si INSIG, ARMO, etj.

Krahasimi i të dhënavë të monitorimit me treguesit e bilanceve kontabël të subjekteve të monitoruara (pa përfshirë TVSH dhe TV Shijak).

Si vit bazë krahasimi është marrë viti 2004

Krahasimi i të dhënavë tështë bërë midis të dhënavë të çdo subjekti të monitoruar dhe të dhënavë të paraqitura në bilancet vjetore në zërin “të ardhura nga reklamat” për vitin 2004, me vlerën vjetore të reklamave sipas monitorimit dhe vlerën vjetore të reklamave të korrektuar me të dyja variantet: 80 përqind dhe 60 përqind.

Vlera e reklamave vjetore për subjektit e monitoruara	4.031.574.000 lekë
“ “ 80 përqind	3.225.259.200 lekë
“ “ 60 përqind	2.418.944.400 lekë

Vlera e reklamave të raportuara në bilancet kontabël 553.209.000 lekë

Nga krahasimi i të dhënavë në shumë absolute dhe përqindje rezulton se subjektit raportojnë:

Në shumë absolute, duke mos regjistruar dhe raportuar një vlerë prej:

Vlera e reklamave e korrektuar me 80 përqind - 2.6 miliard

Vlera e reklamave e korrektuar me 60 përqind - 1.8 miliard

Në përqindje:

Vlera e reklamave e korrektuar me 80 % - Raportimi është 17%

Vlera e reklamave e korrektuar me 60 % - Raportimi është 22%

Në shumë absolute, duke mos regjistruar dhe raportuar një vlerë prej 1.8 deri në 2.6 miliard lekë në vit. (Vlera vjetore e reklamave nga monitorimi e korrektuar është 2.4 deri në 3.2 miliard lekë – vlerën e reklamave të raportuara 553.209.000 lekë në bilancet vjetore).

Subjektet e monitoruara raportojnë mesatarisht 17 deri 22 përqind të të ardhurave të realizuara.

Duke ju referuar vlerës së reklamave të korrektuar me 60 përqind rezulton se diferençat midis të ardhurave të raportuara në bilancet vjetore me të ardhurat nga monitorimi për subjektet e monitoruara është rreth 1.8 miliard lekë.

TV Klan rezulton që nga monitorimi i reklamave të realizojë rreth 780 milion lekë të ardhura në vit nga reklamat, ndërkokë që për vitin 2004 ka raportuar në bilanc 150 milion lekë të ardhura nga reklamat me një diferençë prej 630 milion lekë, TVA gjithashtu rezulton me një diferençë prej 216 milion lekë, TCH me një diferençë prej 492 milion lekë, TV Koha 205 milion lekë, TeleNorba Shqiptare 212 milion lekë, TeleSport 35 milion lekë, TV Teuta 7 milion lekë.

Në përqindje, duke iu referuar të dhënavë të pasqyrës nr. 5 rezulton se nga krahasimi i të ardhurave vjetore të reklamave të raportuara në bilancin kontabël të vitit 2004, në zërin “të ardhura nga reklamat” për çdo subjekt me vlerën vjetore të reklamave sipas monitorimit, të korrektuar me 60 përqind, na rezulton se subjekti TV Klan ka raportuar 19.2 përqind të të ardhurave nga reklamat, TV Arbëria 23.7 përqind, TV Vizion + 48.6 përqind, TV Koha 8 përqind, TV Telesport 25 përqind, TV Teuta 87.2 përqind.

Në pasqyrën nr. 7 janë paraqitur rezultatet financiare të subjekteve të monitoruara për tre vjet radhazi.

Gjatë analizës së treguesve të tre viteve të fundit rezulton se një pjesë e operatorëve që operojnë në Tiranë, dalin me humbje. Kështu, TV Kombëtar “Arbëria”, për tre vite rradhazi 2002, 2003, 2004, rezulton me rezultat financier – Humbje respektivisht - 27 milion, - 25 milion, - 59 milion. TV “Top Channel” për vitin 2002 paraqitet me humbje rreth 53 milion lekë, për vitin 2003 - 33 milion, kurse për vitin 2004 me fitim 4.5 milion. Po kështu, TV “Vizion +” rezulton me humbje respektivisht - 4 milion lekë, - 6 milion, - 3.4 milion lekë. TV “Telesport” - 20 milion lekë humbje për vitin 2002, -36 milion lekë humbje për vitin 2004. TV “Koha” paraqitet me humbje prej rreth - 15.5 milion lekë për vitin 2003 dhe rreth - 53 milion lekë për vitin 2004.

Mendime dhe sugjerime

Nga sa trajtuam më sipër, mendojmë se projekt i monitorimit të reklamave arriti qëllimin e tij, duke na dhënë disa tregues të rëndësishëm, por të përafërt, si:

- Kohën televizive që zënë reklamat në raport me kohën e përgjithshme të transmetimeve.
- Të ardhurat e përafërtë që sigurohen nga reklamat
- Tarifën e blerjes së kohës televizive për sekondë

- Tarifën e kohës së blerjes televizive për spot
- Të ardhurat vjetore që sigurojnë operatorët
- Ballafaqimin e të ardhurave të deklaruara në bilance nga operatorët me të ardhurat që konkluduan nga monitorimi dhe diferençat e rezultuara.

Gjatë monitorimit, ne vumë re se operatorët raportojnë rreth 17 – 22 përqind të të ardhurave të realizuara nga reklamat, duke mos regjistruar vetëm në këtë zë një vlerë prej rreth 1.8 miliardë lekë në vit. Për pasojë, mediat e monitoruara televizive, duke mos raportuar saktësishët të ardhurat që ato realizojnë nga reklamat, influencojnë direkt në rezultatet e tyre paraqitjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, gjë që përbën evazion fiskal.

Duke vlerësuar një projekt si ky, i pari i këtij lloji tek ne, me qëllim që ai të shërbejë për më shumë transparencë, KKRT, këto shifra i ka shtruar për diskutim me secilin nga subjektet e monitoruara. Në përfundim, KKRT i kërkoi administratës së këtij institucioni:

1. Të bashkëpunohet me administratorët e subjekteve dhe institucionet kryesore të administratës fiskale për sigurimin e një transparence dhe ekspertize fiskale në mënyrën e mbajtjes së llogarive, bilanceve vjetore, në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.
2. Të zhvillohet një studim i ngjashëm edhe për reklamat e emetuara nga operatorët radio.
3. Studimi të kompletohet duke identifikuar dhe analizuar edhe të ardhura të tjera nga shërbimet si prodhim reklamash, etj.
4. Të kërkohet informacion periodik, mbi tarifat që aplikojnë operatorët radiotelevizivë në të gjithë vendin për reklamat dhe shërbimet e tjera.
5. Të ndërmerrin hapat për propozimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore për të siguruar transparencën e burimeve të financimit, krijimin, evidentimin, përdorimin e tyre.

Përfundimet e mësipërme vihen në dispozicion të institucionit tuaj, së pari për qëllime njojjeje, por edhe me dëshirën për të nxitur komunikimin e mëtejshëm midis palëve, nga KKRT si autoritet rregullator i fushës, institucionet e tjera të interesuara, si dhe operatorëve radiotelevizivë, subjekte jo vetëm të monitoruara, por sidomos subjekte partnere.

KKRT do të ishte e kënaqur nëse do të mund të ndanim së bashku mendimin se puna e nisur mund të shërbejë për një ecuri të mëtejshme më të thelluar dhe më profesionale.

Tregues te detajuar te oreve te transmetimit

Nr	Subjekti	Vlera e reklamave sipas monitorimit (mije leke)	Ore transmetimi gjithsej (ne ore)	Ore reklama sipas monitorimit (ne ore)	Perqindja e ore reklama ndaj oreve te transm. gjithsej (ne %)
1	Televizioni KLAN - Gjithsej	108390.4	476.0	106.7	22.4
	- Televizioni KLAN - Reklama	81718.0		80.4	16.9
	- Televizioni KLAN - Teleshitje	26672.4		26.3	5.5
2	Televizioni ARBERIA	39463.0	476.0	55.9	11.7
3	Televizioni TOP CHANNEL - Gjithsej	96039.9	476.0	47.8	10.0
	- Televizioni TOP CHANNEL - Reklama	95441.0		47.4	9.9
	- Televizioni TOP CHANNEL - Teleshitje	598.9		0.4	0.08
4	Televizioni VIZION +	20011.0	476.0	49.0	10.3
5	Televizioni KOHA	31082.0	476.0	50.2	10.5
6	Televizioni TELENORBA SHQIPTARE	33713.9	476.0	44.7	9.4
7	Televizioni TELESPORT	6493.5	476.0	16.0	3.36
8	Televizioni TEUTA	770.8	238.0	25.7	10.8
	Shuma	335964.5	3570.0	395.9	11.1
	Televizioni TELENORBA SHQIPTARE - Quiz	110435.0	476.0	153.4	32.2

Vlerat e reklamave sipas subjekteve, tarifat per spot, tarifat per sekonde

Nr	Subjekti	Vlera e reklamave sipas monitorimit (mije leke)	Koha e monitorimit (ne sek)	Tarifa mesatare per spot nga monitorimi (ne leke)	Tarifa mesatare per sekonde nga monitorimi (ne leke)	Vlera vjetore e reklamave (mije leke)
1	Televizioni KLAN - Gjithsej	108390.4	384325.0		282.0	1300684.8
	- Televizioni KLAN - Reklama	81718.0	289742.0	8462.0	282.0	980616.0
	- Televizioni KLAN - Teleshitje	26672.4	94583.0		282.0	320068.8
2	Televizioni ARBERIA	39463.0	201291.0	5880.0	196.0	473556.0
3	Televizioni TOP CHANNEL - Gjithsej	96039.9	172193.0		557.7	1152478.8
	- Televizioni TOP CHANNEL - Reklama	95441.0	170795.0	16765.0	558.8	1145292.0
	- Televizioni TOP CHANNEL - Teleshitje	598.9	1398.0		428.4	7186.8
4	Televizioni VIZION +	20011.0	176555.0	3399.0	113.0	240132.0
5	Televizioni KOHA	31082.0	180624.0	5162.0	172.0	372984.0
6	Televizioni TELENORBA SHQIPTARE	33713.9	160884.0	6287.5	209.6	404566.8
7	Televizioni TELESPORT	6493.5	57627.0	3380.2	112.6	77922.0
8	Televizioni TEUTA	770.8	92798.0	400.0	13.3	9249.6
Shuma		335964.5	1426297.0	24508.7	1656.2	4031574.0

Tregues krahasues te te Ardhurave nga Reklama

Nr	Subjekti	Vlera vjetore e reklamave	Te ardhurat nga reklamat te deklaruara nga subjektet ne bilancet kontabel			(mije leke) Diferencia monitorim - bilanc per vitin 2004
			Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	
1	Televizioni KLAN - Gjithsej	1300684.8	63418	93400	150309	1150375.8
2	Televizioni ARBERIA	473556.0	55975	99685	67356	406200.0
3	Televizioni TOP CHANNEL	1152478.8	48182	103225	199678	952800.8
4	Televizioni VIZION +	240132.0	19173	34144	70718	169414.0
5	Televizioni KOHA	372984.0	0	8534	18009	354975.0
6	Televizioni TELENORBA SHQIPTARE	404566.8	34332	20425	30636	373930.8
7	Televizioni TELESPORT	77922.0	458.7	9714	11703	66219.0
8	Televizioni TEUTA	9249.6	4800	4932	4800	4449.6
	Shuma	4031574	226338.7	374059	553209	3478365

**Krahasimi I te ardhurave nga reklamat ne perqindje dhe vlore absolute,
nga monitorimi I reklamave krahasuar me vitin 2004**

Nr	Subjekti	Vlera vjetore e reklamave v. 2004	Vlera vjetore e reklamave sipas monitorimit (mije leke)	%	Vlera vjetore e reklamave e korrektuar (mije leke)	%
1	Televizioni KLAN	150309	1300684.8	11.5	1040547.8	14.4
2	Televizioni ARBERIA	67356	473556.0	14.2	378844.8	17.7
3	Televizioni TOP CHANNEL	199678	1152478.8	17.3	921983	21.6
4	Televizioni VIZION +	70718	240132.0	29.4	192105.6	36.8
5	Televizioni KOHA	18009	372984.0	4.8	298387.2	6.0
6	Televizioni TELENORBA SHQIPTARE	30636	404566.8	7.5	323653.4	9.4
7	Televizioni TELESPORT	11703	77922.0	15	62337.6	18.7
8	Televizioni TEUTA	4800	9249.6	51.8	7399.2	64.8
Shuma		553209.0	4031574.0	13.7	3225258.6	17.2

Pasqyra nr. 5

Te dhenat financiare sipas Bilanceve Kontabel te subjekteve

000 leke

Nr	Emertimi	Viti 2002			Viti 2003			Viti 2004		
		Te ardhura	Shpenzime	Rez.fin	Te ardhura	Shpenzime	Rez.fin	Te ardhura	Shpenzime	Rez.fin
1	TV Arberia	55984	83518	-27534	106778	132143	-25365	80946	140332	-59386
2	TV Klan	63424	62615	809	113224	106725	6499	153915	151971	1944
3	TV Top Channel	162375	215476	-53101	105565	138770	-33205	257372	252901	4471
4	TV Vizion +	19403	23460	-4057	34358	40796	-6438	80725	84143	-3418
5	TV Telenorba	35029	62123	-27094	48813	47865	948	30763	29304	1459
6	TV Telesport	458	20552	-20094	27331	27331	0	11821	48076	-36255
7	TV Koha			0	8534	24077	-15543	66596	119499	-52903
8	TV Teuta	4800	4789	11	4932	4918	14	4800	4778	22

Pasqyra nr. 6

Te dhena sipas monitorimit te reklamave

milion leke

Nr	Emertimi	Vlera vjetore sipas monitorimit	Vlera e korrektuar me 80% (10 muaj)	Vlera e korrektuar me 60% (7.2 muaj)	Vlera e raportuar ne bilanc	% e raportuar ne muaj
1	TV Arberia	473	378.40	283.80	67.30	1.70
2	TV Klan	1300	1040.00	780.00	150.00	1.38
3	TV Top Channel	1152	921.60	691.20	199.00	2.00
4	TV Vizion +	240	192.00	144.00	70.00	3.50
5	TV Telenorba	404	323.20	242.40	30.00	0.896
6	TV Telesport	78	62.40	46.80	11.70	1.80
7	TV Koha	373	298.40	223.80	18.00	0.60
8	TV Teuta	92	73.60	55.20	48.00	6.20
	Shuma	4112	3289.6	2467.2	594	1.7

ANEKSI 4

A. 4.1. Të dhënat e hyrjes të Shqipërisë paraqitur në Ushtrimin e Parë të Planifikimit

A. 4.1.1. Filat DA1 & DT2

Janë skedare të plotësuara në një soft të përgatitur nga ITU dhe paraqesin koordinatat e kontureve të zonave të allotimit të krijuara për të mbuluar territorin e Shqipërisë me sinjal televiziv numerik tokësor (DA 1) dhe karakteristikat e rrjeteve numerike që do të ndërtohen brenda zonave të allotimit (DT2).

A.4.1.2. Filat DT1

Janë skedare (të plotësuara në softin e përgatitur nga ITU) të kërkesave për caktim frekuencore të televizonit numerik (DVB-T). Me fjalë të tjera, këto skedare do të paraqesin karakteristikat teknike të secilit prej stacioneve transmetues që do të instalohen në secilën prej zonave të allotimit. Plotësimi i këtyre skedareve kërkon studimin e çdo pikë transmetimi e llogaritje të shumta e të komplikuara. Prandaj, edhe paraqitja e kërkesave të tillë në BR ishte lënë në dëshirën e vendeve anëtare. Në fakt, shumica e vendeve pjesëmarrëse në planifikim nuk kanë plotësuar këto lloje skedaresh, pasi, në rast se në procesin e analizës, kërkesa do të rezultonte inkompatibël, e gjithë puna e kryer do të bëhej e pavlefshme.

A.4.1.3. Filat DS1

Janë kërkesat për caktim frekuencore për transmetime audio numerike (T-DAB). KKRT nuk i përgatiti caktimet frekuencore për rrjetin e transmetimeve numerike audio në ushtrimin e parë të planifikimit. Ashtu si dhe përgatitja e filave DT1, për vetë vështirësitë e llogaritjes, paraqitja e këtyre filave është opSIONALE.

A.4.1.4. Filat DS2

Janë kërkesat për allotmente audio numerike (T-DAB). KKRT nuk i përgatiti caktimet frekuencore për rrjetin e transmetimeve numerike audio në ushtrimin e parë të planifikimit. Ato u paraqitën në datën 31.10.2005, me të dhënat për ushtrimin e dytë të planifikimit (për draft Planin).

A.4.1.5. Filat TVA

Janë skedare të plotësuara në një soft të përgatitur nga ITU dhe paraqesin gjendjen e caktimve frekuencore ekzistuese dhe të planifikuara të transmetimeve analoge në territorin e Shqipërisë. Këto të dhëna përdoren për të pasqyruar “gjendjen referencë”, ku do të bazohet hartimi i planit numerik.

ANEKSI 3

RREGULLIMET LIGJORE LICENSIMET DHE RILICENSIMET E OPERATOREVE RTV PROBLEMATIKAT E VEPRIMTARISE RTV

Puna e Departamentit Juridik dhe të Licencave për vitin 2005, ka konsistuar në ndjekjen dhe përbushjen e detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Drejtimet kryesore të veprimitarise së këtij Departamenti kanë qënë si më poshtë :

1. Rregullimi ligjor i transmetimeve numerike në Republikën e Shqipërisë.

Finalizimi i këtij objektivi është konkretizuar me Vendimin nr. 336, datë 18.04.2005 "Për miratimin e projektligjit "Mbi hyrjen e transmetimit numerik eksperimental në Republikën e Shqipërisë", i cili është dërguar për procedurë të mëtejshme pranë Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë.

2. Legalizimi i transmetimeve të operatorëve rtv vendorë analogë tokësorë që kanë instaluar impiante jashtë zonës së licencimit e në funksion të kësaj, propozimi i ndryshimeve në ligj, në kuadrin e përmirësimit të tij me qëllim krijimin e operatorëve rajonalë.

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së, pas një bashkëpunimi të frytshëm mes departamenteve të administratës së KKRT-së, u arrit të përgatitej projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë".

Pjesë përbërëse gjatë hartimit të projektligjit ishte edhe propozimi i paraqitur në muajin prill të vitit 2002 pranë Kuvendit të Shqipërisë, i cili ka të bëjë me përfshirjen e konceptit të licencës rajonale. Ky propozim vjen dhe në përgjigje të standardeve e rekomandimeve ndërkombëtare, si të Këshillit të Europës dhe të ITU (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve).

Një aspekt tjetër që çoi në domosdoshmërinë e hartimit të këtij projektligji ishte edhe realizimi i detyrimit që rrjedh nga neni 122 i Kushtetutës së R.SH., si dhe i atij të sanksionuar në ligjin nr. 9335, datë 16.12.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Ndryshues të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar", i cili ngarkon KKRT-në si zbatues të Konventës Europiane për Televizionin Ndërkufitar dhe të Protokollit Ndryshues të saj.

Projektligji i mësipërm është aprovuar nga KKRT si organ vendimmarrës, me Vendimin nr. 358, datë 26.09.2005.

Ai është dërguar për procedurë të mëtejshme pranë Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë.

3. Përgatitja e projektakteve normative (kriteret dhe rregullorja) për licencimin e operatorit rtv kombëtar, paraqitura për miratim në Këshill, si dhe shpallja dhe organizimi i konkurrimit.

Si rezultat i disponibilitetit të frekuencave të lira të evidentuara nga Departamenti Teknik, Departamenti Juridik dhe i Licencave i parapriu realizimit të objektivit të radhës, me hartimin e Rregullores “Për dhënien e licencave për transmetime televizive analoge tokësore në nivel kombëtar”, si dhe të Kritereve “Për dhënien e licencave për transmetime televizive analoge tokësore në nivel kombëtar”.

Pas diskutimit edhe me departamentet e tjera të administratës së KKRT-së, aktet e mësipërme u miratuan nga KKRT në mbledhjen e datës 01.07.2005, me Vendimin nr. 354.

Për transparencë, aktet e mësipërme u botuan dhe në faqen e internetit të KKRT-së. Për sa më sipër, KKRT ka njoftuar publikisht se shpallja dhe organizimi i konkurrimit për licencimin e operatorit rtv kombëtar do të realizohet në datën që ajo do të caktojë, midis operatorëve ekzistues që ofrojnë shërbim në zonën Tiranë-Durrës me pajisje të autorizuara për të transmetuar nga pika e Malit të Dajtit.

4. Rishikimi i kritereve dhe rregullores për licencimin e operatoreve privatë radiotelevizivë.

Në bazë të propozimit të paraqitur nga ana e Departamentit Juridik dhe të Licencave, në mbledhjen e datës 01.07.2005, Këshilli ra dakord për rishikimin e “Kritereve për dhënien e licencave për transmetim radio FM dhe televizive”, dhe “Rregullores për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv, televizion analogjik tokësor dhe radio FM kombëtare dhe lokale”, të miratuara me Vendimet nr. 10, datë 15.05.2000 dhe nr. 14, datë 28.06.2000 të KKRT-së, ndryshuar me Vendimin nr. 52, datë 16.07.2001 të KKRT. Në përfundim të konsultimeve dhe bashkëpunimit me departamentet e tjera të KKRT-së, nga ana e Departamentit Juridik dhe të Licencave, u paraqitën përpara Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizonit për miratim në mbledhjen e datës 29.08.2005, Rregulloret dhe Kriteret e mëposhtme:

- Rregullorja “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetime radiofonike analoge tokësore në nivel kombëtar”;
- Kriteret “Për dhënien e licencave për transmetime radiofonike analoge tokësore në nivel kombëtar”;
- Rregullorja “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor” dhe
- Kriteret “Për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”.

Pas shqyrtimit të sa më sipër, KKRT i miratoi këto akte me Vendimin nr. 355, datë 29.08.2005.

5. Rishikimi i rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë.

Me qëllimin që procedurat përmarrjen e licencës për operatorë privatë radio e televizivë në të ardhmen të jenë sa më transparente dhe që në to të pasqyrohej edhe parimi i shprehur në nenin 7, pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, sipas të cilit "Shqyrtimi i kërkesave për licenca bëhet në mënyrë publike", u bë e mundur që me Vendimin nr. 375, datë 30.11.2005, të KKRT-së, të miratohet rregullorja "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë".

Një risi tjetër që ka sjellë kjo rregullore është fakti, që në të ardhmen, vendimi për shpalljen publike për konkurrimin e kandidaturave për operatorë privatë rtv, tashmë do të merret nga KKRT, dhe jo nga administrata e saj.

6. Kryerja e analizave të nevojshme ligjore për interpretimin e ligjit dhe për draftimin e vendimeve të KKRT-së, si dhe përgatitja e materialeve për çështje të ndryshme të rendit të ditës së mbledhjeve të KKRT-së, duke përfshirë këtu projektvendimet e shoqëruara me relacionet përkatëse.

Gjatë vitit 2005, nga KKRT janë marrë 101 vendime, nga të cilat 85 vijnë si propozim i Departamentit Juridik dhe të Licencave, ose e shprehur në përqindje, rrëth 84% e vendimeve të marra vijnë si propozim i Departamentit Juridik dhe të Licencave.

7. Mbajtja e regjistrat te licencave dhe ndjekja e veprimeve qe lidhen me te.

Nga ana e Departamentit Juridik dhe të Licencave është mbajtur regjistri i licencave që nga fillimi i aktivitetit të KKRT-së në vitin 2000, duke pasqyruar në të, të dhëna dhe informacione që janë konsideruar të domosdoshme nga ky departament.

Me gjithë përpjekjet e Departamentit Juridik dhe të Licencave për të patur një rregullim të brendshëm institucional për mbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të tij, u arrit që me Vendimin nr. 373, datë 30.11.2005, KKRT të miratojë mbajtjen e tij me të dhënat përkatëse.

Si rezultat i mbajtjes së këtij regjistri, duke pasqyruar në të ato informacione që Departamenti i ka parë të arsyeshme dhe të domosdoshme, janë evidentuar të gjithë subjektet rtv, të cilëve u përfundon afati i licencimit.

8. Shpallja e listës së operatorëve të cilëve u përfundon afati i licencës gjatë vitit 2005, si dhe e kritereve që do të ndiqen gjatë procesit të rinovimit të licencave.

- Nëse gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës subjekti ka qenë i rregullt në zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Shqyrtimi i aplikimeve për rinovim licence, përgatitja e raporteve të vlerësimit dhe e projektvendimeve përkatëse.

Gjatë vitit 2005, KKRT ka miratuar rinoimin e licencave për 11 subjekte rtv, si më poshtë:

1. TV Onufri
2. TV Shkodra
3. TV Egnatia
4. TV Kuçova
5. TV Tirana
6. TV Puka
7. TV Mati
8. TV Teuta
9. TV Klaudiana
10. Radio Alsat
11. Radio Prespa

Në të njëjtën kohë janë duke u ndjekur me rigorozitet procedurat për rinoimin e licencave të atyre subjekteve që kanë patur mangësi në dokumentacion ose vonesë në paraqitjen e tij.

Gjatë procesit të rinoimit të licencave janë evidentuar raste të mosrespektimit të nenit 30 të ligjit "Detyrimi për njoftimin e ndryshimeve".

Megjithëse ky është një detyrim i subjektit rtv, Departamenti Juridik dhe i Licencave, me nismën e tij, ose kur ka patur ndonjë informacion, ka kryer verifikime pranë Zyrës së Regjistrat Tregtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Mbi këtë bazë, në rastet kur janë konstatuar ndryshime të kryera pranë këtij Regjistri, për të cilat KKRT nuk është vënë në dijeni, ndaj subjektit përkatës janë marrë masat që parashikojnë aktet përkatese ligjore në fuqi.

Gjithsesi, edhe ato subjekte që nuk e kanë respektuar në kohë nenin 30 të ligjit, kanë qenë të detyruara ta përmblushin këtë detyrim gjatë procesit të rinoimit të licencës.

9. Evidentimi i pronarëve në radiot dhe televizionet e licencuara dhe verifikimi i përputhjes së statusit të tyre me ligjin dhe në funksion të kesaj, paraqitja e propozimit për ndarjen e operatorit të rrjetit nga operatori i programit.

Lidhur me realizimin e këtij objektivi, Departamenti Juridik dhe i Licencave ka përpiluar listën e poseduesve të çdo operatori radio apo televiziv.

Në këtë listë është pasqyruar çdo ndryshim i evidentuar në përbërje të shoqërisë rtv, si dhe është ndjekur respektimi i nenit 20 të ligjit, nga ana e operatorit.

Sic është parashikuar dhe në planin e veprimit 2005, është paraqitur propozimi për ndarjen e operatorit të rrjetit nga ai i programit, në projektligjin e miratuar nga KKRT.

10. Ndjekjen e problemeve që lidhen me të drejtat e transmetimit.

Mbështetur në ligjin nr. 9124 dt. 29.07.2003, dhe irregullores "Mbi depozitimin e dokumentacionit mbi të drejtën e transmetimit", operatorët radiotelevizivë në mënyrë periodike kanë depozituar dhe vazhdojnë të depozitojnë dokumentacionin përkatës për programet e transmetuara.

Krahas verifikimit dhe analizës së marrëveshjeve të depozituara, për problemet e ndeshura është realizuar dhe një praktikë e gjerë shkresore me subjektet përkatëse.

Vlen të theksohet fakti, se në raport me vitin e kaluar, fenomeni aq shqetësues i piraterisë tek subjektet rtv që operojnë në sistemin analog dhe kabllor, ka qenë në përmasa jo shqetësuese dhe plotësisht i kontrollueshëm. Ky fakt pasqyrohet edhe në sanksionet me gjobë të vendosuara për piraterinë për vitin 2005, (gjithsej vetëm 3) përkatësisht për subjektet TV AVN, TV AL-TE, TVSH.

Shqetësimi i vetëm lidhur me subjektet televiziye kabllore mbetet transmetimi i programeve të tyre pa logon përkatëse. Mungesa e emërtimit të stacionit transmetues tek televizionet kabllore përbën një shqetësim, pasi evidentimi i atyre operatorëve që shkelin dispozitat detyruese të ligjit lidhur me transmetimin e programeve pirate është dhe do të jetë i vështirë.

Hyrja në fuqi e ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", si dhe krijimi në të ardhmen i zyrës për mbrojtjen e të drejtave të autorit që parashikohet në këtë ligj, do të sjellë një ndihmë mjaft të madhe në garantimin e një konkurrence të ndershme tek operatorët rtv lidhur me transmetimin e programeve të tyre.

11. Ndjekja e proceseve gjyqësore dhe hartimi i materialeve për përfaqësimin ligor të KKRT-së.

1. **TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 321, datë 07.03.2005 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0106, datë 02.02.2005 në masën 300.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin e saj nr. 648, datë 16.05.2005, kjo gjykatë vendosi **rrëzimin e kërkësë-padisë** së paditësit Fatos Mihali, si të pambështetur në ligj dhe në prova.

Argumentat juridike që e çuan gjykatën në dhënien, e këtij vendimi, të cilat janë pasqyruar edhe në pjesën arsyetuese të tij, ndër të tjera janë: ► Pala paditëse nuk provoi në gjykim kundërligjshmërinë e nxjerrjes së aktit administrativ nr. 321, datë 07.03.2005 të palës së paditur. ► Gjithashtu, paditësi nuk provoi në gjykim mostransmetimin e programeve të TV Top Channel prej tij dhe ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje ndërmjet dy televizioneve apo ndonjë kontratë tjetër ndërmjet këtyre subjekteve. Kundër këtij vendimi nga ana e TV AVN është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë. Jemi në ndjekje të gjykimit të çështjes nga kjo gjykatë.

2. **"Albautor" – KKRT** me objekt – shpërblim për çdo licencë të dhënë operatorëve radio-televizivë, pa autorizimin e Albautor. Kjo çështje po gjykohet ende në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë vitit 2005, jemi paraqitur në të gjitha sencat gjyqësore (gjithsej 9), por ky gjykim nuk ka filluar ende të shqyrtohet nga gjykata për problemet e saj organizative. Konkretisht, në seancën e datës 08.11.2005, gjyqtari i çështjes dha dorëheqjen nga gjykimi i çështjes për pamundësi të formimit të trupit gjykues. Kjo dosje civile iu caktua me short sipas procedurës në gjykatë, një trupi tjetër gjykues. Jemi në ndjekje me seriozitet të plotë të procesit gjyqësor.
3. **TV AVN (kabllor) – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0098, datë

03.11.2004 në masën 800.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin e saj nr. 1503, datë 14.11.2005 kjo gjykatë vendosi pranimin e kërkësë-padisë, anullimin e gjobës datë 03.11.2004 të grüpitsë inspektimit të KKRT-së, lënë në fuqi me vendimin nr. 292, datë 12.11.2004 të KKRT-së. Argumentat juridike që e quan gjykatën në dhënen e këtij vendimi, të cilat janë pasqyruar edhe në pjesën arsyetuese të tij, ndër të tjera janë : ►Në kohën kur vendimi me nr. 279, datë 29.10.2004 i KKRT-së për licencimin e subjektit televiziv kabllor privat TV AVN nuk ishte botuar ende në Fletoren Zyrtare, (*botim i cili sillte hyrjen në fuqi të këtij vendimi*) është vendosur gjoba me nr. 0098, datë 03.11.2004 nga ana e Grüpitsë inspektimit të KKRT-së. Në këtë rast nga ana e Grüpitsë inspektimit duhet të ishin marra masa në zbatim të nenit 137/2 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998. ►Akti i Inspektimit i kryer prej Grüpitsë inspektimit kundrejt subjektit TV AVN është mbajtur në zyrat e KKRT-së dhe jo në ambientet ku paditësi zhvillon veprimtarinë e tij (vendi ku ndodheshin pajisjet e transmetimit). Kundër këtij vendimi nga ana e KKRT-së, në datën 02.12.2005, me shkresën nr. 905 prot., është bërë ankim brenda afateve ligjore, në Gjykatën e Apelit Vlorë. Jemi në **ndjekje me seriozitet të plotë të gjykimit të çështjes nga kjo gjykatë**.

4. **TV AVN – KKRT** me objekt – ankim kundër vendimit nr. 197, datë 14.11.2003 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0047, datë 16.10.2003 në masën 200.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive).
Kjo çështje u gjykua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe me vendimin e saj nr. 1063, datë 08.09.2004, kjo gjykatë vendosi pushimin e gjykimit të çështjes civile për shkak të mosparaqitjes pa shkaqe të arsyeshme të ankuesit (TV AVN). Kundër këtij vendimi nga ana e TV AVN u bë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin e saj nr. 06.2005 vendosi kalimin për rigjykim të kësaj çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Jemi në **ndjekje me seriozitet të plotë të procesit gjyqësor**.
5. **TV AL-TE – KKRT** me objekt – anullimi tërësisht i vendimit të KKRT-së nr. 331, datë 29.03.2005 (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0107, datë 09.03.2005 në masën 300.000 lekë të vendosur nga Grupi i Inspektimit të KKRT-së në kuadër të luftës kundër piraterisë televizive). Kjo çështje filloj të gjykohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Rrëshen. Në datën 23.05.2005, përmungesë të seksionit administrativ, kjo gjykatë vendosi të kalojë gjykimin e kësaj çështjeje civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në datën 09.11.2005, kjo gjykatë vendosi **pushimin e gjykimit** të çështjes civile për shkak të mosparaqitjes pa asnjë shkak ligjor të paditësit në mbështetje të nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile.
6. **Digitalb – KKRT** me objekt – anullimin e vendimit nr. 264, datë 03.09.2004 të KKRT-së (Lidhur me miratimin e sanksionit, gjobës nr. 0081, datë 20.08.2004 në masën 2.000.000 lekë të vendosur Grupi i Inspektimit të KKRT-së). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. datë 23.12.2005, ka vendosur **pushimin e gjykimit** të çështjes civile për shkak të mosparaqitjes pa asnjë shkak ligjor të paditësit në mbështetje të nenit 179/1 të Kodit të Procedurës Civile.

7. **RTSH – TVA** me objekt – shlyerje e detyrimit kontraktor. Në këtë çështje civile KKRT është thirrur si person i tretë me kërkesë të palës së paditur TVA-së. Kjo çështje gjyket në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. **Jemi në ndjekje me seriozitet të plotë të procesit gjyqësor.**
8. **RTSH – Radio +2** me objekt – shlyerje e detyrimit kontraktor. Në këtë çështje civile KKRT është thirrur si person i tretë me kërkesë të palës së paditur Radio +2. Kjo çështje gjyket në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. **Jemi në ndjekje me seriozitet të plotë të procesit gjyqësor.**

9. TV Shijak – KKRT me objekt:

1. Anullimi i aktit administrativ të KKRT-së me nr. 298, datë 22.12.2004.

2. Pezullimi i zbatimit të aktit administrativ.

Në përfundim të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në datën 30.03.2005, kjo gjykatë, me Vendimin nr. 1732 ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së ngritur nga shoqëria “Media +”sh.a.:

- Ndryshimi i aktit administrativ, Vendimit nr. 298, datë 22.12.2004 të KKRT,
- Refuzimi i kërkesës së palës paditëse për vënien e këtij vendimi në ekzekutim të përkohshëm.

Kundër këtij vendimi, të dyja palët kanë paraqitur ankimimin e tyre në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kundërshtuar pikat përkatëse të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Kjo çështje pritet të gjyket nga Gjykata e Apelit.

12. Shqyrtimi i aplikimeve për licenca, përgatitja e raporteve të vlerësimit dhe e projektvendimeve përkatëse.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2005 janë depozituar një numër i konsiderueshëm kërkesash (12 të tillë) për t'u licencuar për operatorë rtv. Për këto kërkesa, pas studimit të disponibilitetit të frekuencave nga ana e Departamentit Teknik, është organizuar në mënyrë periodike konkurrimi i kandidaturave për t'u licencuar si operator rtv.

Kërkesat për licencë për shërbime televizive në qytetin e Tiranës dhe Durrësit kanë marrë përgjigje negative, mbështetur në Vendimin nr. 143, datë 30.05.2005 të KKRT-së, duke qenë se spektri i radiofrekuencave është mjaft i ngarkuar dhe mundësia për kanale të lira është e pamundur.

Për sa më sipër, janë marrë në shqyrtim kërkesat dhe dokumentacioni i aplikimit për licencë të paraqitur nga ana e subjekteve private për transmetim programesh radio e televizive, dhe relacionet e përgatitura i janë paraqitur Këshillit.

Mbi bazën e tyre është bërë dhe licencimi ose jo i subjekteve.

Gjatë vitit 2005, nga ana e KKRT-së janë licencuar 18 subjekte, nga të cilat: 7 për transmetim TV vendor, 4 për transmetim TV kabllor, 5 për transmetim radio FM vendore dhe 2 për transmetim radio FM, si më poshtë:

1. TV Skampa (Elbasan)
2. TV Armonia (Gjirokastër)

3. TV Berati (Berat)
4. TV 6 (Kavajë)
5. TV Vlora Channel (Vlorë)
6. TV Scutari (Vlorë)
7. TV Era (Ersekë)
8. TV kabëll Kruja (Krujë)
9. TV kabëll Fokus (Maliq)
10. TV kabëll Delvina (Delvinë)
11. TV kabëll KL-ED (Durrës)
12. Radio Star (Fier)
13. Radio Club Alsion (Elbasan)
14. Radio Armonia (Gjirokastër)
15. Radio Egnatia (Elbasan)
16. Radio 6 (Kavajë)
17. Radio me përsëritës RFI (Tiranë)
18. Radio me përsëritës World Family (Tiranë)

Sic shihet, edhe për vitin 2005 vihet re një interes konstant për t'u licencuar për operator privat radioteleviziv.

13. Përgatitja e licencave për subjektet e licencuara nga KKRT.

Gjatë vitit 2005, mbi bazën e vendimeve të marra nga KKRT për dhënie licence, pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, janë përgatitur licencat përkatëse për këto subjekte.

14. Përgatitja e dokumentacionit ligjor për prokurimet e zhvilluara nga KKRT dhe ndjekja e procedurave të tyre në përputhje me aktet ligjore në fuqi mbi prokurimet publike.

Për vitin 2005 janë realizuar prokurimet me objekt:

- **"Blerjen e organeve të shtypit nëpërmjet abonimit vjetor".**
Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 107. dt. 16.12.2004, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, më dt. 05.01.2005, ora 10.00, u realizua Tenderi Kërkesë për Kuotim me objekt "Blerjen e organeve të shtypit nëpërmjet abonimit vjetor", me fond limit 503.000 lekë, për nevojat e administratës së KKRT-së Nga firmat pjesëmarrëse nuk pati asnjë ankesë dhe me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve ligjore në fuqi.
- **"Blerjen e kompjuterave dhe printerave".**
Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 16/1 prot., dt. 11.01.2005, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, më dt. 11.02.2005, ora 10.00, u realizua Tenderi i Hapur me objekt "Blerje kompjutera dhe printerë", me fond limit 2.000.000 lekë, për nevojat e administratës së KKRT-së. Nga firmat pjesëmarrëse nuk pati asnjë ankesë dhe me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve ligjore në fuqi.
- **"Blerjen e bojrave të printerit dhe fotokopjeve".**

Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 135/1prot., dt. 15.02.2005, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, më dt. 07.03.2005, ora 10.00, u realizua Tenderi Kërkesë për Kuotim me objekt "Blerje bojra printeri dhe fotokopje", me fond limit 720.000 lekë, për nevojat e administratës së KKRT-së.

Nga firmat pjesëmarrëse nuk pati asnjë ankesë dhe me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve ligjore në fuqi.

- **"Për aksesin në internet të rrjetit të KKRT-së dhe mbajtjen e WEB SITIT të tij në internet".**

Në bazë të Urdhërit të Prokurimit nr. 49, dt. 31.05.2005, të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, më dt. 20.06.2005, ora 10.00, u realizua Tenderi Kërkesë për Kuotim me objekt "Për aksesin në internet të rrjetit të KKRT-së dhe mbajtjen e WEB SITIT të tij në Internet", me fond limit 500.000 lekë, për nevojat e institucionit.

Nga firmat pjesëmarrëse nuk pati asnjë ankesë dhe me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve ligjore në fuqi.

- **"Blerje karburanti".**

Mbështetur në Urdhërin e Prokurimit nr. 23, dt. 01.03.2005 të Kryetarit të KKRT-së dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, më datë 31.03.2005 u realizua Tenderi i Hapur, me objekt "Blerje karburanti" me fond limit 1.310.000 lekë, për nevojat e institucionit.

Nga firmat pjesëmarrëse nuk pati asnjë ankesë dhe me firmën fituese u lidh kontrata përkatëse brenda afateve ligjore në fuqi.

Lidhur me prokurimet e zhvilluara janë zbatuar të gjitha kërkesat e akteve ligjore mbi prokurimet publike lidhur me :

Zgjedhjen e procedurës së prokurimit, përgatitjen e dokumentave të tenderit, të ftesës për ofertë, përsa i përket përpilimit dhe botimit të saj, paraqitjes dhe pranimit të ofertave, shqyrtimit të dokumentacionit të kualifikimit dhe specifikimeve teknike, vlerësimit të ofertave, hartimin e raporteve përbledhëse dhe njoftimet e fituesit, si dhe lidhjen e kontratave përkatëse.

15. Përgatitja e projekteve për "Kodin i Etikes" dhe "Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Pas diskutimeve me drejtuesit e KKRT-së dhe të administratës së saj lidhur me hartimin e projektrregullores së përgatitur nga Departamenti Juridik dhe i Licencave "Për etikën dhe parandalimin e konfliktit të interesave të anëtarëve dhe administratës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit", u konkludua në hartimin veçmas të tyre, pra, në ndarjen e "Kodit të Etikës" nga ai i "Konfliktit të Interesave". Në këto kushte, hartimi dhe kalimi i këtyre projektakteve për procedurë të mëtejshme mbetet për t'u realizuar në fillim të vitit 2006.

16. Kontrolli në bashkëpunim me departamentet e tjera i respektimit të kushteve të përcaktuara në licencë nga subjektet rtv private dhe propozimi i masave e sanksioneve në rast shkeljeje, vendosja e tyre dhe ndjekja e zbatimit të tyre në bashkëpunim me Policinë Tatimore.

Në varësi të shkeljeve të kryera, të cilat në mbështetje të ligjit nr. 8410 përbëjnë kundërvajtje administrative, në bashkëpunim me departamentet përkatëse të administratës së KKRT-së janë ndërmarrë saksionet përkatëse për subjektet si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Numri	Data	Shkaku	Vlera
1.	TV AVN (Kabllor)	0106	02.02.2005	Për piraterinë (2)	300.000 lekë lënë në fuqi me v. 321, dt. 07.03.2005
2.	TV AL-TE (Kabllor)	0107	08.03.2005	Për piraterinë	300.000 lekë ulur në 200.000 me v. 331, dt. 29.03.2005 paguar
3.	TV Arbëria	0108	08.03.2005	Nuk janë dhënë të dhënat e kërkua	200.000 lekë paguar
4.	Klevi Lumshi (Kabllor) Maliq	0109	31.03.2005	Dalje ne transmetim pa autorizim, licencim te KKRT	100.000 lekë paguar
5.	TV KORÇA (Kabllor)	0110	31.03.2005	Nuk ka respektuar kuftjtë territorialë	60.000 lekë paguar
6.	TV KOHA	0111	04.04.2005	Nuk ka respektuar kuftjtë territorialë	1.000.000 lekë hequr me v. 348, dt.10.06.2005
7.	TV AL-TE (Kabllor)	0112	07.04.2005	Për piraterinë	500.000 lekë hequr me v. 338, dt.20.05.2005
8.	TVSH	0113	21.09.2005	Për piraterinë	200.000 lekë

Mbështetur në nenin 137/5 të ligjit nr. 8410, dt. 30.09.1998, të ndryshuar, për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së, lidhur me gjobat dhe sankzionet, ngarkohet Policia Tatimore.

Mbështetur në kërkesën për ndihmën përkatëse nga kjo e fundit, është bërë i mundur ekzekutimi i vendimit nr. 331, dt. 29.03.2005 "Për uljen e masës së gjobës të vendosur ndaj subjektit televiziv kabllor privat TV AL-TE" dhe ekzekutimi i gjobës nr. 108, datë 08.03.2005 ndaj subjektit TVA.

Në të njëjtën kohë është kërkuar në mënyrë të përsëritur ekzekutimi:

- I gjobës nr. 0106, datë 02.02.2005 për subjektin TV AVN lënë në fuqi me Vendimin nr. 321, datë 07.03.2005 të KKRT-së;
- I vendimit nr. 317, datë 28.01.2005 "Për uljen e masave të gjobave ndaj subjektit Real TV" të KKRT-së.

ANEKSI 4/1

A.4/1.1. Të dhënrat e hyrjes për caktimet/allotime numerike

Për ushtrimin e parë të planifikimit, pranë BR janë paraqitur kërkesa për caktimet numerike nga 98 Shtetet Anëtare dhe Autoriteti Palestinez, brenda zonës së planifikimit. Nuk janë marrë kërkesa nga 21 Shtete Anëtare, 18 prej të cilëve prej Zonës Afrikane të Transmetimit. Numri total i kérkesave të vlefshme ishte 59 871. Nga Shqipëria janë paraqitur 210 kérkesa për caktimet numerike, të gjitha të gjitura të vlefshme nga BR.

Për mungesë informacioni, që u trajtua më sipër, KKRT nuk paraqiti kérkesa për caktimet numerike në brezin VHF dhe për sistemin T-DAB, po në këtë brez. Kjo mungesë u plotësua në muajin Gusht 2005, në përputhje me afatin e vendosur nga IPG-1.

Tabela e mëposhtme është një pjesë e tabelës që pasqyron paraqitjen e kérkesave nga të gjitha vendet e zonës së planifikimit. Në tabelë mund të shihen kérkesat e paraqitura nga Shqipëria.

Statistika lidhur me kérkesat numerike të përfshira në ushtrimin e parë të planifikimit

	Total	DS1	DS2	DT1	DT2	DA1
AFS	366			366		
ALB	121				110	11
ALG	800	160		640		
ARM	192				183	9
AUT	509		31	308	121	49
AZE	330				297	33
BDI	18			18		
BEL	193	55	17		74	47

A.4/1.2. Të dhënrat e hyrjes lidhur me transmetimet analoge televizive

Të dhënrat e hyrjes lidhur me transmetimet analoge ekzistuese dhe të planifikuara janë gjeneruar nga Byroja, në përputhje me indikacionet e Raportit të RRC-04. Byroja përpiloj listën e të gjitha caktimeve që janë potencialisht të vlefshme për t'u futur në procesin e planifikimit (rreth 90 732 caktimet). Më pas, Byroja përjashtoi nga kjo listë ato caktimet frekuencore për të cilat administratat përkatëse kerkuan që të mos merren në konsideratë në ushtrimin e parë të planifikimit (rreth 55 399 caktimet). Si rezultat, në ushtrimin e parë të planifikimit, u përfshinë rreth 35 333 caktimet frekuencore të televizionit analog. Informacioni përbledhës përfshihet në tabelën e mëposhtme.

Statistika lidhur me caktimet e transmetimeve analoge ekzistuese dhe të planifikuara për zhvillimin e ushtrimit të parë të planifikimit (FPE), për çdo administratë

	Nr. i caktimeve potencialisht të regjistrueshme ne FPE					Nr. i caktimeve të regjistruara ne FPE					Nr. i caktimeve të përjashtuara nga FPE				
	ST6 1	GE8 9*	MIF R	RC	Tota l	ST6 1	GE8 9*	MIF R	RC	Tota l	ST6 1	GE8 9	MIF R	RC	Total
AFS	0	712	0	0	712	0	688	0	0	688	0	24	0	0	24
AGL	0	193	0	0	193	0	193	0	0	193	0	0	0	0	0

	Nr. i caktimeve potencialisht të regjistrueshme ne FPE					Nr. i caktimeve të regjistruara ne FPE					Nr. i caktimeve të përjashtuara nga FPE				
	ST6 1	GE8 9*	MIF R	RC C	Tota l	ST6 1	GE8 9*	MIF R	RC C	Tota l	ST6 1	GE8 9	MIF R	RC C	Total
ALB	4	0	0	0	4	4	0	0	0	4	0	0	0	0	0
ALG	818	171	0	0	989	818	171	0	0	989	0	0	0	0	0
AND	4	0	0	0	4	4	0	0	0	4	0	0	0	0	0

A.4/1.3. Të dhënat e hyrjes lidhur me caktimet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve të tjera primare, të ndryshme nga transmetimet televizive

Të dhënat e hyrjes lidhur me caktimet e shërbimeve të tjera primare janë gjeneruar nga Byroja, në përputhje me indikacionet e Raportit të RRC-04. Byroja përpiloj listën e të gjitha caktimeve që janë potencialisht të vlefshme për t'u futur në procesin e planifikimit (rreth 12 529 caktime). Më pas, Byroja përjashtoi nga kjo listë ato caktime frekuencore për të cilat administratat përkatëse kërkuau që të mos merren në konsiderate në ushtrimin e parë të planifikimit (rreth 886 caktime), si dhe të gjitha caktimet e notifikuara pas 10 Majit 2004, pasi asnjëri prej tyre nuk ishte koordinuar me sukses me të gjitha administratat përkatëse. Si rezultat, në ushtrimin e parë të planifikimit, u përfshinë rreth 8 107 caktime frekuencore të shërbimeve të tjera primare. Informacioni përbledhës përfshihet në tabelën e mëposhtme.

Statistika të përgjithshme lidhur me caktimet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve të tjera primare për zhvillimin e ushtrimit të parë të planifikimit (FPE)

Burimi	Nr. i caktimeve potencialisht të përshtatshme për përfshirje në FPE	Nr. i caktimeve të përfshira në FPE
Caktimi të regjistruara në MIFR deri në 31 Dhjetor 1989	509	254
Caktimi të regjistruara në MIFR midis 31 Dhjetorit 1989 dhe 10 Maj 2004	8484	7853
Caktimi të notifikuara në BR midis 10 Majit 2004 dhe 28 Shkurtit 2005	3536	0
Total	12529	8107

Duke qenë se në planin kombëtar të Radiofrekuencave, miratuar nga Këshilli i Ministrave, në bandat e frekuencave që janë subjekt i Marrëveshjes RRC-06 nuk parashikohen caktimi për shërbimet e tjera primare, nga ana e Shqipërisë nuk u paraqitën kërkesa për këto shërbime.

ANEKSI 4/2

A.4/2.1. Rezultati i ushtrimit të parë të planifikimit (Të dhënrat në dalje)

Në mbledhjen e IPG-1 u theksua që ushtrimi i parë i planifikimit ofroi një eksperiencë të vlefshme që u dha administratavave ide më të qarta si të procedojnë në përgatitjen e kërkesave të hyrjes për draft planin. Qëllimi i IPG nuk ishte të studionte detajet e vendeve të veçanta, por të përcaktonte çështjet që pengojnë një rezultat të suksesshëm dhe të formulojë veprimet që duhen ndërmarrë për të siguruar këtë sukses.

Për përmirësimin e rezultatit në hartimin e draft planit, IPG u ftua të ofronte zgjidhje për çështjet e mëposhtme:

- Kërkesa të ekzagjeruara të hyrjes në krahasim me spektrin në dispozicion. (Disa vende kishin paraqitur kërkesa për më shumë kanale nga sa disponon spektri).
- Disa vende, me rezultat të dobët, paraqiten inkompatibilitete të brendshme (midis allotmenteve të vetë vendit). Ato duhet të rishqyrtojnë këtë kompatibilitet.
- Gabime në përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesave të hyrjes nga disa administrata.
- Përcaktimi i aksosit të barabartë në procesin e sintezës.
- Test points (pikat e provës)/rrjetet referencë në det.
- Caktimi me fuqi shumë të lartë transmetimi (ndonjeherë të lidhura me allotmentet).
- Caktimi apo allitime për zona shërbimi shumë të gjera.
- Dorëzimi i deklaratave administrative, të brendshme dhe me vendet fqinje, të cilat, psh, mund të marrin në konsideratë karakteristikat reale të terrenit. Kjo çështje u shqyrtua edhe në gr ad hoc 2.
- Akses i barabartë (d.m.th. një numër minimal prej 4 deri në 7 kërkesash/shtresash për zonë). Kjo çështje u shqyrtua edhe në gr ad hoc 1.
- Zbutje e kritereve të planifikimit siç u këshillua nga Working Group 4.

Në përputhje me indikacionet e Anekxit 2 të Resolutës COM5/1, rezultatet e ushtrimit të parë të planifikimit duhet të publikoheshin deri në 15 Korrik 2005. Kjo u realizua me LQ CR/238 të datës 31 Maj 2006. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet jepet në kapitullin që vijon (**Anekxi 4/3 - 4.2.3.5. Zhvillimi i ushtrimit të parë të planifikimit (përshkrim i përgjithshëm dhe statistikat)**). LQ CR/238 e dërguar nga ITU përmban edhe CD-ROM-e, ku janë përfshirë të gjitha detajet e rezultateve të ushtrimit të parë të planifikimit dhe softin për të lexuar këto të dhëna.

Informacioni është esencialisht i njëjtë i paraqitur në mbledhjen e IPG-1 (4–8 Korrik 2005) me ndryshimet e mëposhtme:

- disa rezultate që janë përfshirë tashmë gjatë mbledhjes së IPG-së. Në këto raste procesi i sintezës është përsëritur. Si rezultat, për disa administrata janë shënuar ndryshime;
- tashmë, deklaratat administrative janë të dukshme.

Në bazë të Aneksit 2 të Rezolutës COM5/1, administratat duhet të analizojnë këto rezultate, me synim që ato të merren në konsideratë kur të përgatiten të dhënat e hyrjes për prodhimin e draft planit. Kujtojmë se IPG, pas rishikimit të këtyre rezultateve dhe duke vënë re që ekziston një numër i konsiderueshëm inkompatibilitetesh, ftoi PXT të përsërisë disa etapa të procesit të planifikimit (kryesisht procesin e sintezës), bazuar në deklaratat administrative shtesë. Për këtë qëllim, të gjitha administratat u ftuan të rishikojnë paraqitjen e deklaratave administrative shtesë, duke përdorur konceptin dhe formatin e paraqitur në Addendum 1 të CR/229. Afati për paraqitjen e këtyre deklaratave administrative shtesë u vendos **22 Gushti 2005** dhe rezultatet e këtyre llogaritjeve shtesë, së bashku me rezultatet e tjera do të paraqiten në mbledhjen e Takimit të Punës (Working Party) të IPG-së të planifikuar për 28-29 Shtator 2005.

Ky veprim bëhet për të vlerësuar ndikimin e deklaratave administrative në rezultatet e procesit të planifikimit. Pas diskutimit dhe përcaktimit të masave në mbledhjen e shtatorit, të gjitha vendet do të kryejne korrigimet e nevojshme dhe do të paraqesin kërkesat e korriguara për hartimin e draft planit që do shqyrtohet në mbledhjen IPG-2.

ANEKSI 4/3

A.4/3.1. Zhvillimi i Ushtrimit të Parë të Planifikimit

(Përshkrim i përgjithshëm dhe statistikat).

PXT zhvilloi ushtrimin e parë të planifikimit duke përdorur indikacionet e Raportit të RRC-04. Rezultatet e ushtrimit u paraqiten në “versionin bazë” (shih më poshtë). PXT gjithashtu kreu tre studime shtesë, bazuar në këshillën prej Grupit Drejtues të IPG-së, lidhur me opsonet e variantet e mundshme të planifikimit.

A.4/3.1.1. Versioni bazë (varianti 1)

Për këtë version, PXT përfshiu të gjitha caktimet frekuencore të televizionit analog që janë në gjendjen referencë “ekuivalente” dhe të gjitha caktimet frekuencore të shërbimeve primare të ndryshme nga transmetimet rtv që janë në gjendjen referencë “ekuivalente”, siç jepet nga Raporti i RRC-04, i plotësuar me indikacione nga administratat përkatëse.

A.4/3.1.2. Varianti 2

Në këtë studim, gjatë procesit të planifikimit janë marrë në konsideratë të gjitha caktimet e televizionit analog në gjendjen referencë “ekuivalente”, dhe të gjitha caktimet e shërbimeve primare të ndryshme nga transmetimet rtv në gjendjen referencë “ekuivalente” u përjashtuan nga procesi i planifikimit.

A.4/3.1.3. Varianti 3

Në këtë studim, gjatë procesit të planifikimit janë përjashtuar të gjitha caktimet frekuencore të televizionit analog në gjendjen referencë “ekuivalente”, dhe të gjitha caktimet e shërbimeve primare të ndryshme nga transmetimi në gjendjen referencë “ekuivalente” janë marrë në konsideratë gjatë procesit të planifikimit.

A.4/3.1.4. Varianti 4

Në këtë studim, gjatë procesit të planifikimit, të gjitha caktimet e televizionit analog në gjendjen referencë “ekuivalente”, dhe të gjitha caktimet e shërbimeve të tjera të ndryshme nga transmetimet rtv në gjendjen referencë “ekuivalente” janë përjashtuar nga procesi i planifikimit.

A.4/3.1.5. Përbledhje e rezultateve

A.4/3.1.5. 1. Rezultatet për Bandën III (VHF) (DVB-T)

	Varianti 1			Varianti i 2			Varianti 3			Varianti 4		
	T-DAB	DVB-T	Total	T-DAB	DVB-T	Total	T-DAB	DVB-T	Total	T-DAB	DVB-T	Total
Po	765	1 362	2 127	759	1 373	2 132	1 591	2 433	4 024	1 605	2 469	4 079
Jo	5 140	4 813	9 953	5 146	4 802	9 948	4 314	3 742	8 056	4 300	3 706	8 006
Total	5 905	6 175	12 080	5 905	6 175	12 080	5 905	6 175	12 080	5 905	6 175	12 080

Po = numri i kërkesave që janë pajisur me kanal apo bllok frekuencash

Jo = numri i kërkesave të paplotesuara me kanale apo blloqe frekuencash

Në këto rezultate nuk janë pasqyruar kërkesat e Shqipërisë, pasi për këtë bandë frekuencash, ato janë dërguar pas datës së publikimit;

A.4/3.1.5. 2. Rezultatet për Bandën IV dhe V (UHF) (DVB-T)

	Varianti 1	Varianti 2	Varianti 3	Varianti 4
Po	16 243	17 025	25 233	26 274
Jo	26 483	25 701	17 493	16 452
Total:	42 726	42 726	42 726	42 726

Po = numri i kërkesave që janë pajisur me kanal apo bllok frekuencash

Jo = numri i kërkesave të paplotësuara me kanale apo blloqe frekuencash

4A.4/3.1.5.3 Rezultatet për Shqipërinë për bandat IV dhe V (UHF) (DVB-T)

Po = numri i kërkesave që janë pajisur me kanal apo bllok frekuencash Jo = numri i kërkesave të paplotësuara me kanale apo blloqe frekuencash									
Studimi 1			Studimi 2		Studimi 3		Studimui 4		
ADM	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	
AFS	88	278	88	278	309	57	309	57	
ALB	0	110	0	110	9	101	8	102	
ALG	203	187	204	186	376	14	376	14	
ARM	7	149	9	147	117	39	151	5	
ARS	148	272	151	269	254	166	260	160	

Tabela e mësipërme tregon se me të dhënat e dërguara për ushtrimin e parë të planifikimit, pa kryer parakoordinimin me vendet e tjera, Shqipëria nuk mund të krijonte asnje rrjet numerik me shtrirje kombëtare, edhe në rastin ku nuk merren parasysh interferencat nga caktimet analoge ekzistuese dhe të planifikuara, si dhe nga shërbimet e tjera primare të ndryshme nga transmetimet TV. Duke iu referuar 11 zonave të allotimit, të përcaktuara nga projektplani, për të kriuar një rrjet SFN, Shqipërisë i duhen 11 caktimë frekuencore.

Konkluzione të ngjashme u arritën edhe për kërkesat e vendeve të tjera. Me këtë rast, BR identifikoi shkaqet dhe paraqiti masat për lehtësimin e planifikimit, nëpërmjet zbutjes së kritereve të caktuara në kushte të caktuara, nëpërmjet uljes së numrit të kërkesave (duke siguruar një numër minimal mbulimesh kombëtare për çdo vend, bazuar në parimin e aksosit të barabartë të vendeve në burimet spektrale).

ANEKSI 4/4

A.4/4. Projekt shembulli i tekstit rregulator

Projekt shembulli i tekstit rregulator u prezantua nga z. **Mr. Jean CHARTIER**, Kryetar i SWG-1/WPRPG (Grupit te Studimit 1 të Takimit te punes se RPG). Ne prezantimin e tij, (Doc RPG/2-E), Z. Chartier, informoi mbledhjen si vijon:

A.4/4. 1. Veprimtarite intersesionale ne kuadrin e RPG

Per te pergatitur mbledhjen e RPG, jane ndermarre hapat e meposhtem

- Takimi i Punes se RPG (WP RPG, Gjeneve, Nentor 2004)

U organizua takimi i Punes te RPG, per te percaktuar modalitetet dhe Grupin e punes, per caktimin e drejtuesit te tij dhe perqatitjen e projekt shembulli i tekstit rregulator bazuar ne diskutimet nga perfaquesuesit e vendeve antare gjate Takimit ta Punes (Pala shqiptare nuk ka marre pjese ne WP RPG) .

- Mbledhjet e Grupit te punes.

Jane organizuar tre mbledhje te Grupit te Punes :

1. SWG-1 (Gjeneve, Mars 2005)
2. SWG-1 (Gjeneve, Qershori 2005)
3. SWG-1 (Gjeneve, Gusht 2005)

Rezultatet e ketyre aktiviteteve u paraqiten ne mbledhjen e RPG (Gjeneve 6-9 Dhjetor 2005).

A.4/4. 2. Qellimi i Marreveshjes RRC

1. **Qellimi kryesor i Marreveshjes qe pritet te neneshkruhet, eshte implementimi i transmetimeve radio e televizive numerike ne Rajon.**

Per kete eshte e nevojeshme te percaktohen:

- Procedura per modifikimin e Planeve qe do te dalin nga Konferenca (Neni 4 i “projekt shembullit te tekstit rregulator”) duke siguruar mbrojtjen e transmetimeve ekzistuese dhe te planifikuara, si dhe sherbimet e tjera tokesore, te ndryshme nga transmetimet rtv;
 - Procedura per notifikimin e caktiveve frekuencore perpara futjes se tyre ne perdom (Neni 5);
 - periudha e tranzicionit per migrimin nga analogu ne digital
2. **Qellimi i dyte kryesor i marreveshjes, eshte te stabilizohet nje kuader afatgjate per te programuar zhvillimet e ardheshme te transmetimeve radio e televizive.**

A.4/4. 3. Planet RRC-06

Marreveshjes RRC-06 do t'i bashkengjiten dy Plane:

- Plani analog qe do te permboje caktimet frekuencore ekzistuese dhe te planifikuara, sic do te percaktohen nga RRC-06

- Plani numerik (digital) qe do te permbaje caktimet dhe allotimet numerike.
- Plani numerik do te ndertohet bazuar ne hipotezat e meposhtme:

Hipoteza n°1

- Plani numerik do te jete kompatibel ne vetvehte (self-compatible), d.m.th te gjitha allotmentet/caktimet ne Planin numerik janë kompatibel me njeri tjetrin.
- Kerkasat numerike incompatible qe nuk do te perfshihen ne plan ne conference do te koordinohen me vone duke perdonur proceduren e peshkruar nga Neni 4.

Hipoteza n°2

- Allotimet/caktimet numerike ne Plan qe jane inkompatibel me caktimet analoge ekzistuese apo te planifikuara, apo me caktime te sherbimeve te tjera primare tokesore, te ndryshme nga transmetimi rtv, ekzistuese apo te planifikuara, ne Planin Numerik do te kene nje shenim qe do te tregoj se, perpara futjes ne perdonim te stacionit numerik eshte e domosdoshme te kryhet procedura e koordinimit.

A.4/4. 4. Nenet kryesore te Marreveshjes

Neni 4

a. Kuadri i pergjithshem

Rregullon evolucionin e kerkesave te administrative te ndryshme per

- Shtimin, modifikimin apo fshirjen e nje allotimenti/caktimi ne Planin analog apo ne Planin numerik.
- Konvertimin e allotmentit(eve) ne caktim(e) frekuencore .
- Koordinimin e sherbimeve te tjera primare tokesore me transmetimet radiotelevizive.

Per rregullimin e ceshtjeve te mesiperme, Marreveshja GE89 eshte bazuar ne perfshirjen e plote te BR (Byrose se Radiokomunikacioneve te ITU), ndersa Marreveshja ST61 eshte bazuar ne marreveshjet bilaterale.

Grupi i punes SWG-1 propozon qe GE06 (RRC-06) te bazohet ne nje kombinim te ketyre dy opsiuneve.

b. Permbajtje e pergjithshme dhe hapat (procedurat) e Shtimit, modifikimit apo fshirjen e allotmenteve/caktimeve

1. Administratat mund te kerkojne miratim direkt perpara dergimit te kerkesave te tyre ne BR.
2. Paraqitja ne BR
3. Identifikimi nga BR i administatave te prekura nga kerkesa(t) e paraqitur(a).
4. Publikimi nga BR (IFIC)
5. Periudha per komente me mundesine per t'u shtuar ne procesin e koordinimit
6. Nese arrihen miratimet nga te gjitha administratat e prekura, modifikimi futet ne Plan. Perndryshe, lihet nje periudhe per koordinimin midis administrative.

Mund te jepet asistence nga BR.

c. Opinione te ndryshme mbi metodat e identifikimit te administratave te prekura nga modifikimet qe kerkohen

- Perqasja 1
 - Identifikimi i administrative te prekura te bazohet sipas territorit te tyre dhe jo ne caktimet/allotimet perkatese.
- Perqasja 2

- Identifikimi i administrative te prekura te bazohet ne caktimet/allotimet e tyre.
- Perqasja 3 (*jo plotesisht e studuar nga SWG-1*)
 - Identifikimi i administtatave te prekura te bazohet ne territorin e tyre, por arsyet per mosmiratimin duhet te bazohen vetem ne caktimet /allotmentet.

Neni 5

a. Kuadri i pergjithshem

- Rregullon procedurat par notifikimin e caktimeve per regjistrimin ne MIFR (Master Registrin Nderkombetar te Frekuencave)
 - Per transmetimet RTV
 - Per sherbimet e tjera primare tokesore, te ndryshme nga transmetimet rtv.
- Procedurat e propozuara
 - Perqasja 1 : Neni 5 t'i referohet Nenit 11 te RR (Radio Rregulloreve te ITU)
 - Perqasja 2 : Te percaktohet nje procedure e vecante qe do te peshkruhet ne Marreveshje
- Sanksionon kontrollin e konformitetit me Marreveshjen perpara regjistrimit ne MIFR (Master International Frequency Register)

b. Konformiteti

Propozohen kriteret per verifikimin e konformitetit si me poshte:

- Caktimi frekuencor perfshihet ne Plan, apo
- Caktimi frekuencor perfshihet ne masken e nje hyrjeje ne Plan.
 - Konvertimi i nje allotamenti te Planit Numerik ne nje apo me shume Caktime.
 - Perdorimi i transmetimeve analoge pas perfundimit te periudhes se tranzicionit.
 - Perdorimi i nje hyrjeje ne plan me karakteristika te ndryshme.
 - Perdorimi i nje hyrjeje numerike ne Plan per qellime te tjera.

c. Probleme

Neni duhet te percaktoje ne se ka apo nuk ka mundesi per te futur ne perdorim nje caktim i cili nuk eshte ne konformitet me Marreveshjen

Ne grupin e punes, per kete ceshtje nuk eshte arritur asnje konkluzion.

A.4/4. 5. Periudha e tranzacionit

Do te percaktohet nga marreveshja

Eshte periudha e migrimit nga teknologja analoge ne ate digitale. Pas kesaj periudhe,

- Plani analog fshihet
- Plan digital mund te implementohet plotesisht pa kufizime.
- Disa transmetime analoge mund te vazhdojne, me kusht qe te mos shkaktojne interference apo te kerkojne mbrojtje (koncepti i maskes, permblehdheses)

Per kohezgjatjen e periudhes se tranzacionit ne Raportin RRC-04 jepen dy opsiione

- Perpara 2015
- Midis 2028 dhe 2038

Ekziston mundesa per te miratuar ne menyre bilaterale nje periudhe tranzicioni te reduktuar.

A.4/4.6. Revizionimi i Marreveshjeve ST61 and GE89

Gjate konferences RRC-06 do te organizohen dy konferenca te shkurtera per te revizionuar marreveshjet ST61 and GE89.

Kjo behet per te shmangur cdo mbivendosje midis marreveshjeve ekzistuese dhe Marreveshjes se re. Per pasoje, do te abrogohen pjese te ST61 dhe GE89 qe lidhen me brezat 174-230 MHz dhe 470-862 MHz.

A.4/4. 7. Kontributet e Administratave pjesemarrese

Ne vijim, ne séance plenare u shqyrtuan dokumentet qe permbanin kontributet e administratave e institucioneve te ndryshme per permiresimin e neneve te ndryshme "te projekt shembullit te marreveshjes ».

Pas diskutimit te secilit prej dokumenteve te paraqitur, kahasimit te propozimeve per amandime te ndryshme me pjeset perkatese te draft tekstit te marraveshjes se paraqitur nga grupi i punes dhe adoptimit apo mos aprovimit te propozimeve nga mbledhja, u arrit te perpilohej nje draft tekst i permiresuar, i cili paraqitet bashkengjitur.

Diskutimet per ceshtjet me te debatueshme, per shkak te qendrimeve te ndryshme te administratave te vendeve te ndryshme, rezultuan ne perpilimin e perqasjeve te ndryshme (approach) tye cilat u lane ne projekt tekstin si opsione, per zgjedhjen e te cileve do te vendose Konfrenca (RRC-06).

Ceshtjet me te debatueshme, qe pasqyronin edhe politikat e ndryshme te zhvillimit te zgjedhura nga administrata te ndryshme, pasqyrohen me poshte:

A.4/4. 8. Qendrimet lidhur me Neni 4 te draft tekstit

(Procedura lidhur me modifikimet e Planeve dhe koordinimi i sherbimeve te tjera primare tokesore)

Ne kete nen, parashikohen kriteret per identifikimin e administrative qe preken nga kerkesa e re per tu futur ne plan dhe paraqitja e arsyeve per mosmiratim. Per kete pike (4.1.2.2) u hartuan dy perqasje:

Perqasja 1.

Sipas kesaj perqasjeje, identifikimi nga BR i administrative qe preken qofte nga modifikimi i Planeve apo nga nje caktim i ri apo i modifikuar per sherbimet e tjera primare tokesore, bazohet ne territorin e tyre (dmth kur tejkalojen standartet e vendosura te mbrojtjes ne kufi apo ne cdo pike te territorit te kesaj administrate) dhe nuk bazohet ne caktimet/allotimet e saj te transmetimeve RTV.

Sipas ketij varianti,

- Do te mbrohet e drejta e administrates se ciles i kerkohet koordinim duke lejuar kete administrate te zhvilloje me vone rrjetet t saj te transmetimit Brenda territorit te saj; per pasoje propozohet qe te mos aplikohet asnje limit kohor per futjen ne perdonim te modifikimeve te Planit
- Nje kerkese koordinimi mund te hidhet poshte nga Administrata edhe nese kjo e fundit nuk ka caktime apo allotime te prekura.
- Kjo perqasje sjell me shume kerkesa per koordinimin se sa perqasja 2.

Sipas kesaj perqasjeje, nje administrate mund te blokoje lehtesishet administraten tjeter, sidomos gjate periudhes tranzitore, gje qe eshte ne avantazh te vendeve ne zhvillim qe synojne qe ta zgjasin periudhen tranzitore deri ne vitin 2025.

Perqasja 2

Sipas kesaj perqasjeje, identifikimi nga BR i administrative te prekura qofte nga modifikimi i Planeve apo nga nje caktim i ri apo i modifikuar per sherbimet e tjera primare tokesore, bazohet ne caktimet/allotimet e tyre se bashku me nje limit kohor per futjen ne perdonim te caktimeve/allotimeve te reja.

Sipas ketij varianti,

- Objekzioni per nje kerkese per koordinim do te bazohet ne caktimet/allotimet e prekura qe ndodhen ne Plan
- Mund te mos mbroje te drejten e te gjitha administrative te zhvilloje me vone rrjetet e transmetimit brenda territorit te tyre.

Perqasja 2 favorizon me shume vendet e zhvilluara qe parashikojne zhvillim te shpejte te rrjeteve te tyre numerike.

Perqasja 3.

Ekziston edhe nje perqasje tjeter si kombinim i dy te parave, por ajo nuk eshte studiuar plotesisht.

**A.4/4. 9. Qendrimet lidhur me Neni 5 te draft tekstit
(Notifikimi i Caktimeve frekuencore)**

Perqasja 1

Ideja eshte qe nenii notifikimit te marreveshjes se re t'i referohet nenit 11 te RR, aktualisht ne fuqi. Sipas kesaj perqasjeje, vetem caktimet e koordinuara me sukses apo caktimet Brenda maskes se nje hyrjeje ne Plan konsiderohen "ne konformitet me Marreveshjen dhe Planet shoqeruese te saj" dhe prandaj regjistrohen ne MIFR, me vleresim pozitiv. Per pasoje mund te linde nevoja qe RRC-06 te vendose qe Rregullat e Procedures ne Nenin 11.34 te mo aplikohen lidhur me Marreveshjen GE06 (RRC-06).

Perqasja 2

Sipas kesaj perqasjeje, propozohet te hartohet nje nen me vete per notifikimin e caktimeve frekuencore te transmetimeve RTV.

A.4/4. 10. Kohezgjatja e periudhes se tranzacionit

Ne draft tekstin qe rezultoi pas diskutimeve (Neni 13, pika 13.5), percaktohet :

« Periudha e tranzacionit do te perfundoje ne [2015] [2025]. Pas perfundimit te periudhes se tranzacionit Plani analog do te abrogohet. ».

Vendosjet e datave ne kllapa katrore tregon se mbledhja nuk e gjeti konsensusin per te percaktuar nje date te perfundimit te periudhes se tranzacionit. Vendet e CEPT-it mbeshtetin variantin e perfundimit te periudhes se tranzacionit perpara vitit 2015, ndersa vendet e Afrikes dhe vendet arabe te perfshira ne zonen e planifikimit, mbeshtetin variantin pas vitit 2025.

Data e perfundimit te periudhes se tranzacionit, qe percaktohet nga zhvillimi ekonomik i nje vendi si dhe faktore te tjere sociale e politike, mbetet te miratohet gjate Konferencies, ne muajin maj 2006.

Per sa u trajtua ne paragrafin paraardhes, eshte e nevojeshme qe brenda afatit kohor te mbetur deri ne celjen e Konferencies Rajonale te Radiokomunikacioneve RRC-

06, te organizohen konsultime me te gjithe faktoret politike e administrative te vendit me qellim qe te sqarohet perspektiva e zhvillimit te transmetimeve numerike ne Shqiperi, perfshire percaktimin e kohezgjatjes se periudhes se tranzicionit.

A.4/4. 11. Hyrja ne fuqi e marreveshjes dhe fshirja e te gjitha caktimeve qe nuk figurojne ne Plan.

Pikat 13.1 dhe 13.2 te nenit 13 te projekt tekstit jane formuluar :

,,13.1 Marreveshja do te hyje ne fuqine [17 Qershori 2007] ne oren [0001] GMT.

[13.2 Ne kete date stacionet transmetues ne funksionim me caktimet frekuencore qe nuk jane ne Plane apo qe nuk jane ne konformitet me planet do te nderpresin transmetimin].

Pika 13.2 ne kllapa katrore deshmon se shume vende rezerva ne aplikimin e kesaj dispozite vetem 1 vit pas neneshkrimit te Marreveshjes.

Mendimi yne eshte se, sidomos aktualisht, kur nuk dihen rezultatet e ushtrimit te dyte te planifikimit (draft plani) qe do te percaktoje gjendjen reference (stacionet analoge ekzistuese te koordinuara si dhe caktimet/allotimet numerike), nuk ekzistojne madesite per te percaktuar daten e mbylljes se stacioneve qe nuk figurojne ne Plan. Nese, pas publikimit te gjendjes reference do te rezulton shume stacione analoge shqiptare te pa vendosura ne gjendjen reference (kjo eshte situate e priteshme, pasi Shqiperia ka vetem 4 caktime frekuencore te regjistruar ne ST61), zbatimi i dispozites 13.2 do te diktonte mbylljen e shume stacioneve ekzistues.

Nga diskutimet jozyrtare me perfaqesues te administrate italiane rezulton se edhe ata ndajne te njejtin mendim. Perfundimisht, mendimi yne eshte qe dispozita 13.2 te mos perfshihet ne tekstin e Marreveshjes se re.

A.4/4. 12. Projekt tekstet shembull per aktet finale te Konferencave te vecanta per revizionimin e Marreveshjeve Stockholm 61 dhe Gjeneva 89

Ne mbledhjen e RPG, ne perputhje me udhezimet e RRC-04, u paraqiten edhe projekt tekstet shembull per aktet finale te dy Konferencave te vogla qe do te mbahen per te revizionuar marreveshet ST 61 dhe GE 89, per pjesen e spektrit 174-230 MHz dhe 470-862 MHz qe u perkasin transmetimeve RTV. Keto tekste paraqiten bashkengjitur ne variantin e ripunuar qe rezultoi pas mbledhjes se RPG.

Per keto dy tekste u diskutua data e hyrjes ne fuqi, qe eshte e lidhur me daten e hyrjes ne fuqi te Marreveshjes kryesore RRC 06 (qe tashme do te quhet GE06).